



Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë-2024

Përgatitur nga : Basri Hyseni



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHITIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP

 **WE
EFFECT**

PARATHËNIE

Ky raport është përgatitur me ndihmën financiare të “WE EFFECT”.

Pikëpamjet e shprehura në të janë të konsulentit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjen zyrtare të “We efektit” ose Qeverisë së këtij vendi. Konsulent i angazhuar në përgatitjen e këtij studimi është Basri Hyseni – Agronom konsulent.

Përmbajtja	
1	Përmbledhje ekzekutive 8
2	Metodologjia 11
3	Konteksti dhe të dhënat kryesore të sektorit të blegtorisë..... 11
3.1	Gjendja aktuale e sektorit të qumështit..... 12
3.1.1	Qumështi i lopës 12
3.2	Gjendja aktuale e sektorit të mishit (gjedhit)..... 15
3.3	Sipërfaqja e tokës, toka e punueshme 17
3.4	Punësimi aktual dhe potencial 18
4	Prodhuesi/Fermerët..... 19
4.1	Sektori i prodhimit të qumështit 19
4.1.1	Prodhimi i qumështit të lopës..... 19
4.2	Sektori i prodhimit të mishit..... 24
4.2.1	Prodhimi i mishit të gjedhit..... 24
5	Industria e Përpunimit..... 26
5.1	Industria e përpunimit të qumështit..... 26
5.2	Industria e përpunimit të mishit..... 33
6	Organizatat e Shoqërisë Civile dhe roli i tyre në përmirësimin e sektorit të qumështit 36
6.1	Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK)..... 36
6.2	Shoqata e Përpunuesëve të Qumështit në Kosovë (SHIQK) 38
7	Politika qeveritare për sektorin e gjedhtarisë (qumështit dhe mishit) 38
7.1	Përpunimi i qumështit 43
7.2	Përpunimi i mishit..... 43
8	Tregu dhe Tregtia e produkteve Blegtorale 44
8.1	Sektori i qumështit 44
8.3	Sektori i mishit..... 48
8.4	Pikat mbizotëruese të tregut, efektiviteti dhe mundësitë e tyre 49
8.5	Disponueshmëria e produkteve 50
8.6	Modelet e konsumit..... 50
8.7	Kuadri ligjor për tregtinë..... 51
8.8	Pengesat ekzistuese të tregtisë 52
9	Niveli i përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të BE-së..... 52
9.1	Cilësia e prodhimit primar dhe sekondar 53
9.2	Higjiena dhe siguria ushqimore në fermë dhe nivelet e përpunimit, duke u përqendruar në standardet për mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë 54
9.3	Mirëqenia e kafshëve 54
9.4	Siguria ushqimore 55
9.5	Niveli aktual i përputhshmërisë me standardet përkatëse kombëtare dhe të BE-së dhe numri i ndërmarrjeve të miratuara nga BE-ja për eksporte (certifikatat e eksportit të BE-së) 56
9.6	Programe të tjera për përditësimin e standardeve të BE-së në Kosovë 56
10	Trendet e kaluara dhe zhvillimet e ardhshme në aspektin e investimeve 58
10.1	Analizë e investimeve në nivelet primare dhe të përpunimit të sektorit të qumështit dhe mishit..... 58
10.2	Ndikimi i PBZHR-së 2014-2020 dhe 2020/2021 – 2023 në zhvillimin e deritanishëm të sektorit..... 62

11	Identifikimi i potencialeve dhe nevojave të sektorit	65
11.5	Analizimi i nevojave të sektorit për nga pikëpamja e planifikimit të politikave.....	73
12	Identifikimi i nevojave për trajnim në sektor.....	73
12.1	Sektori i qumështit	74
12.2	Sektori i mishit.....	74
13	Përafrimi me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së.....	75
14	Rezultatet	78
14.1	Sektori i qumështit	78
14.2	Sektori i mishit.....	85
15	Referencat	90
16	SHTOJCA	91
	SHTOJCA 1: Llogaritjet e marzhit bruto të qumështit.....	91
	SHTOJCA 2: Llogaritja e marzhit bruto të mishit të viçit	92

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Lista e tabelave

TABELA 3-1. SIPËRFAQJA E FORAGJEREVE/HA 2018-2022	17
TABELA 3-2. PRODHIMI I FORAGJEREVE/TON, 2018-2022 (TON)	18
TABELA 4-1. FONDI DHE STRUKTURA E BAGËTIVE	21
TABELA 4-2. BILANCI I FURNIZIMIT PËR QUMËSHITIN E LOPËS DHE PRODUKTET E QUMËSHITIT, 2018-2022	24
TABELA 4-3. GJEDHET E THERURA NË NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE BUJQËSORE DHE JASHTË TYRE	25
TABELA 5-1. STANDARDET E CILËSISË SË QUMËSHITIT TË PËRCAKTUARA ME DEKRETIN E CILËSISË SË QUMËSHITIT TË PAPËRPUNUAR 20/2006	30
TABELA 5-2. PËRQINDJET E PRODHIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TOTAL TË QUMËSHITIT NGA LOPËT QUMËSHTORE	30
TABELA 5-3. PRODHIMI DHE SHFRYTËZIMI I QUMËSHITIT	31
TABELA 5-4. PRODUKTET E PËRPUNUARA TË QUMËSHITIT NË NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE BUJQËSORE	31
TABELA 5-5. KATEGORIZIMI I IMPIANTEVE TË PËRPUNIMIT TË QUMËSHITIT	32
TABELA 5-6. KATEGORITË E PRODUKTEVE TË QUMËSHITIT ME VLERË TË SHTUAR	32
TABELA 5-7. BILANCI I FURNIZIMIT ME MISH VIÇI 2018-2022	36
TABELA 7-1. PAGESAT DIREKTE 2018-2022, NË €	40
TABELA 7-2. NUMRI PËRFITUESËVE NË VITIN 2022, NË NËMASAT 1.7 DHE 1.9 SHPREHUR NË €	41
TABELA 7-3. NUMRI PËRFITUESËVE NË VITIN 2022 NË NËMASAT 3,1, SHPREHUR NË €	41
TABELA 7-4. NUMRI PËRFITUESËVE NË VITIN 2022 NË NËMASAT 1.5, NË €	42
TABELA 7-5. NUMRI PËRFITUESËVE NË VITIN 2022 NË NËMASAT 3.2, NË €	43
TABELA 8-1. IMPORTET DHE EKSPORTET E PRODUKTEVE TË QUMËSHITIT 2018-2022	46
TABELA 8-2. KATEGORIZIMI I QUMËSHITIT SIPAS CILËSISË NËPËR VITE 2019 - 2023 SHPREHUR NË LITRA & %	47
TABELA 8-3. IMPORTI DHE EKSPORTI I PRODUKTEVE TË MISHIT PËR VITET 2018-2022, NË 1000 €	48
TABELA 8-4. ÇMIMET MESATARE VJETORE TË DEMAVE DHE MËSHTJERRAVE, €/KG, - 2019-2022	48
TABELA 8-5. ÇMIMET MESATARE VJETORE NË FERMË NË €/KG, - 2019-2022	49
TABELA 8-6. ÇMIMET MESATARE VJETORE TË KONSUMIT NË €/KG	50
TABELA 8-7. DISPONUESHMËRIA E PRODUKTEVE TË QUMËSHITIT	50
TABELA 10-1. MASA E 101 E INVESTIMEVE NË FERMAT E QUMËSHITIT 2020/2021 – 2023	58
TABELA 10-2. MASA E 103 E INVESTIMEVE NË ASETET FIZIKE DHE PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE TË PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E QUMËSHITIT PËR PERIUdhËN 2020/2021 – 2023	59
TABELA 10-3. MASA 101 E 103 E INVESTIMEVE NË ASETET FIZIKE NË FERMAT QUMËSHTORE DHE PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE TË PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E QUMËSHITIT PËR PERIUdhËN 2014-2019	59
TABELA 10-4. MASA 101 E 103 E INVESTIMEVE NË ASETET FIZIKE NË FERMAT QUMËSHTORE DHE PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE TË PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E QUMËSHITIT PËR PERIUdhËN 2014-2019 DHE 2020/2021-2023	59
TABELA 10-5. MASA E 101 E INVESTIMEVE TË PLANIFIKUARA NË FERMAT E MISHIT TË GJEDHIT 2020/2021 – 2023	60
TABELA 10-6. MASA E 103 E INVESTIMEVE TË PLANIFIKUARA NË ASETET FIZIKE TË PËRPUNUESËVE TË MISHIT 2020/2021 – 2023	60
TABELA 10-7. MASA 101 E 103 E INVESTIMEVE NË ASETET FIZIKE NË FERMAT PËR TRASHJEN E VIQAVE (PËR MISH DHE PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE TË PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E MISHIT PËR PERIUdhËN 2014-2019 DHE 2020/2021-2023	60
TABELA 10-8. MBËSHETETJA FINANCIARE NGA ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR MBËSHETETJEN NË ASETET FIZIKE PËR FERMAT E LOPQËVE QUMËSHTORE DHE PËRPUNUESIT E QUMËSHITIT NËN IPA I DHE IPA II	60
TABELA 10-9. PËRMBLEDHJE E INVESTIMIT NGA MBPZHR DHE FONDET IPA TË BE 2014-2023	61
TABELA 10-10. PAGESAT DIREKTE 2014 – 2023	63
TABELA 10-11. NË VIJIM SHPJEGON POLITIKAT SHUMË TË FAVROSHME TË MBZPHR NË FERMAT E PRODHIMIT TË QUMËSHITIT.	64
TABELA 11-1. PRODHIMI I QUMËSHITIT TË LOPËS - ANALIZAT SWOT	65
TABELA 11-2. PËRPUNIMI I QUMËSHITIT - ANALIZAT SWOT	68
TABELA 11-3. PRODHIMI I MISHIT - ANALIZAT SWOT	70
TABELA 11-4. PËRPUNIMI I MISHIT - ANALIZAT SWOT	72
TABELA 14-1. PROPOZIMI I VLERËS NË € PËR LITËR QUMËSHIT SIPAS CILËSISË	79
TABELA 14-2. SKEMA E PROPOZUAR E SUBVENCIONEVE PËR CILËSINË E QUMËSHITIT NGA LOPËT QUMËSHTORE	80
TABELA 14-3. PLANI I VEPRIMIT PËR MBËSHETETJEN E SEKTORIT TË LOPËVE QUMËSHTORE	84
TABELA 14-4. PLANI I VEPRIMIT PËR MBËSHETETJEN E SEKTORIT TË MISHIT TË GJEDHIT	89

Akronime

ADA	Austrian Development Agency – Agjencia Austriake e zhvillimit
ABP	Animal by-products (ABP)s - Inspektimi i nënprodukteve shtazore
EB	Ekonomi bujqësore
PBZHR	Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
CEFTA	The Central European Free Trade Agreement - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
KE	Komisioni Evropian
EYE	Empowerment of young people - Përmirësimi i punësimit të të rinjve
IPA	The Instrument for Pre-accession Assistance - Instrumenti për Ndihmën e Para-anëtarësimit
IPARD	The Instrument for Pre-accession Assistance Rural Development - Instrumenti për Para-anëtarësimin për asistencë në Zhvillimin Rural
SHPQK	Shoqata e Prodhuesve të Qumështit në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SHIQK	Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës
AUV	Agjencia Ushqimit dhe Veterinarisë
FBO	Food business operator - operatori i biznesit ushqimor
PBV	Prodhimet Bruto Vendor
PMP	Praktika e mirë e prodhimit
HACCP	Hazard Analysis & Critical Control Point - Analiza e rreziqeve dhe e pikave kritike të kontrollit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
AZHB	Agjencia e zhvillimit të bujqësisë
PGQ	Pikat e Grumbullimit të Qumështit
AP	Agjencia e Pagesave
KC	Kontrolli i cilësisë
IHD	Investimet e huaja direkte
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
WB6	6 shtetet e Ballkanit Përendimor
TVSH-së	Tatimi në vlerës së shtuar
NIF	Numri identifikues i fermerit
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
DTN	Data Transmission Network

SRM	Supplier relationship management - Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit
ToR	Termet e referencës
UHT	Ultra-high temperature - Temperatura ultra-e lartë
SWOT	Strengths, weaknesses, opportunities, and threats - Përparësit, dobësitë, mundësit dhe rreziqet
OJQ	Organizatë jo qeveritare
NTB	Non-tariff barrier (Barrierat jo tarifore)
NJB	Njësi blegtorale
LQ	Lopë qumështore
B	Bovine - Gjedhi
P	Pigs – Derri
O	Ovis – Dele
A	Avian – Shpezë
SCC	Somatic cell count - Numri i qelizave për ml qumësht
GHG	Greenhouse gasses – gazrat serrë
FSS	Farm Structure Survey – Analiza strukturore e fermës
TIK	Teknologjitë e inovacionit dhe komunikimit
FBVUP	Fakulteti Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombtar
BSE	Bovine spongiform encephalopathy - sëmundja e lopës së çmendur
p.e	Production equivalent

1 Përmbledhje ekzekutive

Studimi i analizës së sektorit të blegtorisë (me theks të veçantë sektorin qumështor dhe mishor në gjedhëtarë) është hartuar për të ndihmuar Shoqatën e Prodhuesëve të Qumështit të Kosovës (SHPQK), në sigurimin e informacionit gjithëpërfshirës të nevojshëm për të vendosur mbi këshillimin e fermerëve, rritjen e anëtarësimit dhe qëndrueshmërinë e shoqatës dhe politikëbërësit në institucionet qeveritare të Kosovës të identifikojnë fushat prioritare për investime dhe mbështetje me fokus të veçantë në zinxhirin e furnizimit me qumësht nga lopët qumështore, dhe mish gjedhi. Ky studim do të ju shërben të gjithë aktorëve tjerë në zinxhirin e vlerës së këtyre dy produkteve kryesore blegtoriale në analizën e këtij sektori dhe marrjen e vendimeve në lidhje me aktivitetet e tyre, siq janë bankat, shoqatat me theks të veçantë SHPQK dhe SHIQK, organizatat e ndryshme ndërkombtare, kombtare, institucionet mikrofinanciare, individ, biznese, etj. Studimit sektorial është financuar nga fondet e WE EFFECT.

Ky studim në bazë të termave të referencave me qëllim të kompletimit si tërësi duhet të përmbush objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të tij.

- Si objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është:

Të mbështesë Shoqatën e Prodhuesëve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) në sigurimin e informacionit gjithëpërfshirës të nevojshëm për të vendosur mbi këshillimin e fermerëve, rritjen e anëtarësimit dhe qëndrueshmërinë e shoqatës dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në hartimin dhe zbatimin e politikës së saj bujqësore në përputhje me rregulloret dhe praktikën e BE-së të aplikueshme për këtë sektor dhe duke marrë parasysh ndërthurjen e objektivave në lidhje me mjedisin dhe ndryshimet klimatike, qasjen e bazuar në të drejtat, personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe barazinë gjinore.

Kurse si objektiva specifike janë si në vijim:

- Të japë një përshkrim sasior dhe cilësor të sektorëve përkatës të blegtorisë; të sigurojë një diagnozë të sektorit të blegtorisë, duke identifikuar ndër të tjera pengesat, dobësitë dhe pikat e forta për sa i përket produktivitetit, konkurrencës dhe kapacitetit për të hyrë në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Siguronë vendimmarrësve informacione të përditësuara, relevante dhe gjithëpërfshirëse të nevojshme për një programim dhe zbatim të mirë të programeve të pagesave direkte dhe të zhvillimit rural,
- Siguronë SHPQK-së informacionin gjithëpërfshirës të nevojshëm për të vendosur mbi këshillimin e fermerëve, rritjen e anëtarësimit dhe qëndrueshmërinë e shoqatës dhe
- Siguronë SHPQK-së dhe vendimmarrësve informacionin gjithëpërfshirës të nevojshëm për përcaktimin e masave të tregut dhe të pagesave direkte që mund të konsiderohen nën kuadrin financiar.

Analiza sektoriale për këtë sektor do të trajtojë: Prodhimin dhe përpunimin e qumështit nga lopët qumështore dhe prodhimin dhe përpunimin e mishit nga gjedhet.

Anëtarësimi i mundshëm i Kosovës në Bashkimin Evropian ngre mundësi dhe sfida të konsiderueshme për sektorin e blegtorisë në Kosovë. Për qëllime të procesit të pranimit në BE, sektori i blegtorisë në Kosovë do të duhet të përmirësojë efikasitetin dhe konkurrencën. Studimin i analizës së sektorit të blegtorisë motivohet nga nevoja për të kuptuar më mirë forcat që nxisin aftësinë konkurruese dhe efikasitetin e zinxhirit të furnizimit me qumësht, dhe mish.

Një nga problemet më të mëdha që ka penguar zhvillimin e sektorit të blegtorisë është se ka tregti të njëanshme të produkteve me origjinë shtazore në Kosovë. Nuk lejohet eksporti i produkteve me origjinë shtazore nga Kosova në vendet e BE-së. Vendet që dëshirojnë të eksportojnë produkte shtazore në BE duhet të përmbushin kërkesat e BE-së për shëndetin publik. Vendet eksportuese jo anëtare të BE-së duhet të autorizohen në Rregulloren Zbatuese 2021/405 për çdo mall që do të eksportohet në BE (Shtojca -I për planet e kontrollit; anekse të tjera për sigurinë ushqimore kur është e përshtatshme) e cila është në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamenti dhe Këshillit Evropian. Përveç kësaj, ka pengesa të ndryshme si NTB për eksportimin e produkteve me origjinë shtazore në vendet e rajonit. Si masë urgjente për zhvillimin e sektorit të blegtorisë në Kosovë është përmbushja e standardeve të sigurisë ushqimore dhe heqja e kufizimeve të eksportit në BE dhe në vendet e rajonit për produktet me origjinë shtazore. Në bazë të informacioneve nga përpunuesit e ushqimit për disa produkte specifike që ata prodhojnë, ka kërkesa të mëdha për eksport, por për shkak të problemeve të përmendura, ata nuk janë përpjekur deri më tani të eksportojnë produkte me origjinë shtazore. MBPZHR duhet të punojë ngushtë me AUV në identifikimin e problemeve, ku MBPZHR duhet të mbështesë kompanitë me investime në grante për të përmbushur këto standarde, ndërsa AUV duhet të punojë për zbatimin e ligjeve të sigurisë ushqimore dhe kërkesave të tjera që dalin nga rregulloret e eksportit të BE-së për produktet me origjinë shtazore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural po mbështet sektorin e blegtorisë në bazë të dy programeve të hartuara: Programin e Pagesave Direkte dhe Programit të Zhvillimit Rural. Një ndër qëllimet e studimit të analizës sektoriale në sektorin e blegtorisë është të analizohet zinxhiri i vlerës në këtë sektor me fokus të veçantë në vlerësimin e efektit të programit kombëtar për pagesa direkte dhe programit të skemës së granteve të zhvillimit rural, përkatësisht ndikimi i tyre në rritjen e prodhimit, përdorimit të tokës, të ardhurave bruto dhe zëvendësimit të importit për produktet dhe nënproduktet e qumështit (bulmetit), zinxhirit të furnizimit me mish dhe nën produkte të mishit. Rezultatet e studimit të analizës së sektorit të blegtorisë, treguan se programi kombëtar për pagesat direkte (subvencionet për krerë e aplikuar nga viti 2010, në shumën fillestare prej €30 për krerë dhe vazhduar deri në ditët e sotme në shumën prej €95) nuk patën performancë të mirë në rritjen e përdorimit të tokës, të ardhurave bruto, zëvendësimet e importit apo në shtimin e numrit të lopëve për qumësht, dhe gjedheve për mish, krahasuar me fermat e pambështetur (fermat jo përfituese).

Për më tepër, përkundër mbështetjes së qeverisë përmes pagesave direkte për gjatë viteve 2018 – 2023 që janë marrë për analizë, importet e produkteve blegtoriale u rritën në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa nga ana tjetër përdorimi i tokës dhe numri i lopëve, pati një rënie të lehtë përgjatë të njëjtës periudhë krahasuese. Si pike e vetme e fortë e programit kombëtar të pagesave direkte për prodhimin e qumështit ishin pagesa direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar (për klasen ekstra, klasen e parë dhe të dytë), e aplikuar për herë të parë gjatë vitit 2014. Në vitin 2023, 50% e mostrave totale të qumështit të papërpunuar të testuar ishin në kategorinë ekstra, ndërsa në vitin 2018, 40% e numrit të mostrave të qumështit ishin në kategorinë ekstra. Rritja e numrit të mostrave të qumështit të papërpunuar në kategorinë ekstra është tregues i mirë që pagesa direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar po ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe ky është një tregues pozitiv për të gjithë zinxhirin e furnizimit të qumështit.

Përcaktuesit kryesorë që ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit me qumësht dhe mish janë: përmirësimi i racave, intensifikimi i prodhimit të foragjereve në fermë, përmirësimi i normave të ushqimit, aplikimi teknologjive inovative në ujitje dhe përdorimi i sistemeve të mbajtjes së lopëve dhe gjedheve me sistem të lirë.

Duke marr për bazë rezultatet e të dhënave qeveritare dhe analizën e vlerësimit të ndikimit të programit të pagesave direkte, është thelbësore që Qeveria e Kosovës të rifreskojë programin e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë, skemën e subvencioneve për krerë duke mbajtur këtë për lopët e qumështit, dhe gjedheve për mish (pagesat e ndara/shkeputura nga prodhimi - decoupled) dhe qeveria duhet t'i rialokojë disa fonde nga pagesa direkte tjera, në pagesa për cilësinë e qumështit të papërpunuar, duke rritur pagesat premium për secilën kategori të qumështit të papërpunuar. Reforma e cilësisë së qumështit të papërpunuar duhet t'i përfshijë edhe subvencionimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar nga fermerët që merren me prodhimin e qumështit të cilët janë në kategorinë e tretë sa i përket cilësisë së qumështit. Kjo vlen për t'u siguruar fermerëve të vegjël të qumështit të kategorisë së tretë një stimulim për formalizimin e kanaleve të marketingut dhe për raportimin e prodhimit e të shitjeve të tyre, si dhe për të rritur numrin e fermerëve të regjistruar të qumështit – formalizimit të sektorit. Mbështetja e kombinuar, me pagesat direkte të bazuara në cilësinë e qumështit të papërpunuar do të rrisë formalizimin e sektorit të blegtorisë dhe do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave të fermave të qumështit, për analiza dhe kërkime sektoriale në të ardhmen. Kjo form e mbështetjes do t'i motivojë gjithashtu blegtorët të përmirësojnë praktikën e ushqimit të bagëtive, të ndryshojnë strukturën e mbarështimit me çka do të rrisin numrin e lopëve. Për t'i dhënë fermave qumështore të vogla dhe të mesme një shans real për qëndrueshmëri ekonomike, MBPZHR duhet të vazhdojë të mbështesë investimet në asetet fizike të fermave të qumështit, veçanërisht duke u përqendruar në fermat e mesme blegtorale të orientuara nga tregu. Për më tepër, qeveria duhet të promovojë sistemet e fermave me system të lirë të mbajtjes së kafshëve dhe të zgjerojë zonat e mbjella me kultura foragjere.

Nën-sektori i mishit konsiderohet të ketë një potencial të mirë në Kosovë, pasi kërkesa për produkte mishi është e lartë, dhe duke pasur parasysh qasjen e duhur, mund të ndikojë në rritjen e përgjithshme të ekonomisë. Vetëm disa ferma janë përqendruar në majmëri intensive me një numër relativisht të ulët krerësh. Prandaj, pjesa më e madhe e mishit të përdorur për përpunim importohet dhe mishi i freskët i sapo therur shitet vetëm në dyqanet e mishit (mishtore). Prioritetet kryesore të propozuara të harmonizimit me BE-në lidheshin me uljen e kostos së lartë të prodhimit përmes përmirësimit të fermave (ambienteve dhe pajisjeve), rritjen e përmasave të fermave të vogla dhe rritjen e konsolidimit të tokës, mbështetjen e fermerëve me pagesa direkte në mënyrë që të jenë më konkurrues në treg, rritjen e kontrollit të cilësisë së mishit të ngrirë të importuar, rritjen e prodhimit vendas të misrit dhe silazhit të misrit që kërkohet për të mbështetur rritjen e kërkesës për lëndë ushqimore, përmirësimin e menaxhimit të kullotave etj.

2 Metodologjia

Qëllimi i përgjithshëm është përgatitja e studimit/analizës për sektorin e blegtorisë që përshkruan në detaje nënsektorët (qumështin, dhe mishin) duke u fokusuar tek ofrimi i të dhënave për rifreskimin e Programi kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural 2023-27, Programet vjetore të zhvillimit rural, Programet e pagesave direkte që janë pjesë integrale e strategjisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural 2022 – 2028, për sektorin e blegtorisë bazuar në evidencë dhe të dhëna si dhe si të krijohet qëndrueshmëria e SHPQK, si të zhvillohen shërbimet e reja të SHPQK dhe si të zhvillohet më tutje tarifa e anëtarësimit.

Në mënyrë që arrihet përmbushja e qëllimit dhe të objektivave specifike të studimit, janë përdorur dy metoda për mbledhjen e të dhënave: studimi me bazë dokumentacionin, apo “hulumtimi në tavolinë” dhe studimi cilësor, apo mbledhja e të dhënave në terren. Studimi me bazë dokumentacionin u fokusua te mbledhja dhe analizimi i të dhënave dytësore për sektorin e blegtorisë në Kosovë nga burime të ndryshme dhe nga ana tjetër, studimi cilësor përdori vetëm një teknikë kërkimore: intervistat me fermer komercial të prodhimit të qumështit dhe mishit, kryetarët e dy shoqatave nacionale të prodhimit dhe përpunimit të qumështit, duke përfshirë ekspertët e sektorit privat dhe publik, pronar të therrëtoreve, përpunues qumështi dhe mishi në çdo fazë të zinxhirit të vlerës.

Tek burimet dytësore për mbledhjen dhe analizën sasiore të të dhënave dytësore përfshin Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZH), Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë e (AZHB), Agjencia e Kosovës për Statistikat (ASK) dhe raporte të ndryshme nga shoqatat e prodhuesëve, dhe organizatat e ndryshme ndërkombetare për bashkëpunim dhe zhvillim dhe burime të tjerë. Një tjetër komponent i studimit në tavolinë ishte edhe studimi i bazës së të dhënave që ishin në përdorim nga MBPZH/AZHB, ASK, dhe AUVK.

3 Konteksti dhe të dhënat kryesore të sektorit të blegtorisë

Zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe kalimi tek ekonomia me bazë tregun ka qenë i ngadaltë dhe i vështirë. Kosova është një vend i vogël, i mbyllur, pa qasje në det, me sipërfaqe totale prej 1,1 milionë hektarësh, ku 53% e tokës së Kosovës është bujqësore, 44% është tokë pyjore, 1% është sipërfaqe ujore, kurse 5% janë sipërfaqe të tjera p.sh., rrugë, urbane dhe toka të tjera. Blegtoria në veçanti është e një rëndësie thelbësore për Kosovën si në aspektin social, ashtu edhe në atë ekonomik; sidomos në kohë të vështira ekonomike, bujqësia është shtylla kurrizore e zhvillimit ekonomik në zonat rurale.

Sipas Anketës të Fuqisë Punëtore 2023¹, Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1,171,763) janë popullsi në moshë pune. Persona aktivë ishin 477,350. Persona joaktivë ishin 694,413. Persona të punësuar ishin 425,499. Persona të papunësuar ishin 51,851.

Numri i forcës aktive të punës (15-64 vjeç) është 477,350 (meshkuj: 333,019; femra: 144,331), të punësuarit (15-64 vjeç): 425,499 (meshkuj: 307,509 femra: 117,990)

Sektori i tregtisë është kontribuesi më i madh i punësimit në Kosovë me 20%, pasuar nga ndërtimtaria me 11,8%, Arsimi 9.9% ndërsa bujqësia kontribuon me mbi 2.4% të shkallës së punësimit, në pjesëmarrjen në punësim sipas aktiviteteve.

Në vitin 2022, sektori i bujqësisë në Kosovë kontribuoi rreth 7.4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit.

¹ <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8237>

Blegtoria dhe në veçanti, nënsektori i qumështit, mbetet aktiviteti kryesor i biznesit në të gjitha zonat rurale të Kosovës. Me perspektivën e anëtarësimit përfundimisht në BE, sektori i qumështit në Kosovë përballet me sfidën e transformimit nga një sektor joefikas fermash të vogla qumështi në një sektor që përfundimisht duhet të konkurrojë me industrinë shumë efikase të qumështit të BE. Me rritjen e konkurrencës në nivel global është shumë e rëndësishme që fermerët e qumështit në Kosovë të përmirësojnë cilësinë e qumështit dhe të rrisin efikasitetin e prodhimit të qumështit. Eksportet e prodhimeve bujqësore kanë ndryshuar ndjeshëm nëse krahasohen ndërmjet viteve 2022 dhe 2021 në raport me vitet 2016 dhe 2015. Eksportet janë rritur vetëm 2.4% krahasuar vitet 2016 me vitin 2015. Por nëse krahasohet përqindja e eksportit në mes viteve 2022 dhe 2021, atëherë kemi një rritje signifikante prej 24.8%. Vlera eksporteve ka arritur €118.9 milion. Importet u rritën në mënyrë të qëndrueshme si një trend. Në periudhën 2019-2020, vlera e importeve ishte mbi €1.5 miliardë, ndërsa në periudhën 2021-2022 vlera e importeve u rrit në mbi €2.1 miliardë. Në 2022-ën, vlera e importeve shfaqet përsëri me një rritje të madhe prej 21.4% krahasuar me 2021². Vlera e eksporteve të prodhimit të blegtorisë në vitin 2022 ishte €11.56 milion kurse vlera e importeve të prodhimit të blegtorisë ishte €280.2 milion me një deficit tregtar në bilancin tregtar prej €268.6 milion³.

3.1 Gjendja aktuale e sektorit të qumështit

3.1.1 Qumështi i lopës

Sektori i qumështit të lopës në Kosovë është duke u zhvilluar sipas trendeve në rajon, zvogëlimi i krerëve të lopëve qumështore, zvogëlimi i numrit të fermave por kemi një rritje të lopëve qumështore brenda kopesë, që është një faktor kyq se kemi të bëjmë me një trend pozitiv të konsolidimit të fermave blegtorale posaqërisht në gjedhtari. Është e dukshme se shumë përpjekje janë bërë vitet e fundit mbështetur nga MBPZHR dhe organizata të tjera ndërkombëtare, të donatorëve, drejtoritë komunale për zhvillim ekonomik, donatorët lokal etj.. Është gjithashtu e qartë se ka investime të mëdha si në krerë të lopëve qumështore, ashtu edhe në objekte. MBPZHR vlerëson se në vitin 2022 sektori i blegtorisë gjeneroi një vlerë vjetore prej €175.5 milionë produkte blegtorale. Qumështi është produkti më i rëndësishëm i këtij sektori dhe në vitin 2022 kontribuoi me €119,1 milionë ose shprehur në 68% në vlerën e prodhimit nga vlera totale prej €175,5 milionë në produktet blegtorale kurse vezët vlera totale e prodhimit €38.4 milion ose shprehur në 22%. Këto dy produkte blegtorale (qumështi dhe vezët) paraqesin gati 90% të produkteve blegtorale, kurse pjesa mbetur produktet tjera blegtorale nga delet, dhitë etj⁴.

I nxitur nga çmimet e mira të qumështit (€0,46 - 0,51 për litër) dhe nga mungesa e kufizuar e mundësive alternative për gjenerimin e të ardhurave, numri i fermave komerciale të qumështit në dhjetë vitshin e fundit është pritur të rriten ndjeshëm në Kosovë, por kjo realisht nuk ka ndodhur, dhe se një ndër arsytet është emigrimi masiv dhe ndikimi kushteve klimatike; gjithashtu, prodhimi i qumështit për lopë për fermat e vogla është rreth 2,100 l/laktacion (që kanë raca tradicionale dhe nuk ju përmbahen praktikave të mira bujqësore) dhe për fermat komerciale rreth 5,000 l/laktacion. Rendimenti mesatar i dukshëm i qumështit për lopë në BE arriti në 7,653 (L në laktacion në vitin 2022⁵). Sipas Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit në Kosovë (SHPQK) ka 1,286 fermerë komercialë të qumështit, të cilët i tregtojnë produktet e tyre të freskëta të qumështit përmes kanaleve komerciale.

² https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 95

³ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 95

⁴ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 23

⁵ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Milk_and_milk_product_statistics

Industria e qumështit në Kosovë përbëhet nga 44 fabrika për përpunim të qumështit, prej tyre 4 fabrika të qumështit janë jo aktive dhe 1 fabrikë e qumështit merret vetëm me grumbullimin e qumështit, bazuar në bazën e të dhënave marr nga AUVK. Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë për qumështin e lopës dhe produktet e qumështit, në Kosovë në vitin 2022 është 81.3%. Produktet lokale të qumështit mbulojnë të paktën një të tretën e kërkesës së tregut për produkte të përpunuara të qumështit në Kosovë. Industria ka identifikuar shumë pengesa që e ndalin këtë potencial ekonomik. Si probleme thelbësore konsiderohet kuadri ligjor, duke përfshirë mungesën e rregulloreve për standardet e identitetit të qumështit e të produkteve të qumështit dhe kualifikimi i ulët i bujqësisë, por gjithashtu problem konsiderohen edhe produktet e qumështit që vijnë nga importi i vendeve të BE-së dhe produkteve që supozohet se subvencionohen për eksport sidomos nga prodhuesit e vendeve të rajonit. Fermerët dhe përpunuesit e qumështit nga vendet eksportuese po marrin rimbursime direkte ose indirekte për eksport të produkteve të tyre si dhe shitjet në "tregun e gjelbër" rreth (26.7%), po shihen si pengesa më e madhe për industrinë e qumështit dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për të zhvilluar një sektor konkurrues të qumështit, së pari është e nevojshme të kuptojmë kufizimet aktuale. Prodhimi i ulët i qumështit i raportuar shkaktohet kryesisht nga ushqimi jo i përshtatshëm i lopëve qumështore, keqmenaxhimi i fermës, ndikimi i ndryshimeve klimatike nga stresi nxehtësisë, thatësitrat kronike gjatë fazave kryesore të rritjes së misrit (korrik-gusht) dhe potenciali i dobët gjenetik i racave të përdorura për qumësht. Sfidat kryesore me të cilat përballlet industria variojnë nga cilësia e dobët e qumështit, produktiviteti dhe efikasiteti i ulët i fermave të blegtorisë. Një prej burimeve të efikasitetit të ulët të prodhimit të qumështit në Kosovë mund t'i atribuohet përdorimit joproporcional të përbërësve të ushqimit. Për shembull, kostot e foragjereve dhe ushqimit të koncentruar shpesh mbeten të larta në fermat e qumështit në Kosovë. Në vlerësimin e efikasitetit të prodhimit të qumështit janë me rëndësi jetike rritja e rendimentit mesatar të qumështit dhe ulja e kostove të ushqimit. Tejkalimi i këtyre sfidave mund ta ndihmojë qeverinë të arrijë qëllimet e saj në produktivitetin e qumështit dhe në përmirësimet e cilësisë së qumështit duke çuar në rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit vendas të qumështit dhe duke gjeneruar fitime të qëndrueshme për prodhuesit e qumështit.

Gjedhet ushqehen kryesisht në stalla (hapësira të mbyllura) dhe jo në kullota, gjë që rrit koston. Sana është ushqimi më i zakonshëm gjatë kohës së dimrit. Sana është përbërje barërash (në livadhe dhe të mbjella natyrore) ose jonxhe. Prodhimi i silazhit po rritet, gjë që redukton kostot e prodhimit të produkteve shtazore. Prodhimi i silazhit sjell gjithashtu më shumë siguri për fermerët për ushqimin e dimrit, por prodhimet/rendimentet janë ende të ndryshueshme dhe varen nga reshjet e shiut gjatë periudhës vegetative të kultivimit të drithërave dhe kulturave foragjere. Në rajonet me ujtitje, fermerët arrijnë rezultate më të mira ose që kulturat e tyre të mbjellura ujiten me sisteme të ujites formale ose joformale. Ndryshimet klimatike kanë sjell pasoja shumë të mëdha në sektorin e qumështit, gjegjësisht në bazën e tyre ushqimore, nëse marrim parasysh vitin 2023 ku në bazë të dhënave meteorologjike të marra nga një kompani ndërkombtare që merren me matjen e reshjeve dhe mbledhjen e parametrave meteorologjik, sasia e reshjeve gjatë muajëve kyq për kulturën e misrit janë shumë të ulëta (korrik – gusht). Këto të dhëna janë marr nga software-i i sigurimeve bujqësore i cili i merr të dhënat satelitore të motit nga kompania DTN, me seli në Shtete të Bashkuara të Amerikës dhe Holande <https://www.dtn.com/contact-us/>. Në vitin 2023 reshjet e shiut në korrik kanë qenë 16 mm/m² kurse në gusht vetëm 15 mm/m², përkundër nevojave të misrit në praktikat e mira të ujites 120 mm/m² në muajin korrik dhe 75 mm/m² në muajin gusht. Kjo don të thotë se kemi pasur rendiment shumë të ultë dhe jo kualitativ të misrit kokërr dhe sillazh së paku deri 50% më të ulët dhe nga stresi i nxehtësisë zvogëlim të prodhimit të qumështit deri në 20% gjatë muajëve të verës (korrik – gusht). Humbjet konsiderohen €27 milion.

Prandaj Qeveria, institucionet financiare, BE duhet të mendojnë më shumë në investimet kapitale në ujitje dhe teknologjitë moderne të ujitjes. Thatësitat me një frekuencë dhe ashpërsi të lartë gjatë 20 viteve të para të shekullit 21 janë faktori më limitues në sektorin e prodhimit blegtoral me theks të veçantë në sektorin e qumështit nga lopët qumështore dhe prodhimi mishit të gjedhit. Deri sa fermerët që merren me kultivimin e pemëve dhe perimeve kultivojnë vetëm atëherë kur kanë ujë të siguar për ujitje, fermerët që merren me rritjen e gjedheve duhet të kultivojnë misër edhe kur nuk kanë sisteme të ujitjes, sepse ata duhet të tentojnë të prodhojnë ushqime të tyre. Siq dihet globalisht dëmet më të mëdha në bujqësi shkaktohen nga thatësia me pjesëmarrje 75%, nga ngricat pranverore 20% dhe reshjet e tepërta dhe breshëri 5%. MBPZHR-ja duhet të kompensojë prodhuesit e qumështit të cilët kanë humbje jashtëzakonisht të mëdha për shkak të temperaturave të larta (thatësisë në vitet 2023 dhe 2024). Gjatë këtyre dy viteve prodhuesit e qumështit kanë pasur humbje në rendiment në kultivimin e misrit prej 50%, zvogëlim të humbjeve në prodhimin e qumështit për shkak të stresit të nxehtësisë prej 20% në dy muajt ekstrem të verës (korrik dhe gusht), si dhe një bazë e dobët ushqimore për shkak se rendimenteve të ulta dhe cilësi jo kualitative. Humbjet nga ushqimi jo kualitativë nuk janë llogaritur por se efekti i këtyre ushqimeve ka ndikim të lartë në humbje të fermerëve. Pra fermerët nuk mund të sigurojnë bazë të mjaftueshme ushqyese, jo kualitative jo vetëm për misër por edhe kulturat tjera foragjere.

Lopët qumështore duhet të ushqehen siç duhet nëse dëshirojmë që të marrim sasi më të lartë të qumështit prej tyre. Nëse ushqehet mirë, lopa është e shëndetshme, ka kondicion më të mirë dhe mbarësohet rregullisht, gjë që siguron prodhimin të mirë të qumështit. Veçanërisht kur bëhet fjalë për lopë me produktivitet të lartë siç është rasti me racën Holstein, ushqyerja është shumë e rëndësishme. Nëse Holsteini merr ushqim me lëndë me energji shumë të ulët, ajo humb peshë, sëmuret më lehtë dhe prodhon më pak qumësht. Racat vendore mund të mbijetojnë me më pak ushqim, por potenciali i tyre gjenetik për të prodhuar sasi të mëdha qumështi është më i ulët. Ripërtpësisht si p.sh. lopët qumështore kërkojnë foragjere të mira, si dhe nevojitet sasi më e madhe e ushqimit të koncentruar. Lopët duhet ta kenë gjithmonë qasje të lirë në ushqim voluminoz dhe foragjere. Lopët në fazën e tharjes/shterpës kanë nevojë të ushqehen me lëndë ushqyese si ushqim voluminoz dhe foragjere, por nuk duhet të ushqehet shumë sidomos me ushqim të koncentruar. Lloji i barit që zgjidhet është shumë i rëndësishëm: bari duhet të jetë i përshtatshëm si për gjedhe ashtu por edhe për sipërfaqen e kultivuar.

Në Kosovë akoma janë prezente në një shkallë të lartë kryqëzimet në mbarësim me origjinë nga raca vendore si p.sh. Busha. Përgjithësisht, kjo lloj race karakterizohet me shkallë të ulët prodhimi, por njihet për rezistencë të lartë ndaj sëmundjeve të ndryshme dhe përshtatje të mirë ndaj kushteve ekstensive të mbarështimit. Së fundmi, në fermat komerciale mund të shihen kryqëzime të racave të importuara si: Simmental, Holstein, Brown Swiss.

Praktika e mbarësimit të lopëve në Kosovë bazohet te mbarështimi natyral dhe artificial. Mbarështimet natyrore janë dukshëm më të përdorura. Mbarësimet e pasuksesshme, mungesa e zbulimit në kohë të estrusit dhe dështimet e tjera kanë çuar në përdorimin e mbarështimit artificial me shkallë më të ulët edhe në fermat komerciale.

Gjatë viteve të fundit, rrjeti i furnizimit të industrisë së përpunimit të qumështit është zhvilluar mjaft mirë, pasi fermerët dhe industria e përpunimit kanë dakordësuar nënshkrimin e marrëveshjeve të furnizimit të qumështit të papërpunuar dhe që të cilat kanë ulur intensitetin e lëvizjeve të fermerëve nga një fabrikë përpunimi qumështi në një tjetër. Duke krijuar qendra të reja për grumbullimin e qumështit dhe pajisjen e fermerëve me pajisje ftohëse qumështi, efikasiteti i mbledhjes së qumështit është rritur dhe cilësia e qumështit është përmirësuar.

Në Kosovë ka rreth 52 pika për grumbullimin e qumështit (PGQ) që e marrin qumështin nga fermerët, e ftohin dhe dorëzojnë të papërpunuar te përpunuesit e qumështit. PGQ-të janë përgjegjëse për kryerjen e analizave bazë të qumështit për çdo fermer ofruer, si dhe të japin komentet e tyre mbi cilësinë dhe kushtet e pagesës për fermerin e qumështit. PGQ-ja është, në një farë mënyre, ndërmjetësuese për fermerin e qumështit dhe përpunuesin e qumështit, e cila merr një pagesë përqindjeje për ndërmjetësimin e transaksionit. Ka dy lloje PGQ-sh: janë ato që janë të vendosura në një fermë të madhe, e cila mbledh prodhimin e fermës së saj, por merr edhe qumështin e fermerëve të tjerë në afërsi. Si dhe, PGQ që nuk janë të vendosura në asnjë fermë qumështi, por operojnë si biznese ndërmjetësuese dhe që jo vetëm mbledhin qumështin e fermerëve, por edhe bëjnë dërgimin te përpunuesit e qumështit.

Gjatë viteve të fundit, me grantet e investimeve të MBPZHR-së dhe me donatorë të tjerë, pikat e grumbullimit të qumështit kanë përmirësuar gjendjen ku kanë instaluar pajisje ftohëse, pajisje për grumbullimin e qumështit dhe për transportimin e qumështit nga PGQ-të në përpunuesit e qumështit. Shumica e pikave të grumbullimit përmbushin standardet e sigurisë ushqimore, por kanë ende nevojë për investime që të rrisin sigurinë ushqimore dhe të zbatojnë standardet e sigurisë ushqimore.

Kosova varet shumë nga ushqimet e importuara për kafshë si: misri kokërr, soja dhe luledielli, si dhe nga përzierjet e plota dhe shtesë ushqimore (kombinimi i proteinave, mineraleve dhe vitaminave).

3.2 Gjendja aktuale e sektorit të mishit (gjedhit)

Industria e mishit në Kosovë mund të përshkruhet si e fragmentuar dhe jo e plotë. Një numër i madh fermash të vogla gjedhesh dhe mishtoret private dominojnë industrinë. Sektori i prodhimit të mishit në Kosovë është i dominuar nga fermat ekzistenciale me tufa me më pak se nëntë gjedhe. Në vitin 2022, vetëmjaftueshmëria nga fermat lokale të gjedheve furnizuan 40.1% të nevojës së tregut të Kosovës për mish viçi, ndërsa bilanci i mbetur prej rreth 59.9% u importua⁶. Në vitin 2022, importi i mishit të freskët dhe të ngrirë të gjedhit arriti në €115,2 milionë. Konsumi i përgjithshëm i mishit të gjedhit për frymë në Kosovë llogaritet të jetë rreth 20 kg vit (mish viçi). Konsumi aktual për frymë i mishit të gjedheve në Kosovë është ende i ulët kur krahasohet me vendet e EJLQ-së (vendet e Evropës Jug Lindore Qendrore) dhe me vendet e BE-së. Sidoqoftë, me rritjen ekonomike pritet rritja e kërkesës, ashtu si edhe konsumi i mishit dhe produkteve të mishit në Kosovë. Sipas AUV, Kosova ka 59 thertore të licencuara për therrjen e gjedheve, deleve dhe derrave (thundrakëve), 19 prej tyre i kryejnë dy aktivitetet në të njëjtën periudhë kohore: therrjen dhe përpunojnë mish dhe 7 thertore për therrjen e pulave⁷. Po ashtu janë të regjistruara edhe 62 operator që merren me përpunimin e mishit si aktivitetet i vetëm. Këto të dhëna në lidhje me këta operator janë marr nga një bazë e të dhënave në webfaqen e AUK. Aktualisht, përpunuesit e mishit po prodhojnë kryesisht produkte si: sallam, sallam hamburgeri me mish të thatë, hot-dog. Si rezultat i furnizimit të pamjaftueshëm të produkteve primare nga blegtorët e Kosovës, përpunuesit vendorë të mishit importojnë 80% të lëndës së parë për të përmbushur nevojat e tyre të prodhimit. Mëqenëse përqindja e importeve të mishit është rritur vazhdimisht në pesë vitet e fundit, Kosova vazhdon të importojë kafshë si peshë të gjallë dhe gjithashtu mish karkasash/mish të ngrirë për të përmbushur kërkesat e tregut.

Një pjesë e mishit të tregtuar në Kosovë vjen nga therrja e kryer jashtë thertoreve të autorizuar. Megjithatë procesi i therrjes mbikëqyret nga kasapë me përvojë, mungon garancia për higjienën e operacioneve të kryera pa mbikëqyrje veterinarë.

⁶ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 70

⁷ Burimi: AUVK,

Duke qenë se një nga shtyllat e sistemit të sigurisë ushqimore është qasja “nga ferma tek piruni”, agjencia duhet ta rregullojë me ligje specifike këtë sektor me përjashtime të parashikuara për disa operatorë dhe produkte. Qëllimi përfundimtar është që të gjithë operatorët që punojnë në këtë sektor të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore dhe kërkesat e tregut.

Situata aktuale e therrtove në Kosovë nuk është inkurajuese, duke qenë se procedurat sanitare dhe trajtimi human i kafshëve para therjes janë pothuajse inekzistente. Problemi kryesor në sektorin e mishit të viçit është mungesa e sasisë së furnizuar të mishit të viçit. Therrtoret janë të vjetruara dhe kryesisht të vetë-dizajnuara nga pronarët. Shumica e therrtove janë manuale dhe shumë joefikase në krahasim me thertoret e automatizuara rajonale dhe të BE-së. Shumica e tyre janë të përfshirë në përpunim, por pa paketim cilësor. Si rezultat, prodhuesit dhe përpunuesit vendas të mishit të viçit furnizojnë vetëm restorante dhe dyqane të shitjes së mishit me pakicë, ndërsa është pothuajse e pamundur të furnizosh supermarkete të mëdha pa krijuar një emër “brend” dhe pa përmirësuar materialet e paketimit. Kjo situatë çon në sezonalitet të lartë të biznesit. Gjatë sezonit të verës kur restorantet frekuentohen më shumë dhe që konsiderohet sezoni i dasmave, kërkesa për mishin e viçit të prodhuar dhe të përpunuar në vend është shumë e lartë. Megjithatë, jashtë sezonit, qarkullimi i impianteve të përpunimit të viçit bie pasi kërkesa nga restorantet zvogëlohet. Problemi i sezonalitetit transferohet më pas drejtpërdrejt te fermerët, të cilëve u mungon furnizimi me viça për therrje dhe të cilët nuk arrijnë të konsolidohen në ferma komerciale. Për më tepër, praktikat e fermave janë shumë të dobëta dhe të dhënat mbi gjurmueshmërinë dhe regjistrimin e kafshëve mungojnë dukshëm. Zhvendosja e kafshëve të therrura nuk bëhet siç duhet dhe kafshët e therrura nga fermerët nuk raportohen. Rregulloret e inspektimit të mishit duhet të zbatohen rregullisht. Në shumicën e dyqaneve të mishit, karkasat varen në vitrinat e dyqaneve pa ftohje, direkt nën rrezet e diellit dhe/ose mbahen në frigoriferë të vegjël në dyqan. Dyqanet më të vogla të mishit nuk kanë kamionë frigoriferë për transportimin e mishit të freskët dhe nuk kanë as depo për ftohje me temperatur të kontrolluar për ruajtjen e duhur të mishit. Shumë dyqane të vegjël kanë frigoriferë të thjeshtë ku ata ruajnë karkasat/mishin e freskët pasi të jetë varur në vitrinat e dyqaneve pa frigorifer gjatë ditës.

Prodhimi lokal i të gjitha kategorive të mishit është relativisht i vogël në krahasim me tregun e përgjithshëm. Duk qenë se kuzhina e Kosovës ka preferencë të fortë për mish, dhe me furnizimin lokal që nuk plotëson kërkesën totale, vëllimi dhe vlera e importeve të mishit janë shumë të larta. Importet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme janë rritur vazhdimisht që nga viti 2018. Në vitin 2020, importet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme ishin rreth €49.9 milionë, ndërsa në vitin 2021 importet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme arritën rreth €75.5 milionë. Rritja e importeve në vitin 2022 ishte 42% krahasuar me vitin 2021.

Industria e përpunimit të mishit në Kosovë varet shumë nga importet e mishit të papërpunuar. Qendrat e therrtove, përpunimit dhe magazinimit të produkteve me origjinë shtazore ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Qendrat e therrtove;
- Qendrat për përpunimin e mishit dhe përgatitjen e produkteve me origjinë shtazore;
- Qendrat për ftohjen, ngrirjen dhe magazinimin e produkteve me origjinë shtazore.

AUV hartoi një strategji për ndërtimin e qendrave të produkteve të kategorisë I dhe II dhe të qendrave të tjera për trajtimin e produkteve të Kategorisë III.

Hapi tjetër që do të ndërmerret është përafrimit të inspektimit të Produkteve Shtazore (ABP - Animal by Product) me legjislacionin e BE-së, pasi nuk ka akoma Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit (SRM - Supplier Relationship Management)-së dhe të produkteve shtazore. Burime njerëzore shtesë do të alokohen për zbatimin e legjislacionit në terren dhe mbështetje do t'u ofrohet FBO (Food business operators)-ve pasi ato nuk kanë asnjë sistem për mbledhjen dhe asgjësimin e ABP/SRM.

3.3 Sipërfaqja e tokës, toka e punueshme

Sipërfaqja e kultivuar me kulturave foragjere dhe drithëra nuk është rrit në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2018. Kurse vetëm sa për ilustrim të kësaj që u përshkrua është se diferenca në mes vitit 2022 në raport me vitin 2021, është vetëm 0.02%⁸. Kjo tendencë e “ngecjes” së sipërfaqes së kultivimit me kultura foragjere nuk është e mirë për sektorin e qumështit pasi nuk përmirësohet programin e ushqimit të gjedheve për qumësht dhe mbetet konstant efikasitetin e prodhimit të qumështit duke mos ndikuar në uljen koston e ushqimit të lopës së qumështit, pra fermat nuk do të jenë efikase dhe konkruuese.

Foragjeret janë pjesë e rëndësishme e çdo racioni të lopëve të qumështit. Përfshirja më e lartë e ushqimeve me cilësi të lartë në racionin e lopëve qumështore do të ruajë shëndetin e rumenit të kafshëve ripërtypëse, do të përmirësojë përbërësit e qumështit dhe do të rrisë të kontribuoj në rritjen e të ardhurave për njësi. Në vitin 2022, sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me kultura foragjere dhe drithëra të korrura të gjelbra ishte 108,551 ha, e cila ishte ulur me 9 ha krahasuar me një vit më parë. Të lashtat që kanë pësuar rënie më të theksuar e sipërfaqes janë: misri i gjelbër me 4.9% dhe kulturat e tjera foragjere të gjelbra me 3%, ndërsa kulturat e tjera kanë shënuar rritje të vogël të sipërfaqes. Prodhimi i të gjithëve kulturat janë rritur, me përjashtim të misrit të gjelbër dhe kulturave të tjera të gjelbra foragjere, që ka pasur një ulje, për shkak të zvogëlimit të sipërfaqes, sepse rendimenti është rritur në të gjitha kulturat.

Tabela 3-1. Sipërfaqja e foragjereve/ha 2018-2022

	2018	2019	2020	2021	2022
Foragjere dhe drithërat e korrur e gjelbër	107,099	108,480	108,436	108,560	108,551
Misër (gjelbër)	7,085	7,082	7,037	7,061	7,080
Misër (gjelbër) - kultur dytësore	212	304	205	210	200
Sanë (livadhe)	70,679	70,679	70,717	70,723	70,736
Bar	9,200	9,253	9,261	9,293	9,316
Jonxhë	17,182	18,293	18,329	18,360	18,359
Tërfil	854	901	904	931	938
Foragjere të tjera gjelbër	1,887	1,967	1,984	1,982	1,922

Burimi: Raporti i Gjelbër 2023

⁸ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 41

Tabela 3-2. Prodhimi i foragjereve/ton, 2018-2022 (Ton)

Kulturat	2018	2019	2020	2021	2022
Foragjere dhe drithëra të korrur jeshilë	480,966	504,406	503,758	481,952	493,955
Misër (gjelbër) sillazh	109,532	118,504	120,653	118,937	120,088
Misër (gjelbër) - kultur dytësore	2,260	4,322	2,851	2,875	2,807
Sanë (livadhe)	249,559	249,683	247,921	233,323	240,783
Bar	30,786	31,689	30,584	28,819	29,542
Jonxhë	73,754	84,257	85,503	82,330	85,044
Tërfil	3,065	3,446	3,652	3,551	3,703
Foragjere të tjera gjelbër	12,010	12,506	12,595	12,117	11,986

Rendimenti për hektarë i kulturave foragjere është përmirësuar me kalimin e viteve, pasi fermerët i kanë zgjeruar njohuritë për prodhimin dhe e shohin rolin dhe efektin në prodhimin e qumështit. Rritja më e madhe në rendimentin për hektar vërehet në prodhimin e jonxhës midis viteve 2018 deri 2022 me 15% ndërsa 3% ishte rritja e rendimentit për hektar jonxhë në 2022 krahasuar me 2021. Rritja e dytë më e madhe në rendimentin për hektar vërehet te silazhi i misrit midis viteve 2018 deri 2022 me 9.6%, ndërsa 1% ishte rritja e rendimentit për hektar të silazhit të misrit në 2022 krahasuar me 2021

3.4 Punësimi aktual dhe potencial

Toka bujqësore e Kosovës është e një cilësie të lartë dhe përbën më shumë se gjysmën e shfrytëzimit të tokës së saj. Bujqësia ka qenë gjithmonë sektor kyç në ekonominë e Kosovës, por ka rënë ndjeshëm gjatë dhe pas luftës. Sektori i bujqësisë përlllogaritet se zë 26,7% të punësimit të përgjithshëm dhe produktet bujqësore përbëjnë rreth 12.91% të vlerës totale të eksportit⁹. Sektori është i kufizuar nga fragmentimi i tokës dhe madhësia e vogël e parcelave bujqësore. Kjo gjë ka paraqitur problem për ruajtjen e prodhimeve përkatëse bujqësore, duke çuar në ulje të prodhimit bujqësor dhe humbje ekonomike në nivel familjar, lokal dhe kombëtar.

Sektori i blegtorisë është i një rëndësie të madhe për bujqësinë e Kosovës; megjithatë, ndikimi i tij mbetet ende i ulët për sa i përket krijimit të vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave. Edhe pse supozohet se sektori i blegtorisë ka potencial të lartë, ende nuk ka informacione për përfitueshmërinë e bizneseve të këtij sektori. Që prej vitit 2013, MBPZHR-ja ka nisur mbështetjen për fermerët që merren me prodhimin dhe përpunimin e qumështit, dhe mishit, i cili pritet të krijojë një sistem funksional mes prodhuesve dhe përpunuesve. Potenciali më i lartë për krijimin e vendeve të punës është në vlerën e shtuar dhe në përpunimin e produkteve të qumështit e mishit për tregjet lokale, si dhe eventualisht në prodhimin e produkteve të veçanta për vendet e rajonit me tradita të ngjashme konsumi. Përmirësimi i prodhimeve dhe mbështetja ndaj prodhuesve të qumështit, dhe mishit për rritjen e madhësive të fermave do të rrisë ofertën dhe vendet e punës në ferma, ndërsa po në të njëjtën kohë, do t'u mundësojë përpunuesve të rrisin shfrytëzimin e kapaciteteve të tyre, duke pasur efekt pozitiv në krijimin e vendeve të punës përmes rritjes së numrit të zhvendosjes së prodhimit.

Në bazë të raporteve të studimit dhe të vlerësimeve të ekspertëve që u takuan nga eksperti angazhuar, në kuadër të prodhimit blegtoral, potenciali është krijimi i më shumë se 12,500 vendeve të reja të punës në 5 vitet e ardhshme, kryesisht në nënsektorin e qumështit, dhe mishit. Potenciali për krijimin e vendeve të punës është më i fokusuar të përpunimi.

⁹ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 87

Në mënyrë që fermerët të rrisin tufat dhe kapacitetin prodhues, duhet të bëhen një sërë rregullimesh. Prodhuesit kanë nevojë për infrastrukturë më të mirë, më shumë tokë për prodhimin e ushqimit dhe për përmirësimin e aftësive të menaxhimit, veçanërisht për fermat më të mëdha. Aktualisht, vetëm fermat me më shumë se 10 lopë qumeshtore janë fitimprurëse dhe llogariten si komerciale në kontekstin e Kosovës. Shumica e këtyre fermave kanë shprehur interes për shtimin e tufave të tyre. Nën-sektori i qumështit ka potencial të mirë për krijimin e vendeve të punës, veçanërisht me mish, dhe eventualisht me prodhime të përmirësuara qumështi për ha tokë dhe me opsione më të mira për dhënien me qira me qëllim rritjen e madhësisë së tufës dhe rritjen e prodhimit të qumështit. Po ashtu, racat më të mira janë shumë të rëndësishme për të rritur efikasitetin e prodhimit të qumështit në përgjithësi. Menaxhimi më i mirë i fermës, infrastruktura dhe standardet e cilësisë janë gjithashtu shumë të rëndësishme për të kontribuar në rritjen e prodhimit dhe punësimit.

Potenciali më i lartë për krijimin e vendeve të punës është në vlerën e shtuar dhe në përpunimin e produkteve të qumështit e mishit për tregjet lokale, si dhe eventualisht në prodhimin e produkteve të veçanta për vendet e rajonit me tradita të ngjashme konsumi. Qasja e vetme është mbështetja e ngritjes së fermave të specializuara të qumështit, të majmërisë së demave dhe diferencimi i prodhimit, ndërkohë që intensifikohet kontrolli i kafshëve të destinuara për therje. Përmes fermave më të specializuara për majmërinë e demave, industria mund të zëvendësojë importet e mishit dhe produkteve të tij, si dhe të ketë ndikim në krijimin e vendeve të punës në zonat rurale. Ekzistojnë mundësi investimi për sipërmarrje të përbashkëta me përpunues ekzistues, të cilët janë të interesuar për partneritet me kompani të huaja. Sektori mund të mbështesë krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale, në industrinë përpunuese, në zbatimin e standardeve të cilësisë së ushqimit, në marketing dhe në fund të rrisë fitimin e qumështit, industrisë së mishit përmes rritjes së besimit të konsumatorëve në produktet vendase.

4 Prodhuësi/Fermerët

4.1 Sektori i prodhimit të qumështit

4.1.1 Prodhimi i qumështit të lopës

Nëse analizohen të dhënat e numrit të krerëve gjatë një priudhe të gjatë historike në Kosovë nga viti 1949/50 deri në vitin 2022, vërehet një lëvizje fluktuese e lartë. Në bazë të dhënave statistikore mbas luftës së dytë botërore gjegjësisht në vitin 1949/50 numri i gjedheve ishte rreth 330,000, kurse në vitin 1990 numri gjedheve ishte 405,000, ose 33% më i lartë krahasuar me periudhën e pasluftës së dytë botërore¹⁰. Numri i lopëve qumështorë dhe mështjerrave të mbarështuara ka qene 221,000 krerë në vitin 1990, që paraqet se pjesmarrja e lopëve qumështore dhe mështjerrave është 58% në numrin e përgjithshëm të gjedheve. Lufta e fundit në Kosovë dëmtoi rëndë sektorin e qumështit, duke shkaktuar djegien e mijëra fermave dhe shkatërrimin e rreth 50% të bagëtive¹¹. Edhe pse sektori i qumështit është një nga nën-sektorët më të rëndësishëm të industrisë blegtorale, struktura e fermave të qumështit (numri i bagëtive për fermë) në periudhën e pasluftës (pas vitit 1999) ka ndryshuar, dmth numri fermave blegtorale (lopë qumështore dhe gjedhe për mish), dhe numri i krerëve të gjedheve si kuptim i gjërë ka rënje dhe se është duke vazhduar në mënyrë të vazhdueshme rritja numrit të krerëve brenda fermës – konsolidimi fermave.

¹⁰ Programi zhvillimit të Blegtorisë dhe prodhimit blegtoral në Kosovë deri në vitin 2000, 1990, Instituti Blegtorisë dhe veterinarisë – Fakulteti Bujqësisë Prishtinë, faqe 14

¹¹KAMP - Assessment of the current situation of kamp, page 5

Sipas ASK, gjithsej numri i Ekonomive Bujqësore në Kosovë që janë marrë me blegtori në vitin 2014 ishte 91,227, 70% e gjithsej Ekonomive Bujqësore.

Nga gjithsej Ekonomitë Bujqësore, që merren me blegtori, 73% e Ekonomive Bujqësore i takojnë gjedhtarisë. Shumica e gjedheve mbahen nga Ekonomitë Familjare Bujqësore ose 99.7%, kurse Subjektet Juridike mbajnë vetëm 0.3%. Numri mesatar i gjedheve për Ekonomi Bujqësore është 3.9 krerë. Shumica e Ekonomive Bujqësore mbajnë 1-2 gjedhe (56%), por shumica e gjedheve rriten nga Ekonomitë Bujqësore që mbajnë 3-9 gjedhe (42%). Bazuar në të dhënat e Anketës Statistike, 2023, numri gjedheve ishte – 250,899, dhe më shumë se gjysma e gjedheve janë lopë qumështore dhe mështjerra të mbarështuara (52%), ose 130,493 krerë.

Shumica e fermave të qumështit janë të vogla dhe prodhojnë kryesisht për konsum vetanak. Inventari aktual përbëhet nga një numër i madh racash të kombinuara qumësht - mish. Përveç kësaj, fermat e vogëla blegtorale në Kosovë përballen me sfida sa i përket produktivitetit të ulët të qumështit, gjenetikës së racave tradicionale, shfrytëzimit të fragmentuar të tokës, ndryshimet klimatike gjatë periudhës së vejetacionit dhe efikasitetit të ulët. Numri i madh i racave të kryqëzuara në inventarin e bagëtive, ushqimi i dobët, higjiena, ndryshimet klimatike – thatësira të shpeshta dhe të ashpra gjatë muajëve kryesor të vejetacionit korrik dhe gusht dhe kushtet e dobëta të shumimit, mungesa e njohurive menaxheriale mbi praktikën e përparuar të fermave të qumështit midis fermerëve konsiderohen si faktorët kryesorë (përcaktuesit e mundshëm) që shkaktojnë efikasitet të ulët të prodhimit.

Numri mesatar i Njësive Blegtoriale për hektar të sipërfaqes së tokës bujqësore të shfrytëzuar në Kosovë është 0.7, që është shumë e ngjashme me numrin mesatar të NJB për hektar të sipërfaqes së tokës bujqësore të shfrytëzuar në vendet e BE-së (0.8)¹².

Fermat e qumështit në Kosovë përdorin njërin nga dy alternativat e sistemit të mbajtjes së lopëve: sisteme të lidhura ose të lira. Sistemi i lidhur dominon, pasi 98% e fermave përdorin këtë sistem, ndërsa vetëm 2% e tyre përdorin sistemin e lirë të prodhimit dhe ky është një disavantazh për sektorin e qumështit.

Gjedhët përfshirë të gjitha kategoritë tyre janë burimi kryesor për prodhimin e qumështit dhe mishit në vend. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2022, fondi i kafshëve në gjedhtari është 250,899 krerë dhe krahasuar me vitin 2021 ka në rënje prej -4%. Megjithatë në vitin 2022, sa i përket produkteve blegtorale, vlera e tyre llogaritet në €315 milionë, ose 14% më e lartë krahasuar me vitin 2021 (€277 milionë). Nga numri i përgjithshëm i lopëve qumështore prej 130.493 krerë, në vitin 2022, 40% ose 52.527 krerë ishin subvencionuar nëpërmjet programit të pagesave direkte.

Bazuar në të dhënat e ASK-së nga viti 2022, numri i gjedheve ka rënë me 4% krahasuar me vitin 2021, ndërsa krahasuar me vitin 2018, vërehet një rënie prej 3%. Analiza krahasuese e kategorive të ndryshme të kategorive të gjedhit po tregon një rritje prej rreth 0.96% midis viteve 2018 deri në 2022 në kategorinë e viqave nën moshën 1 vjeç. Ndërsa nën të njëjtën kategori, ka një rënje me 6,5% midis viteve 2022 deri 2021. E vetmja kategori që shënoi rritje ishin demat mbi 2 vjeç, me 19.93% mes viteve 2018-2022, ndërsa për të njëjtën periudhë mëshqerrat mbi 2 vjeç (kategoria është kryesisht për riprodhim) shënuan rënie të ndjeshme me 11%. Në përgjithësi, tendenca në vitin 2022 është më pozitive krahasuar me vitin 2021 për dema mbi 2 vjeç dhe shënoi një rënje të theksuar prej 11.2%. Ndërsa gjatë së njëjtës periudhë, mëshqerrat mbi 2 vjeç, vazhduan të shënonin rënie me rreth 3.5%. Në kategorinë e lopëve të qumështit pati rënie prej 1,49% mes viteve 2018 deri në 2022 ndërsa midis viteve

¹² https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, page 69

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

2022 dhe 2021 rënia ishte 1.2% në kategorinë e lopëve të qumështit. Tabela më poshtë tregon gjendjen dhe strukturën e bagëtive për vitet 2018 deri në 2022.

Tabela 4-1. Fondi dhe struktura e bagëtive¹³

Kategoritë e gjedheve	2018	2019	2020	2021	2022	Diferenca 2022/2021
Gjedhë	258,662	257,733	261,389	260,528	250,899	-4
Viça nën 1 vjeç	41,911	43,863	38,653	48,047	44,934	-7
Mëshqerra nën 1 vjeç	41,263	39,263	40,731	35,191	33,107	-6
Mëshqerra 1-2 vjeç	26,982	26,149	25,558	26,836	25,146	-7
Dema mbi 2 vjeç	5,519	6,303	7,113	7,451	6,619	-11
Mëshqerra mbi 2 vjeç	9,635	8,128	8,920	8,890	8,575	-4
Lopë qumështi	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493	-1
Gjedhe tjera	898	2,088	1,737	2,037	2,025	-1

Fermerët e gjedheve kanë disa mundësi duke filluar nga të qenit në gjendje të rrisin konkurrencën e fermave deri në prodhimin e sasive më të larta të qumështit. Sidoqoftë, për t'i shfrytëzuar këto mundësi, duhet të ketë përmirësime në praktikën e menaxhimit të fermave të qumështit që do të çojnë në rritjen e produktivitetit të qumështit duke rezultuar në përmirësime në efikasitetin e prodhimit.

Sipas të dhënave të MBPZHR të marra nga regjistrimi i bujqësisë i vitit 2015, 65% e inventarit të gjedheve ishte në ferma me nëntë ose më pak krerë, ndërsa vetëm rreth 10% kanë 30 ose më shumë krerë, fermat me mbi 50 krerë janë vetëm 4%, rajoni i Prishtinës ka numrin më të madh të fermave të gjedheve, 25% e fermave të gjedheve ndodhen në rajonin e Prishtinës, pasuar nga rajoni i Prizrenit me 18%, rajoni i Pejës me 17%. Fermat më të mëdha të gjedheve dhe fermat me më shumë se 50 krerë janë në numër më të madh në rajonin e Pejës, Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës, ndërsa rajonet e tjera, posaçërisht në rajonin e Mitrovicës dhe Ferizajt, janë një numër i vogël i këtyre fermave. Lopët qumështore përbëjnë 52% të numrit të përgjithshëm të gjedheve dhe në vitin 2022, numri i lopëve qumështore ishte 3.7% më i ulët se në 2021. Nga shuma totale e nevojës së brendshme për produkte qumështi, 81.3%¹⁴ ishte shkalla e vetë-mjaftueshmërisë për ekuivalentët e produkteve të qumështit dhe pjesa tjetër u mbulua nga importet. Bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ me rreth €36.7 milionë. Konsumi për frymë vlerësohet të jetë 165 kg në vit ose rreth 0,5 kg në ditë është sasia që një person konsumon, duke përfshirë edhe produktet e qumështit ekuivalente. Ndërsa konsumi mesatar i qumështit për frymë, i matur në kilogram për person në vit në BE është mbi 250 kg.

Shumica e fermave të qumështit në Kosovë janë ferma të vogla dhe të mesme, të cilat janë ferma kryesisht familjare. Sipas madhësisë, fermat ndahen në: ferma të vogla blegtorale, që mbarësojnë më pak se pesë (5) njësi blegtorale në baza ditore; ferma të mesme blegtorale, që mbarësojnë nga gjashtë (6) deri në njëzet (20) njësi blegtorale në baza ditore; dhe ferma të mëdha blegtorale, që mbarësojnë mbi njëzet (20) njësi blegtorale të kafshëve të fermës në baza ditore¹⁵. Njësi blegtorale merret lopa qumështore e cila ka koeficientin 1. Kafshët tjera krahasohen duke marrë këtë njësi blegtorale.

¹³ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 69

¹⁴ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 71

¹⁵ <https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/GZKNr25.201320Shqip.pdf>, faqe 6

Po e marrin si krahasim, delet në raport me lopë qumështore kanë koeficientin 0.10. Në shumicën e rasteve, këto ferma kanë nevojë për të hyra në menyre që të jenë në gjendje për të paguar faturat dhe shpenzimet e tyre personale.

Edhe pse dihet se disa ferma kanë rrjedha alternative të ardhurash, mbase një punë tjetër ose dërgesë nga një i afërm jashtë vendit. Mënyra më e mirë për të zbuluar nëse ferma është fitimprurëse është matja e performancës së saj financiare. Mbajtja e llogarive të fermave njihet botërisht si thelbësore për qëllimet e menaxhimit të biznesit të fermave. Menaxhimi dhe procesi i vendimmarrjes së çdo biznesi, qoftë i madh apo i vogël, nuk do të funksionojë siç duhet nëse të dhënat e sakta dhe të azhurnuara nuk konsiderohen si pjesë rutinë e funksionit të menaxhimit. Nëse të dhënat nuk mbahen është e pamundur të shikohen treguesit themelorë siç është nxjerrja e fitimit.

Një problem i madh në Kosovë është mungesa e mbajtjes së shënimeve themelore të përdorimit të burimeve financiare dhe fizike dhe të të ardhurave të krijuara në nivelin e fermës. Në vitet e fundit fermat e qumështit priren të jenë më mirë në mirëmbajtjen e regjistrave të fermave, por nëse këta regjistra janë të paplotë ose të përpiluar në mënyrë të pasaktë, atëherë analiza mund të jetë çorientuese dhe shpesh çon në vendimmarrje të papërshtatshme. Të dhënat e sakta janë themeli i çdo funksioni të menaxhimit të biznesit dhe blegtorisë. Llogaritja e marzhit bruto është një tregues kryesor në prodhimin bujqësor dhe është mënyra më e përdorur për të analizuar performancën e një biznesi bujqësor. Sidoqoftë, ai nuk mat fitimin, pasi shikon vetëm shpenzimet e bëra që lidhen drejtpërdrejt me secilën ndërmarrje individuale, d.m.th., kostot e ndryshueshme. Mbledhja e të gjitha marzheve bruto të ndërmarrjeve çon në marzhin e përgjithshëm bruto të fermave. Qëllimi i tij kryesor është identifikimi i ndërmarrjeve me fitimin më të mirë nga inputet e përdorura për prodhim.

Me kalimin e kohës, nëse mbahen shënime kontabiliteti, fermeri do të jetë në gjendje të bëjë krahasime të llogarive të viteve të njëpasnjëshme për fermën e tij/saj, në mënyrë që tendencat dhe përmirësimet të mund të monitorohen dhe të ndërmerren veprimet e duhura të bazuar në fakte historike dhe jo në spekulime.

Marzhi bruto i një ndërmarrjeje do të ndryshojë nga sezoni në sezon, pjesërisht për shkak të rendimentit dhe ndryshimeve të çmimeve që ndikojnë në vlerat e prodhimit, dhe pjesërisht sepse kostot e ndryshueshme mund të ndryshojnë në sezone të ndryshme. Shumë faktorë ndikojnë në prodhimin dhe kostot e ndryshueshme të qumështit. Për vlerësimin e këtyre faktorëve, është e nevojshme të kemi një ndarje të detajuar të informacionit fizik dhe financiar në lidhje me prodhimin e qumështit. Mjeti më i rëndësishëm i menaxhimit që fermerët e qumështit mund të përdorin në përmirësimin e veprimtarisë së tyre është ngritja e një sistemi të thjeshtë dhe efektiv për mbajtjen e të dhënave financiare të qumështit në fermë. Mbajtja e duhur e të dhënave financiare do t'i ndihmojë menaxherët e fermave të qumështit në përmirësimin e mjeteve financiare dhe të planifikimit të biznesit që do t'i vijë atyre më pas në ndihmë në procesin e vendimmarrjes.

Aktualisht, shumica e fermerëve të qumështit në Kosovë nuk kanë programe të avancuara për mbajtjen e të dhënave financiare të fermave të qumështit. Mbajtja e shënimeve në fermë mund të jetë detyrë e vështirë nëse vendosni të mbani shënime me laps dhe letër ose me një paketë të sofistikuar programesh kompjuterike. Zgjedhja e sistemit të duhur për fermerët e qumështit është e rëndësishme për suksesin e mbajtjes së të dhënave. Duke marrë parasysh që shumica e fermerëve të qumështit në Kosovë nuk kanë kompjuter ose nuk janë mjaft të njohur me kompjuterët, sistemi manual i mbajtjes së të dhënave financiare i përshtatet aftësive më të mira të fermerëve për të siguruar prodhimin e nevojshëm. Shumë faktorë mund të zvogëlojnë marzhin e fitimit të një operacioni qumështi.

Megjithëse menaxhimi i mirë i krerëve në fermë, të korrave dhe sistemit të plehut çdo ditë lë pak kohë për planifikim afatgjatë, ndaj është e rëndësishme që prodhuesit e qumështit të gjejnë kohë rregullisht për të rishikuar funksionimin e përgjithshëm dhe për të parë nëse ka mungesë efikasiteti. Efikasiteti i prodhimit mund të përmirësohet përmes ndryshimeve në praktikat e prodhimit, të efikasitetit riprodhues, të cilësisë së qumështit, e ushqimit dhe duke mbajtur të dhëna të thjeshta dhe të sakta të fermave të qumështit.

Eksperti zhvilloi analizat e kostos për prodhimin e qumështit dhe të dhënat për kryerjen e analizës së kostos u mbledhën nga diskutimet me fermerët komercial. Nëse fermerët e qumështit në Kosovë synojnë të jenë konkurrues dhe të qëndrojnë në biznes, ata duhet ta dinë gjithmonë nëse po bëjnë nxjerrjen e fitimeve apo jo, ndaj dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme që fermerët e qumështit të bëjnë analiza të shpeshta të kostove. Marzhi i fitimit bruto të bulmetit është krijuar për paraqitjen e kostove drejtuese në prodhimin e qumështit, të cilat më pas do të ndihmojnë në përgatitjen e planeve të përmirësimit të efikasitetit të fermës së qumështit në mënyrë që fermerëve të qumështit t'u mundësohet qëndrimi në biznes.

Analizat e marzhit bruto të kryera për krerë lopë qumështore kanë nxjerrë rezultatet në bazë të mesatares ditore të rendimentit të qumështit prej 20 (L) (shumë pak ferma në Kosovë prodhojnë këtë sasi) për lopët qumështore për periudhën e laktacionit prej 305 ditësh. Çmimi i shitjes së qumështit është €0,46-0.51 (një mesatare prej €0.47, kostoja e prodhimit për një litër qumësht të prodhuar është €0,38; pika e rentabilitetit madje është 4,851 litra qumësht për lopë për laktacion. Marzhi bruto për krerë është €924 në vit. Në biznesin e qumështit, kostot e ushqimit zakonisht përfaqësojnë kategorinë më të madhe të kostove. Në vitet e fundit, kostot e ushqimit për kafshë kanë përfaqësuar më shumë se 56-60% të kostos së prodhimit të qumështit kur çmimet e ushqimit të koncentruar për lopë qumështore kanë qenë të larta pasi importohen drithërat për përmbushjen e nevojave ushqyese të lopëve qumështore. Falë MBPZHR-së, të ardhurat e fermës nga programi i subvencionit të cilësisë së qumështit janë ngrit në €420 për krerë në vit, nëse ferma e qumështit prodhon qumësht të papërpunuar të kategorisë ekstra. Në skenarin kur fermat e qumështit mjelin një tufë me 10 lopë qumështore, atëherë marzhi bruto për të gjithë fermën është €9,241 në vit. Shtojca 1 - Llogaritjet e marzhit bruto të qumështit.

Sipas të dhënave nga Raporti i Gjelbër 2023, bilanci i furnizimit për qumësht lope dhe produkte qumështi vazhdon të mbetet negativ me €36,7 milionë në vitin 2022. Krahasuar me vitin 2021 bilanci tregtar në vitin 2022 u ul me 5%. Numri i lopëve qumështore ra për 1.5% mes viteve 2018 dhe 2022, gjithashtu prodhimi i qumështit shënoi trend negativ me 0.5% mes viteve 2018 dhe 2022. Ndërsa vlera e prodhimit të brendshëm të qumështit shënon 3.85% rritje mes viteve 2022 deri 2021 dhe e cila mund t'i atribuohet rritjes së çmimeve të konsumit të qumështit. Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për bilancin e furnizimit për qumështin e lopës dhe produktet e qumështit, 2018-2022.

Tabela 4-2. Bilanci i furnizimit për qumështin e lopës dhe produktet e qumështit, 2018-2022¹⁶

	Njësi	2018	2019	2020	2021	2022
Lopë qumështi	Krerë	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Prodhimi i qumështit	T	277,599	277,138	281,960	278,746	276,058
Importet	T (p.e.)	70,596	76,139	71,129	72,642	64,666
Furnizimi	T (p.e.)	348,195	353,277	351,089	353,389	340,724
Eksportet	T (p.e.)	572	866	984	1,018	1,196
Përdorime shtëpiake	T (p.e.)	347,624	353,277	352,105	350,371	339,529
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	79.9	78.6	80.1	79.6	81.3
Humbje	T (p.e.)	5,552	5,543	5,639	5,575	5,521
Konsumi për ushqimin e viçave në fermë	T (p.e.)	40,807	40,739	41,448	40,976	40,581
Përpunimi	T (p.e.)	26,848	27,340	27,172	27,090	26,083
Konsumi njerëzor	T (p.e.)	257,416	278,789	227,846	276,730	267,345
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.31	0.32	0.33	0.31	0.34
Vlera e prodhimit	€ mil	71.7	73.9	77.5	72	78.2
Bilanci tregtar	€ mil	-30	-29.9	-29.4	-31.7	-36.7
Konsumi për banor	Kg (p.e)	168	172	170	171	165

4.2 Sektori i prodhimit të mishit

4.2.1 Prodhimi i mishit të gjedhit

Prodhimit të mishit mund t'i shtohet më shumë vlerë duke i transformuar fermat e majmërisë së viçit nga rritja masive e viçave në ferma qumështi, në sisteme të specializuara të prodhimit të mishit të viçit. Numri i gjedheve për mish ka rënë vazhdimisht në pesë vitet e fundit. Prodhimi i mishit në Kosovë është përgjithësisht plotësues dhe bazohet te lopët e qumështit që therren dhe në majmërinë e viçave meshkuj. Inventari aktual i gjedheve përbëhet nga një numër i madh racash të kombinuara mish-qumësht kryesisht raca Simental. Blegtoria në shkallë të vogël e gjedheve në Kosovë është sfida kryesore për zhvillimin e fermave intensive të majmërisë së gjedheve. Për më tepër, prodhuesit e gjedheve për mish po i mbajnë kafshët e tyre në sisteme të lidhur në shtalla dhe në kushte të këqija strehimi. Shumica e gjedheve për mish ushqehen me ushqim me përmbajtje të lartë foragjer, gjë e cila kufizon ritmet e rritjes dhe shtesat më të larta ditore të peshës.

Bazuar në Anketën e Ekonomive Bujqësore (ASK/EB), numri i përgjithshëm i kafshëve të therura për konsum shtëpiak brenda dhe jashtë fermave të kafshëve në vitin 2023 është 64,031 krerë (gjedhe) duke prodhuar 8,136,893 kilogramë mish të konsumuar në njësitë ekonomike bujqësore. Të dhënat përfshijnë kafshët që janë therur jashtë ekonomive bujqësore si (treg, vende enkas për therje të kafshëve etj.) dhe brenda ekonomisë bujqësore. Ndërsa therrja e kafshëve në thertore nuk është përfshirë në të dhënat e më poshtme, (kjo pjesë është e veçantë dhe këto të dhëna do të publikohen në një publikim dedikuar therrjeve në thertore).

¹⁶ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 71

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Për më tepër në këtë pjesë është bërë agregimi i të dhënave për numrin e kafshëve të therura brenda dhe jashtë ekonomive, kurse sasia e prodhimit të mishit, përdorimi dhe shfrytëzimi i mishit është treguar vetëm nga therret që janë bërë brenda ekonomive bujqësore.

Tabela 4-3. Gjedhet e therura në njësitë ekonomike familjare bujqësore dhe jashtë tyre¹⁷

Llojet e kafshës	Kategoria	Gjithsej kafshë të therura	Kafshët e therura jashtë EB (treg, ose vende tjera por jo në therrtore)	Kafshët e therura në EB (për konsum shtëpiak) ose për shitje		
				Krerë	Pesha e gjallë	Pesha e karkasës (rrezja e mishit)
		Krerë	Krerë	Krerë	Kg	Kg
Gjedhë	Viça 0-8 muaj	19,589	8,913	10,676	1,279,873	7,529
	Viça (8-12 muaj)	20,494	4,961	5,533	2,006,634	5,498
	Mëshqerra	4,151	1,043	3,108	577,531	5,683
	Lopët	10,279	2,185	8,094	2,338,737	9,701
	Demat	9,518	3,236	6,282	1,934,117	1,646
	Gjedhët total	64,031	20,338	43,693	8,136,893	30,057

Nga numri i përgjithshëm i gjedheve të therura në fermat bujqësore për konsum shtëpiak dhe jashtë tyre (përfshihen therrret në therrtore), 19,589 krerë i përkasin kategorisë së viçave të rinj (0-8 muaj) që përbëjnë 31% të gjedheve totale të therura në fermat bujqësore, duke prodhuar 25% të prodhimit total të mishit të gjedheve dhe të përdorimit për konsum shtëpiak. Viçat nga 8-12 muaj janë kategoria e dytë më e madhe e gjedheve të therura në fermat bujqësore për konsum shtëpiak. Në vitin 2023, 20,494 viça nga 8-12 muaj janë therur për konsum shtëpiak që përbëjnë 32% të gjedheve totale të therura në fermat bujqësore, duke prodhuar 18% të mishit të përgjithshëm të gjedheve të përdorur për konsum shtëpiak. Lopët e amortizuara janë kategoria e tretë më e madhe e gjedheve të therura në fermat bujqësore për konsum shtëpiak duke prodhuar 16% të mishit të gjedhit të përdorur për konsum shtëpiak, duke prodhuar 32% të mishit të përgjithshëm të gjedheve të përdorur për konsum shtëpiak. Demat janë kategoria e katërt më e madhe e gjedheve të therura në fermat bujqësore për konsum shtëpiak. Në vitin 2023, 17,017 dema janë therur për konsum shtëpiak që përbëjnë 15% të gjedheve totale të therura në fermat bujqësore, duke prodhuar 5% të mishit të përgjithshëm të gjedheve të përdorur për konsum shtëpiak dhe krejt në fund janë mështjerrat e therrura për konsum shtëpiak përbëjnë 6% të gjedheve totale të therrura, duke prodhuar 19% të mishit të përgjithshëm të gjedheve të përdorur për konsum shtëpiak.

Mishi i gjedheve është kryesisht nënprodukt i blegtorisë. Nga numri i përgjithshëm i gjedheve të therura në fermat bujqësore për konsum shtëpiak, 32% e gjedheve therrren jashtë njësite ekonomike familjare bujqësore në thertore dhe/ose në tregun e bagëtive, ndërsa 68% e bagëtive therrren brenda njësite ekonomike familjare bujqësore. Numri i përgjithshëm i bagëtive të therura në njësit ekonomike familjare bujqësore në vitin 2023 ishte 43,693 krerë, 68% e bagëtive të therura brenda këtyre njësite ishin j, nga viça të moshës 8 deri në 12 muaj me 36%, viça të rinj 25%, %, lopë 19% dhe demat 14% dhe krejt në fund. mështjerra 19%

¹⁷ <https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>, Anketa e Ekonomive Bujqësore 2023, faqe 40

Të dhënat për kryerjen e analizës së kostos u mbledhën nga diskutimet me fermer komercial, ekspert të përfshirë në menaxhimin e fermave komerciale për prodhimin e mishit të gjedhit. Marzhi bruto e majmërisë së demit u përcaktua për të paraqitur kostot e drejtimit në prodhimin e mishit, gjë e cila më pas do të ndihmojë në përgatitjen e planeve të përmirësimit të efikasitetit të fermës së majmërisë së demit, në mënyrë që t'u mundësojë fermerëve të prodhimit të mishit të qëndrojnë në biznes. Sipas marzhit bruto të nxjerrë nga analizat për krerë demash për trashje të kryera përmes diskutimit me aktorë të ndryshëm në zingjirin e vlerës së mishit, ka rezultuar se pesha mesatare e viçit mashkull kur blihet për majmëri është 200 deri 300 kg. Me një periudhë majmërie mesatare prej 180 ditësh, demi i majmur arrin peshën mesatare të gjallë prej 500 kg para shitjes për therje. Sipas diskutimeve, çmimi i shitjes së peshës së gjallë për një dem të trashur është 3.7 deri në €3.9 për kg, çmimi rentabël i viçit për të fituar një kg peshë të gjallë është €2.68. Rendimenti rentabël i mishit të viçit është 361 kg për 180 ditë majmëri. Marzhi bruto për krerë është €610.9 për 180 ditë majmëri. Shtesa mesatare ditore në peshë gjatë periudhës së majmërisë së demave është 1,1 kg. Shtojca 2- Llogaritjet e marzhit bruto të mishit të gjedhit.

5 Industria e Përpunimit

5.1 Industria e përpunimit të qumështit

5.1.1 Qumështi i lopës

Bulmeti është një produkt tradicional në Kosovë dhe në të gjithë Ballkanin për sa i përket konsumit dhe prodhimit. Për shkak të kërkesës së madhe e tregut nga njëra anë dhe aftësive kufizuese të ofertes për ta mbajtur në ekuilibër raportin ofertë - kërkesë të tregtisë ushqimore të Kosovës, industria e qumështit u bë një objektivi i hershëm për MBPZHR-në dhe për komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë, së pari për të rindërtuar sektorin dhe më pas për të përmirësuar konkurrencën e sektorit të qumështit. MBPZHR-ja dhe komuniteti i donatorëve kanë punuar për të forcuar funksionet dhe marrëdhëniet në zinxhirin e vlerës së qumështit në Kosovë që u dëmtuan gjatë luftës së vitit 1999, për të promovuar përditësimin e nevojave të tregut dhe teknologjise si dhe për të minimizuar kufizimet dhe pengesat për rritjen e sektorit.

Gjatë viteve të fundit, industria e përpunimit të qumështit ka realizuar investime nga programi mbeshtetes i granteve dhe pagesave direkte të MBPZHR-së, grandet e Komisionit Evropian dhe donacioneve tjera të ofruara nga donatorëve tjerë, me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve përpunuese, modernizimin e linjave teknologjike dhe zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore. Megjithatë, ka ende kompani prodhuese dhe përpunuese vendore që operojn në këtë sektor dhe që nuk përmbushin standardet e kërkuara, si siguria mjedisore dhe e ushqimt, të cilat duhet të adresohen gjatë periudhës së ardhshme. Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, duhet të trajtohet trajtimi i ujërave të zeza nga prodhimi dhe pastrimi i sistemeve të përpunimit të qumështit.

Investimet janë orientuar kryesisht drejt produkteve standarde të qumështit dhe relativisht më pak drejt produkteve të reja inovative, të cilat aktualisht importohen dhe për të cilat mund të shihet rritje e kërkesës në tregun e Kosovës. Shkalla e ulët e produkteve inovative shkaktohet kryesisht nga mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe profesionale, e kapacitetit teknik dhe e kostove të larta që lidhen me zhvillimin e produkteve të reja/inovative.

Përpunuesit e qumështit kanë nevojë për rritje të furnizimit me inputet me cilësi të lartë për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre dhe për të siguruar prodhimin e qëndrueshëm të produkteve të qumështit me cilësi të lartë. Kompanitë vendase të përpunimit të qumështit duhet t'i përditësojnë pajisjet, objektet dhe proceset për të përmbushur standardet ndërkombëtare.

Produktet e qumështit të shitura brenda kanaleve tregtare ndahen në dy grupe: bazë dhe vlerë e shtuar. Produktet bazë përfshijnë qumësht të pasterizuar, kos të pijshëm, kos pa aromë dhe djathë të bardhë. Produktet me vlerë të shtuar përfshijnë qumësht me temperaturë ultra të lartë (UHT), djathë krem (me specia), djathë të verdhë, kos me aromë dhe pije qumështi me aromë.

Cilësia është faktori më i rëndësishëm, i ndjekur nga freskia dhe çmimi. Madhësia e paketimit dhe etiketimi janë faktorë më të rëndësishëm në zonat urbane ku njerëzit zakonisht kanë familje më të vogla dhe blejnë më shumë produkte ushqimore në tregjet zyrtare. Konsumatorët prirën të jenë besnikë, kështu që qëndrueshmëria është kritike në të gjitha tregjet së bashku me njohjen e markës në tregjet zyrtare. Ka më shumë hapësirë për diferencimin e produkteve me vlerë të shtuar përmes formulimeve dhe aromatizuesve plus paketimit dhe etiketimit. Ndërsa marketingu për produktet bazë shton pak vlerë (përveç nëse përpunuesi është një hyrje e re në treg), është me rëndësi jetike që përpunuesit t'i diferencojnë produktet e tyre me vlerë të shtuar nga ato të konkurrentëve. Kërkesa për produktet e qumështit bazë dhe të vlerës së shtuar është e madhe. Çdo vit, popullata e Kosovës konsumon 309.3 milionë litra qumësht nga lopët qumështore (Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2023), nga konsumi i përgjithshëm 40.8% e qumështit të prodhuar në Kosovë konsumohet në fermë ose shkon në tregjet e parregulluara lokale, tregjet e gjelbra 26.7% dhe 32.5 % kalon përmes kanaleve tregtare në përpunuesit dhe tregjet e brendshme. Importet zënë 29 % të produkteve të qumështit me vlerë të shtuar.¹⁸

Ka raporte të ndryshme në lidhje me numrin e fabrikave të licencuara dhe operacionale të përpunimit të qumështit. Sipas AUV¹⁹ në Kosovë, ka 44 përpunues qumështi në Kosovë të licencuar nga AUV (7 prej tyre janë joaktivë); qumështoret e licencuara plotësojnë kërkesat minimale të kerkuara nga qeveria në objektet dhe praktikat e tyre të përpunimit. Ndërsa, sipas të dhënave të siguruar nga Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës (SHIQK), vetëm 16 fabrika për përpunimin e qumështit të cilat janë më aktive në mbledhjen dhe përpunimin e qumështit gjatë gjithë vitit. Ndërsa disa fabrika të licencuara për përpunimin e qumështit kanë dalë nga tregu, disa të tjerë operojnë brenda dhe jashtë tregut dhe të dhënat për mbledhjen dhe përpunimin e qumështit të disa fabrikave të tjera që merren me këtë punë mungojnë. Sipas SHIQK -së, kapaciteti i përpunuesve të vegjël të qumështit arrin deri në 5,000 litra në ditë dhe përpunuesi më i madh mund të përpunojë deri në 100,000 litra në ditë, janë gjithësejt 3 përpunues që posedojnë këtë kapacitet. Në total, kapaciteti i përpunimit të qumështit të përpunuesve arrin 601,050 litra në ditë, por ata përpunojnë vetëm mbi 220,000 litra qumësht në ditë ose shfrytëzohet 36% e kapacitetit total të përpunimit.

Bazuar në shkallën e rrezikshmërisë të sigurisë së ushqimit ndërmarrjet e përpunimit dhe paketimit të ushqimit me origjinë shtazore, sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës janë ndare në 4 kategori: - Kategoria "A"= shkallë e ulët e rrezikut - Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut - Kategoria "C"= shkallë e lartë e rrezikut - Kategoria "D"= shkallë shumë e lartë e rrezikut.

Sipas AUV-it, Kosova ka 44 përpunues qumështi të licencuara kryesisht qumësht prej lopëve qumështore (B) por disa përpunues qumështi përpunojnë qumështin nga: lopë qumështore (B), dele (O), buallica. (vetëm qumështorja Drena përpunon qumështin e buallicave), një përpunues merret me përpunimin e qumështit të dhisë (C), 3 përpunues qumështi përpunojnë qumështin dhe grumbullojnë (kurse njëri nga këto përpunues - Rudina është joaktive sa i përket përpunimit, por e grumbullon qumështin).

¹⁸ <https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>, Anketa e Ekonomive Bujqësore 2023, faqe 26

¹⁹ <https://auvk.rks-gov.net/bizneset/bizneset-e-aprovuara-per-ushqime-me-origjine-shtazore/>

Sa i përket gjendjes së përpunuesëve të qumështit sipas kategorisë së rrezikut, situata është kjo: 15 kategorizohen me rrezik të lartë, 25 me rrezik të mesëm dhe 4 me rrezik të ultë. Në lidhje me kategorizimin sipas vëllimit të prodhimit, gjendja është kjo si në vijim: 4 përpunues me vëllim të lartë prodhimit, 14 me vëllim prodhimi mesatar dhe 26 me vëllim të ulët prodhimi.

Në lidhje me kategorizimin e përpunuesëve të qumështit pas analizës gjendja është si në vijim: A - 4, B – 24, C – 16, kurse në kategorin D nuk është kategorizuar asnjë. Kategorizimi sipas funksionalitetit të ndertesave dhe hapësirave të prodhimit duket si në vijim. 16 – i plotëson kriteret e lartë për këto dy kriteret të vlerësimit, 22 i përkasin kategorisë së mesme dhe 6 i përkasin nivelit të ultë.²⁰

Përpunuesit e mbledhin qumështin e papërpunuar nga fermerë individualë që merren me prodhimin e qumështit dhe nga pikat e grumbullimit të qumështit (PGQ). Për shkak të problemeve me cilësinë, përpunuesit e qumështit preferojnë të blejnë nga fermerë individualë me kontratë; megjithatë, gjatë stinëve të dimrit për shkak të mungesës së qumështit, përpunuesit hezitojnë të refuzojnë çfarë do lloj furnizuesi. Përpunuesit më të mëdhenj filluan të paguanin një premium për qumështin me cilësi të lartë para zbatimit të pagesave direkte për cilësi të qumështit; aktualisht. Ka rreth 52 pika për grumbullimin e qumështit në Kosovë, të cilat mbledhin qumësht nga fermerët e qumështit, e ftohin dhe e shpërndajnë qumështin e papërpunuar te përpunuesit e qumështit ose përpunuesit e grumbullojnë.

PGQ-të janë në pronësi private dhe menaxhohen në mënyrë të pavarur. Ato janë përgjegjëse për kryerjen e analizave themelore të qumështit të furnizuar nga cilido fermerë dhe për dhënien e komenteve të tyre mbi cilësinë dhe kushtet e pagesës për fermerët që merren me prodhimin e qumështit. PGQ-ja është një lloj ndërmjetësimi mes fermerit që merret me prodhimin e qumështit dhe përpunuesit të qumështit dhe e cila përfiton nga përqindja e paguar për ndërmjetësimin në transaksion. Ekzistojnë dy lloje PGQ-sh, të cilat ose gjenden në një fermë më të madhe që e mbledh prodhimin e saj në fermë, por mbledh edhe qumështin nga fermerët e tjerë në afërsi. Ndërsa PGQ-të e tjera nuk gjenden në ndonjë fermë qumështi, por veprojnë si biznes ndërmjetësues dhe mbledhin vetëm qumësht nga fermerë që merren me prodhimin e qumështit në shkallë të vogël dhe ua dorëzojnë përpunuesve të qumështit. Të regjistruara si biznese në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë deri më tani janë 30 PGQ ose 58 % e numrit të përgjithshëm të pikave të cilat janë funksionale. Në bazë të informacionit nga SHPQK, 52 PGQ marrin qumësht nga 1,286 fermerë qumështi dhe mbledhin rreth 106,290 litra qumësht në ditë²¹.

Fermer të regjistruar (PGQ e kryen pagesën nëpërmes bankës) 1,184 ose 53 % e fermereve të cilët dorëzojnë qumështin në pikat grumbulluese të qumështit, Kapaciteti grumbullues i PGQ është 242,600 litra/qumësht. Sasia e grumbulluar e qumështit në PGQ është 106,290 litra qumësht /ditë ose 44 % shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese të pikave grumbulluese të qumështit. Marr parasysh kapacitetin e shfrytëzimit të kapaciteteve të PGQ (242,600 litra/qumësht) rrjedh se PGQ nuk e shfrytëzojnë kapacitetin funksional për 56%.

Shumica e përpunuesve të qumështit kanë linja të shumta prodhimi. Minimalisht, ata prodhojnë produkte bazë dhe përpunuesit më të mëdhenj bëjnë produkte me vlerë të shtuar. Fabrikat e qumështit Devolli dhe Drena janë të vetmet fabrika qumështi në Kosovë që po prodhojnë qumështin UHT dhe po konkurrojnë me sukses kundër importeve me çmimin dhe cilësinë e produktit.

²⁰ <https://auvk.rks-gov.net/doenload/regjistri-i-objekteve-te-aprovuara-per-therjen-e-thundrakeve/>

²¹ Burimi: SHPQK, Raporti numri i grumbullimit të pikave

Qumështi i pasterizuar, djathërat e bardhë dhe të verdhë, kremi i qumështit, gjalpi dhe koset/jogurtet janë produktet kryesore të qumështit të prodhuara nga shumica e fabrikave të përpunimit të qumështit. Jogurti i qumështit (kosi i pijshëm) është produkti më fitimprurës për shumë përpunues qumështi; diferenca është e vogël, por vëllimi është i lartë e bën të mundur fitimi. Pak përpunues eksportojnë, por shohin Shqipërinë dhe Maqedoninë si tregje potenciale eksporti për produktet e qumështit me vlerë të shtuar dhe për djathin e bardhë. Sidoqoftë, besimi është i brishtë mes përpunuesve të qumështit për shkak të konkurrencës në blerjen e qumështit të papërpunuar dhe në fitimin e një pjesë shtesë të tregut lokal. Mosmarrëveshjet mes përpunuesve më të mëdhenj të qumështit prishin drejtimin e industrisë së përpunimit të qumështit.

Pikat më e dobët në funksionin e përpunimit është shkalla tejet e ulët e produktivitetit, raporti i outputit kundrejt inputit; prodhimi i një game të kufizuar produktesh qumështi me vlerë të shtuar dhe teknologjia e vjetruar e përpunimit të qumështit, veçanërisht impiantet e përpunimit të qumështit me madhësi të vogël dhe të mesme. Përpunuesit e qumështit kufizohen nga një sasi dhe cilësi e pamjaftueshme e qumështi të papërpunuar, kështu që veprojnë nën kapacitetin e plotë. Përpunuesit duhet t'i përditësojnë dhe standardizojnë praktikatat e tyre të përpunimit për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve të gatshme, për të rritur efikasitetin e prodhimit dhe për të përmbushur vazhdimisht standardet ndërkombëtare të cilësisë. Inputet me cilësi të lartë si qumështi i papërpunuar kërkohen për rezultate me cilësi të lartë. Produktet e qumështit të fermentuara me cilësi më të lartë mund të prodhohen vetëm duke përdorur qumësht të papërpunuar me cilësi të lartë. Si hap tjetër, qeveria mund të marrë në konsideratë promovimin e Certifikimit të Praktikës së Mirë të Prodhimit (PMP) dhe Analizave të Rrezikut (HACCP) (standardet ndërkombëtare të sigurisë ushqimore) mes përpunuesve për të përmirësuar cilësinë e rezultateve dhe konkurrencën e produkteve lokale në tregjet vendase dhe të eksportit. Certifikimi PMP/HACCP është i domosdoshëm për casjen dhe penetrimin në tregun rajonal dhe në ato të BE-së.

Sektori i qumështit ka shumë rëndësi për prodhuesit, përpunuesit dhe konsumatorët e qumështit. Zhvillimi i prodhimit të qumështit në Kosovë ofron bazën për ndërtimin e një game të gjerë kapacitetesh përpunuese të fabrikave të qumështit. Aktorët kryesorë, të cilët marrin pjesë në zinxhirin e furnizimit të qumështit, kryejnë transaksione mes tyre duke bërë të mundur që produkti të kalojë nëpër zinxhirët kryesorë të furnizimit duke shtuar vlerën e produktit për të arritur te konsumatori përfundimtar. Sipas të dhënave të siguruar nga SHIQK, mesatarisht 222,385 litra qumësht të papërpunuar grumbullohen dhe përpunohen në ditë nga 16 fabrikat më aktive të përpunimit të qumështit në Kosovë. Mesatarisht 32.5% (llogaritja e ekspertëve) e qumështit total të prodhuar në vend shkon për përpunim të mëtejshëm përmes kanaleve tregtare. Ekziston një furnizim i paqëndrueshëm i qumështit të papërpunuar gjatë gjithë vitit me furnizimin e qumështit të papërpunuar që rritet në stinët e verës, ndërsa furnizimi i qumështit të papërpunuar zvogëlohet në stinët e dimrit.

Në vitin 2006, MBPZHR-ja miratoi "Udhëzimin Administrativ për Qumështin e Papërpunuar" nr. 20/2006. Ky udhëzim përcakton standardet dhe udhëzimet specifike të prodhimit të qumështit, duke përfshirë parametrat mikro-biologjike, parametrat e përbërësve të produkteve dhe udhëzimet e rrjetit të pagesave me zbritje deri në -20% për cilësi të dobët nën klasën e tretë dhe prime të çmimit deri në 15% për cilësinë e qumështit të papërpunuar të klasës ekstra. Zbatimi i programit të pagesave direkte për cilësi të qumështit të papërpunuar të MBPZHR-së bazohet në standardet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të cilësisë së qumështit të papërpunuar.

Për shkak të programit të subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar, cilësia e qumështit të papërpunuar që shkon për përpunim të mëtejshëm në fabrikat e qumështit po përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Tabela 5-1. Standardet e cilësisë së qumështit të përcaktuara me dekretin e cilësisë së qumështit të papërpunuar 20/2006

Kategorizimi	Mikroorganizmi	Qelizat somatike	Çmimi Premium/penaliteti
Klasa ekstra	<80,000 për ml	<300,000 për ml	+15%
Klasa I	<100,000 për ml	<400,000 për ml	+/- 0
Klasa II	<200,000 për ml	<500,000 për ml	-5%
Klasa III	<500,000 për ml	<600,000 për ml	- 20%

Burimi:(MBPZHR, 2006)

Prodhimi i qumështit në Kosovë përballet me shumë sfida, siç janë numri i madh i fermave të vogla të qumështit dhe zvogëlimi i numrit të gjedheve, përkatësisht lopëve qumështore. Për kompensimin e këtij bilanci, një sasi e konsiderueshme produktesh të qumështi të përpunuar importohet nga vendet e rajonit, si dhe nga vendet e tjera evropiane. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), qumështi i përgjithshëm i prodhuar në Kosovë gjatë vitit 2023 ishte 342,324,637 litra. Qumështi i përgjithshëm i prodhuar në Kosovë përdoret për qëllime të ndryshme: për konsum të freskët në familje, për bagëti (si ushqim për vëçat), për përpunim në produkte të ndryshme (krem, gjalpë, djathë, kos etj.), si dhe një sasi qumështi të prodhuar i shitet drejtpërdrejt konsumatorit (Tregu i Gjelbër).

Produktet e qumështit me vlerë të shtuar përfaqësojnë vetëm 32.5% të prodhimit të brendshëm të qumështit prodhuar nga lopët qumështore. Pjesa e mbetur përbëhet nga konsumi në shtëpi 40.8% dhe shitjet në tregut të gjelbër të qumështit të papërpunuar me 26.7%.

Tabela më poshtë tregon përqindjet e prodhimit dhe konsumit total të qumështit për vitin 2023 të ndara në tre segmente tregu: Konsumi në shtëpi, tregu i gjelbër (i freskët) dhe tregu i përpunuar.

Tabela 5-2. Përqindjet e prodhimit dhe shfrytëzimit total të qumështit nga lopët qumështore²²

Tregjet ku shitet qumështi nga lopët qumështore	Përqindja	Prodhimi lokal/l
Konsum në fermë	40.8	126,239,980
Tregu informal	26.7	82,563,775
Tregu i përpunuar	32.5	100,539,724
Total	100	309,343,479

Në Kosovë, nga 130,493 lopë qumështore prodhohen 309,343,479 (l) qumësht. Përpunimi i qumështit të prodhuar në ferma bujqësore u kushtohet kryesisht produkteve të tilla si kremi, gjalpi, djathi, kosi i trashë, kosi, ajka etj. Pjesa më e madhe e qumështit për konsum shtëpiak i kushtohet kategorisë tjetër kosit të trashë dhe kosit të thjeshtë me 27,717,175 litra ose 26%, pasuar nga djathi në total me 24 407,200.48 litra ose 22%, pastaj konsumit të qumështit të lëngshëm 23,046,089 litra ose 21% e konsumit të përgjithshëm shtëpiak, pastaj ajka me 20,664,144 ose 19% dhe gjalpë në sasi prej prej 12,652,148 ose 12%. Për më shumë detaje shih tabelënë në vazhdim.

²²<https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>, Anketa e ekonomive bujqësore 2023

Tabela 5-3. Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit²³

Lloji i qumështit	Prodhimi total (L)	Për konsum familjar (L)	Përpunimi në njësitet ekonomike familjare bujqësore			
			Ajka (L)	Gjalpë (L)	Djathë (L)	Tjetër (kos i trashë,)
Qumësht lope	309,343,479	23,046,089	20,664,144	12,652,148	24,407,200	27,717,175
		21	19	12	22	26
						108,486,756

Përpunimi i qumështit të prodhuar në Ekonomitë Bujqësore kryesisht dedikohet në produkte si ajkë, gjalpë, djathë, kos, jogurt etj. Pjesa më madhe e qumështit për përpunim i dedikohet jogurtit, kosit (25,294,694.55 L) dhe jogurtit, kosit etj., pasuar nga djathi. (2,925,958.44 L), ndërsa sasia tjetër shpërndahet në produkte tjera. .

Tabela 5-4. Produktet e përpunuara të qumështit në njësitë ekonomike familjare bujqësore²⁴

Lloji i qumështit	Përdorimi	Përpunimi në një njësitë ekonomike familjare bujqësore			
		Ajkë	Gjalpë	Djathë	Tjetër (kos i trashë, kos)
		Kg	Kg	Kg	Kg
Qumësht lope	Konsumi në EB	2,497,325.98	481,954.27	2,925,958.44	25,294,694.55
	Shitje	210,389.49	104,364.79	1,490,582.60	2,422,481.16
Total		2,707,715.47	586,319.06	4,416,541.04	27,717,175.71

Sipas të dhënave të siguruara nga SHIQK-së, mesatarisht 222,385 litra qumësht të papërpunuar mbledhen dhe përpunohen në ditë nga 16 fabrika më aktive të përpunimit të qumështit në Kosovë. Ekzistojnë katër fabrika më të mëdha për përpunimin e qumështit me kapacitet përpunues mbi 20,000 l qumësht të papërpunuar për turnus 8 orësh, të cilat mbledhin dhe përpunojnë 127,630 (l), duke mbuluar mbi 57% të përqindjes totale të tregut të ndjekur nga katër fabrika të përpunimit të qumështit që mbledhin dhe përpunojnë 59,215 litra qumësht të papërpunuar, duke mbuluar mbi 26% të përqindjes totale të tregut. Pjesa tjetër e fabrikave të përpunimit të qumështit janë me madhësi më të vogël me kapacitet përpunimi që varion nga 1,000 deri në 10,000 (l) qumësht të përpunuar në turn 8 orësh. Sipas të dhënave të SHIQK-së, 84% e totalit të qumështit të papërpunuar që shkon për përpunim të mëtejshëm mbledhet dhe përpunohet në baza ditore nga 8 fabrikat më të mëdha të qumështit. Kapaciteti ditor i përpunimit të qumështit i 15 fabrikave të qumështit është më shumë se 583,000 litra në ditë në turn 8 orësh, ndërsa përdorimi mesatar ditor i kapacitetit të industrisë së përpunimit të qumështit është 36%.

Dy faktorë kryesorë mund të kontribuojnë në rritjen e shfrytëzimit të kapacitetit përpunues të standardizimit të parë të produktit të qumështit lokal dhe të qëndrueshmërisë së cilësisë së produktit të dytë dhe diversifikimit të produkteve. Fabrikat e përpunimit të qumështit shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin me një distancë maksimale prej dy orësh nga njëra-tjetra. Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për kategorizimin e fabrikave të përpunimit të qumështit bazuar në qumështin e papërpunuar të mbledhur dhe të përpunuar për vitin 2023

²³<https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>, Anketa ekonomike bujqësore 2023

²⁴<https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>, Anketa ekonomike bujqësore, 2023

Tabela 5-5. Kategorizimi i impianteve të përpunimit të qumështit

Kategorizimi i impianteve të përpunimit të qumështit bazuar në sasinë e qumështit të mbledhur dhe të përpunuar/L/ditë	Numri i impianteve të përpunimit të qumështit	Sasitë e qumështit të mbledhur dhe të përpunuar/L/ditë	Përqindja e tregut%	Kapaciteti i instaluar i përpunimit/L/ditë
1.000 - 5.000	6	17,140	7.7 %	583,000
5001 - 10.000	2	18.400	8.3%	
10.001 – 20.000	4	59,215	26.6%	
>20000	4	127,630	57.4%	
Total	16	222,385		

Burimi: SHIQK 2023: Përlllogaritje të ekspertit

Sipas të dhënave të siguruara nga SHIQK, ekzistojnë 13 kategori produktesh qumështime vlerë të shtuar të prodhuara nga fabrikat e përpunimit të qumështit në Kosovë. Kosi i thjeshtë merr përqindjen më të madhe të totalit ditor të qumështit të papërpunuar që shkon për përpunim të mëtejshëm në fabrikat e përpunimit të qumështit me 19%, pasuar nga djathi i bardhë i fortë me 18%, qumështi UHT me 14% dhe kosi i thjeshtë me 14%. Në tabelën më poshtë janë paraqitur kategoritë e produkteve të qumështit me vlerë të shtuar me përqindjen e zënë në tregun vendas të prodhuar nga fabrikat e përpunimit të qumështit në Kosovë.

Tabela 5-6. Kategoritë e produkteve të qumështit me vlerë të shtuar

Nr.	Kategoritë e produkteve të qumështit me vlerë të shtuar/L/qumështore	Destinimi i qumështit të papërpunuar për përpunim të mëtejshëm në impiantet e përpunimit të qumështit/L/ditë	Pjesa që zë në treg në përqindje
1	Qumësht i freskët i pasterizuar	9,350	4.2%
2	Qumësht UHT	32,000	14.4%
3	Akullore	2,000	0.9%
4	Djathë i bardhë i fortë	39,386	17.7%
5	Djathë i bardhë i butë (djathë i freskët)	11,140	5.0%
6	Djathë i verdhë	12,983	5.8%
7	Gjizë	13,870	6.2%
8	Djathi tradicional Sharri	5,700	2.6%
9	Kos i thjeshtë	42,200	19.0%
10	Kos	30,250	13.6%
11	Shmand	4,840	2.2%
12	Ajron	11,100	5.0%
13	Krem qumështi i mbushur me spec	7,567	3.4%

Burimi: SHIQK 2023: Përlllogaritje të ekspertit

Përpunuesit e qumështit mbledhin qumështin e papërpunuar nga prodhuesit individualë të qumështit dhe qendrat e mbledhjes së qumështit. Nga 2018 në 2022, çmimet mesatare në fermë për qumështin e papërpunuar janë rritur, ndërsa çmimet mesatare të konsumit të qumështit janë rritur. Shpërndarja e marzhit të fitimit në zinxhirin e furnizimit me qumësht nuk është e ekuilibruar; zinxhirët e supermarketeve me pakicë dhe fabrikat e përpunimit të qumështit po vendosin marzhe më të larta fitimi në të gjithë zinxhirin e furnizimit të qumështit. Disponueshmëria e furnizimit me qumësht të papërpunuar që dorëzohet në fabrikat e përpunimit të qumështit do të rritet më shumë nëse çmimet e qumështit të papërpunuar në fermë të paguara nga përpunuesit e qumështit rriten veçanërisht duke paguar çmime premium për qumështin e papërpunuar me cilësi më të lartë. Përpunuesit e qumështit preferojnë të blejnë qumësht të papërpunuar me cilësi më të lartë, por ata nuk janë ende gati të paguajnë çmim premium për qumësht të papërpunuar me cilësi më të lartë.

Përpunuesit më të mëdhenj të qumështit filluan të paguanin premium për qumështin me cilësi të lartë para zbatimit të udhëzimit administrativë të cilësisë së qumështit, por aktualisht, asnjë përpunues nuk bën ulje pagese për qumështin me cilësi të ulët. Aktualisht, çmimi i sheshtë për qumështin e papërpunuar paguhet bazuar në yndyrën e qumështit të rënë dakord me konsensus nga të gjithë përpunuesit e qumështit.

Gjatë sezoneve të verës për gjatë disa viteve, ka pasur mbiproduhim sezonale ose qumësht të papërpunuar, gjë e cila krijon gjithmonë presion në treg dhe disa sezona kanë parë rritje të furnizimit lokal dhe nga importet e furnizuesve rajonale. Fermerët e vegjël të qumështit po përballen me vështirësi në tregtimin e prodhimit gjatë tepricës sezonale të qumështit të papërpunuar. Për zvogëlimin e presionit të likuiditetit që vjen nga rezervat e krijuara në depo, fabrikat e përpunimit të qumështit gjatë sezoneve të verës pezullojnë blerjet e qumështit të papërpunuar vetëm nga fermerët e vegjël, të cilët e shesin qumështin e tyre të tepërt të prodhuar vetëm gjatë sezoneve të pranverës dhe verës dhe në përpunimin e tepricave të sezonit të qumështit blihen vetëm klasat më të larta të qumështit të papërpunuar.

Ekzistojnë shtatë funksione të zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit në Kosovë: shitja me shumicë, pakicë, shpërndarje, përpunim, mbledhje, prodhim dhe furnizim i inputeve. Ka pasur shumë përmirësime në vlerën e qumështit të Kosovës vitet e fundit. Funksionet e zinxhirit të vlerës dhe lidhjet janë forcuar mes prodhuesve të mëdhenj të qumështit dhe përpunuesve të qumështit dhe nuk ka boshllëqe apo ndërprerje të zinxhirit, por ka ende disa pika të dobëta që pengojnë përmirësimin dhe rritjen, siç janë p.sh. marrëdhëniet jo të mira të zinxhirit të vlerës dhe mungesa e besimit mes aktorëve të zinxhirit të furnizimit me qumësht. Ndër pikat e dobëta mund të përmendim marrëdhëniet dhe lidhjet jo të mira të zinxhirit të vlerës për shkak të zbatimit të dobët të kontratave nga sistemi gjyqësor joefektiv dhe kapaciteti i papërshtatshëm ligjor dhe rregullator i qeverisë. Marrëdhënia më e dobët në zinxhirin e vlerës së qumështit në Kosovë është mes shitësve më të mëdhenj (veçanërisht hipermarketeve) dhe përpunuesve të qumështit. Është një marrëdhënie asimetrike me shitësit që dominojnë marrëdhëniet për shkak të kërkesës në tregun përfundimtar. Importet shesin mirë dhe marzhet e fitimit zakonisht janë më të larta se ato të realizuara me produktet lokale të qumështit.

5.2 Industria e përpunimit të mishit

Mishi i gjedhit dhe shpendëve janë burimet kryesore të konsumit të mishit në vend. Mishi i shpendëve është kategoria kryesore e konsumuar në Kosovë me rreth 23 kg/kokë banori ose 47%, e ndjekur nga mishi i viçit me rreth 20 kg/kokë banori ose 46%, ndërsa pjesa tjetër e mishit të konsumuar në vend vjen nga dhitë, delet dhe derri (ky i fundit, mishi dërrit konsumohet nga komuniteti i besimit katolik dhe ortodoks).

Bazuar në shkallën e rrezikshmërisë të sigurisë së ushqimit ndërmarrjet e përpunimit dhe paketimit të ushqimit me origjinë shtazore, sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës janë ndare në 4 kategori: - Kategoria "A" = shkallë e ulët e rrezikut - Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut - Kategoria "C" = shkallë e lartë e rrezikut - Kategoria "D" = shkallë shumë e lartë e rrezikut⁶. Vetëm një kompani nga sektori i kafshëve është e certifikuar për eksport në BE²⁵.

²⁵ [https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/STRATEGJIA_20222028_FINAL_ALB_Ëeb_Noprint_fin
al_PDF.pdf](https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/STRATEGJIA_20222028_FINAL_ALB_Ëeb_Noprint_final_PDF.pdf), faqe 23

Sipas AUV-it, Kosova ka 59 thertore të licencuara kryesisht gjedhi (B) por edhe të kombinuara gjedhi (B) me dele (O) ose gjedhi (B) me derrin (P), ku 19 prej tyre përpunojnë edhe mishin dhe 7 janë thertore shpëzesh. Nga 59 thertore të regjistruara 6 prej tyre janë pasive.

Sa i përket gjendjes së thertoreve sipas kategorisë së rrezikut, situata është kjo: 29 kategorizohen me rrezik të lartë, 25 me rrezik të mesëm dhe 5 me rrezik të ultë. Në lidhje me kategorizimin sipas vëllimit të prodhimit, gjendja është kjo si në vijim: 5 thertore me vëllim të lartë prodhimit, 31 me vëllim prodhimi mesatar dhe 23 me vëllim të ulët prodhimi. Në lidhje me kategorizimin e thertoreve pas analizës gjendja është si në vijim: A - 4, B – 27, C – 26 dhe D-2. Kategorizimi sipas funksionalitetit të ndërtesave dhe hapësirave të prodhimit duket si në vijim. 24 – i plotëson kriteret e lartë për këto dy kritere të vlerësimit, 29 i përkasin kategorisë së mesme dhe 6 i përkasin nivelit të ultë.²⁶ Të dhënat për kafshët e therura në fabrikat e përpunimit të mishit mungojnë dhe që përshkruajnë llojet e produkteve të mishit të përpunuara në fabrikat e përpunimit të mishit në Kosovë. Sipas kategorizimit (A, B, C dhe D), 3% e kapaciteteve aktuale të thertoreve të gjedheve janë në kategorinë D, 46% në kategorinë C, që do të thotë se rreziku është shumë i lartë për këto dy kategori, 44% në kategorinë B dhe vetëm 7% në kategorinë A. Situata me thertoret e pulave është e njëjtë, 75% e thertoreve aktuale të pulave janë nën kategorinë B dhe 25% nën kategorinë C.

Aktualisht, lista e institucioneve të aprovuara që përpunojnë ushqim me origjinë shtazore gjendet në faqen e internetit të AUV-së: lista do të organizohet në përputhje me dispozitat e listës Master të BE-së SANCO/2179/2005 Revision 2014 dhe me specifikimet teknike të listës master dhe me listat e institucioneve ushqimore të miratuara nga BE-ja dhe disa institucione të tjera të specifikuara ushqimore. Regjistri i produkteve të ushqimit dhe nënprodukteve të kafshëve nuk është bërë akoma. Operatorët që merren me përpunimin e mishit në Kosovë janë të regjistruar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK) dhe se në këtë bazë të dhënave janë të futura të gjitha të dhënat relevante për identifikimin e këtyre operatorëve.

Numri i përgjithshëm i këtyre operatorëve që merren me përpunimin e mishit është 62, prej tyre 57 janë aktiv dhe 5 janë pasivë. Këto përshkruajnë: llojin e mishit, aktivitetin e aprovuar, kapacitetin operacional, kategorizimin e rrezikut, kategorizimin e vëllimit të prodhimit, grupin e kategorizuar, kategorizimin sipas funksionalitetit të ndërtesës, hapësirës së prodhimit dhe të shfrytëzimit të fabrikave të përpunimit të mishit në Kosovë. Lloji mishit që e shfrytëzojnë këta operatorë për përpunim është i gjedhit dhe shpezëve (kryesisht pulave). Kapaciteti operacional i përgjithshëm i të gjithë operatorëve që merren me përpunimin e mishit është 278.7 Ton në baza ditore, kurse në baza individuale ai varion nga 0.5 deri në 20 ton në baza ditore.

Nuk ka të dhëna për shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve përpunuese në aspektin funksional, por sipas vlerësimit të ekspertëve dhe njohësve të sektorit vlerësohet diku 35%. Sa i përket gjendjes së operatorëve të përpunimit të mishit sipas kategorisë së rrezikut, situata është kjo: 26 kategorizohen me rrezik të lartë, 33 me rrezik të mesëm dhe 3 me rrezik të ultë. Në lidhje me kategorizimin sipas vëllimit të prodhimit, gjendja është kjo si në vijim: 4 përpunues mishit me vëllim të lartë prodhimit, 23 me vëllim prodhimi mesatar dhe 35 me vëllim të ulët prodhimi. Në lidhje me kategorizimin e përpunuesëve të mishit pas analizës gjendja është si në vijim: A - 3, B – 33, C – 26 dhe kurse në kategorinë D nuk ka asnjë operator.

²⁶ <https://auvk.rks-gov.net/doenload/regjistri-i-objekteve-te-aprovuara-per-therjen-e-thundrakeve/>

Kategorizimi sipas funksionalitetit të ndertesave dhe hapësirave të prodhimit duket si në vijim. 28 – i plotëson kriteret e lartë për këto dy kriteret të vlerësimit, 26 i përkasin kategorisë së mesme dhe 8 i përkasin nivelit të ultë²⁷. Sidoqoftë, me aktorë të ndryshëm shumica e kafshëve theren në njësitë ekonomike familjare bujqësore ose 68% kundrejt 32% që theren në therrtore. Industria e mishit në Kosovë mund të përshkruhet si e fragmentuar dhe jo e plotë. Situata e thertoreve në Kosovë është mjaft zhgënjyese dhe procedurat sanitare dhe njerëzore të trajtimit të kafshëve para se të theret ishin pothuajse inekzistente.

Therrtoret dhe përpunuesit e mishit në Kosovë janë gjithashtu të paorganizuara dhe larg përmbushjes së standardeve të BE-së. Pajisjet e therrjes dhe përpunimit të mishit janë të vjetra dhe pjesa më e madhe e procesit të therrjes dhe përpunimit është manuale ose gjysëmautomatike. Procedurat sanitare gjatë procesit të therrjes dhe përpunimit të mishit mungojnë gjithashtu, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë negativ në cilësinë e mishit të përpunuar. Mbetjet e hedhura të kafshëve që dalin nga therrja nuk trajtohen siç duhet, duke shkaktuar ndikim negativ në mjedis. Objektet më të vogla të thertoreve nuk kanë kamionë të duhur me frigorifer për transportimin e mishit të freskët dhe nuk kanë as ambiente depozitimi të ftohta për ruajtjen e duhur të mishit. Objektet më të vogla të mishit blejnë dema/viça në tregjet lokale një deri në tre herë në javë dhe i therrin në therrtoret e vogla ku bëjnë sallam dhe biftek për t'i shitur në dyqanet e tyre të mishit. Në vitin 2022, janë therrur gjithsej 115,224 gjedhe, veçanërisht mishi i gjedhit, është një produkt i popullarizuar në Kosovë dhe ofron mundësi për zëvendësimin e importit, veçanërisht nëse prodhimet e foragjereve rriten duke ulur koston e ushqimit. Në 2022-ën, vlera e prodhimit të mishit të gjedhit arriti rreth €57.5 milionë kurse vlera importit ishte €115.2 milion. Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë është 40.1% dhe konsumi për krerë është 20 kg për kokë banori. Industria e mishit të viçit në Kosovë është kryesisht nënprodukt i industrisë së qumeshtit.

Bilanci i furnizimit të mishit të gjedhit vazhdon të mbetet negativ duke arritur rreth €106.7 milionë në vitin 2022. Pra një rritje signifikante e trendit negativ të bilancit nga €40 milion në €106.7 milion, ose 90.93%. Numri i gjedheve të therrura ka një rritje me 1% midis 2018 dhe 2022, gjithashtu prodhimi vendas i mishit të gjedhit shënoi një trend pozitiv rritje me 1.02% mes viteve 2018 dhe 2022 (MBPZHR)²⁸. Ndërsa vlera e prodhimit të gjedhit shënon 19.98% rritje midis viteve 2021 deri 2022, e cila mund t'i atribuohet rritjes së çmimeve të konsumit të mishit të gjedhit. Vlera dhe vëllimi i mishit të gjedhit të importuar u rritën në mënyrë të qëndrueshme. Vëllimi i importuar i mishit të gjedhit midis viteve 2018 dhe 2022 u rrit me 69.5%, ndërsa midis viteve 2021 dhe 2022 vëllimi i importeve të mishit të viçit u rrit me 21.12%. Vlera e përgjithshme e mishit të importuar midis viteve 2018 dhe 2022 u rrit me 96.90%, ndërsa midis viteve 2021 dhe 2022 vlera e importeve të mishit të gjedhit u rrit me 41.6%. Me këtë sasi prodhimi të mishit të gjedhit, shkalla e vetë-mjaftueshmërisë në vitin 2022 ishte rreth 40.1%. Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë së furnizimit me mish gjedhi me 33% midis viteve 2018 dhe 2022. Bilanci tregtar negativ i furnizimit me mish gjedhi midis viteve 2018 dhe 2022 u rrit me 90%. Krahasuar konsumin në mes viteve 2022 dhe 2018, vlera e konsumit e shprehur është në rritje prej 35%.

²⁷ <https://auvk.rks-gov.net/bizneset/bizneset-e-aprovuara-per-ushqime-me-origjine-shtazore/>

²⁸ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 70

Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për bilancin e furnizimit me mish viçi, 2018-2022.

Tabela 5-7. Bilanci i furnizimit me mish viçi 2018-2022

	Njësi	2018	2019	2020	2021	2022
Stoku i gjedhëve	Krerë	258,662	257,733	261,389	260,528	250,899
Lopë qumështi	Krerë	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Therrur në total	Krerë	114,149	114,318	116,048	116,204	115,214
Prodhimi i përgjithshëm vendas	mil Kg	19.5	19.5	19.7	19.8	19.7
Importet	mil Kg	15.2	16.6	18.1	25.4	31.4
Furnizimi	mil Kg	34.7	36.1	37.9	45.2	51.1
Eksportet	mil Kg	0.00	0.02	0.05	0.10	1.99
Përdorime shtëpiake	mil Kg	34.7	36.1	37.8	45.1	49.1
Vlera e prodhimit	Mil €	42.5	45.6	44.3	47.1	57.5
Totali i importeve	mil €	40	43.9	49.9	75.5	115.2
Bilanci tregtar	mil €	-40	-43.8	-49.7	-75.1	-106.7
Shkalla e vetëmjaftueshmërisë	%	56.1	54	52.2	43.9	40.1
Konsumi për frymë	Kg	19.3	20.1	21	25.5	27.7

6 Organizatat e Shoqërisë Civile dhe roli i tyre në përmirësimin e sektorit të qumështit

Me qëllim të zhvillimit të sektori të qumështit në Kosovë (prodhimit primar dhe përpunimi) që nga viti 2005 janë themeluar dy organizata të shoqërisë civile që mbështesin, këshillojnë, llobojnë për të gjithë prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit: Shoqata e prodhuesve të qumështit të Kosovës (SHPQK) që përfaqëson prodhuesit komercialë të qumështit dhe Shoqata e Përpunuesve Industrial të Qumështit të Kosovës (SHIQK) që përfaqëson përpunuesit e qumështit.

6.1 Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK)

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) është shoqata e vetme kombëtare e prodhuesve komercialë të qumështit në Kosovë. SHPQK ka 1,286 anëtarë të regjistruar dhe përfaqëson 30% fermerë komercialë të qumështit në Kosovë të cilët u shesin qumësht fabrikave të licencuara të përpunimit të qumështit.

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) është themeluar në vitin 2005. Selia e saj është e vendosur në Prishtinë në zyrën e marr me qira në qendër të qytetit dhe gjithashtu zyrën operative në objektet e Agjencisë Veterinare të Ushqimit të Kosovës në Prishtinë. SHPQK ka një faqe interneti (www.shpqk.org) e cila përcakton objektivat e Shoqatës, arritjet, vizionin e saj dhe çfarë ofron ajo për anëtarët e saj. Kostot operationale dhe administrative SHPQK i mbulon nga të hyrat që i merr nga kontrolli i pagesës mujore të qumështit që çdo prodhues qumështi merr nga përpunuesi i tij i qumështit për qumështin e papërpunuar të furnizuar në atë muaj të caktuar. Nëse ai fermer qumështor merr pjesë në skemën e testimit të qumështit të papërpunuar me shumicë dhe merr një subvencion nga MBPZHR në varësi të rezultateve të testimit të numrit të qelizave bakteriale të qumështit të mostrës. Zbritja është 0,002 cent për litër qumësht të dorëzuar në përpunuesin e qumështit, i cili dërgohet drejtpërdrejt përmes transfertës bankare nga përpunuesi i qumështit në SHPQK.

Të ardhurat e shoqatës rriten nga muaji në muaj, si dhe numri i përpunuesve të qumështit që transferojnë zbritjet. Ky është një tregues i rritjes së interesit të fermerëve për të marrë pjesë në skemë, si dhe rritjes së numrit të qumështoreve të gatshme për bashkëpunim.

Menaxhimi i SHPQK-ës - është një organizatë e fermerëve komercialë vendorë të qumështit nga e gjithë Kosova, që do të thotë se SHPQK-ës drejtohet nga përfaqësuesit e zgjedhur. Përfaqësuesit e përzgjedhur përbëjnë Bordin Drejtues të SHPQK-ës. Ata zgjedhin një kryetar dhe dy nënkryetarë nga anëtarët e tyre. Burimet njerëzore të SHPQK-ës përbajnë personelin teknik dhe administrativ: një drejtor i zgjedhur me konkurs, dy zyrtarë, 7 ofrues të shërbimeve në terren.

Kjo përqindje e fermerëve komercial (30%) është llogaritur në bazë të numrit të fermerëve komercial që kanë marr pagesa direkte në vitin 2023, 5,236 ferma të lopëve qumështorë që i plotësojnë kriteret për pagesa direkte, 5 e më shumë lopë qumështore. Në bazë të kësaj përqindje mbetet ende hapësirë e gjerë me qëllim të formalizimit të mëtutjeshëm të sektorit. SHPQK të shtojë dhe përmirësojë shërbime shtesë përmes aktiviteteve të drejtuara nga anëtarët me qëllim të rritjes së efikasitetit të prodhimit dhe konkurrencës së fermave të qumështit të Kosovës dhe rrjedhimisht të rrisë mbledhjen e tarifave të anëtarësimit. Qëllimi i SHPQK është të zhvillojë një shoqatë të vetë-qëndrueshme të prodhuesve të qumështit, e cila do të ofrojë shërbime të vlefshme për anëtarët e tyre, të tilla si menaxhimin e fermave të qumështit dhe aftësitë e zhvillimit të biznesit, informacionin teknik, avokimin e politikave dhe pjesëmarrjen në negociatat e politikave.

Objektivi i përgjithshëm i SHPQK-së është që të avancohet në: Qendër Kombëtare për regjistrimin e qumështit, shërbimet këshillimore në sektorin e qumështit, qendra e trajnimit për sektorin e qumështit, përgatitja e kurrikulave të trajnimit dhe certifikimi i tyre nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK). Mbrojtja e fermerëve nga praktikat e padrejta tregtare të imponuara nga produktet e importuara të qumështit dhe për më tepër avokimi dhe lobimi për industrinë vendase të qumështit për të ruajtur të njëjtat kushte loje për të gjithë aktorët pjesëmarrës në tregun e qumështit të Kosovës dhe në fund duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajoneve rurale të Kosovës duke konsoliduar fermat komerciale të qumështit. Për një efikasitet më të madh në prodhimin e qumështit të papërpunuar dhe rritjen e cilësisë më të lartë. Të arrijë ambiciet e SHPQK-së për anëtarët e saj dhe aspiratat e SHPQK-së për të bërë një industri konkurruese të qumështit të Kosovës të gjithë palët e interesuara të industrisë së qumështit të Kosovës; Fermerët e qumështit, përpunuesit e qumështit, politikëbërësit e MBPZHR, AUVK dhe stafi i FBVUP-ës, duhet të rriten dhe të angazhohen që sektori i qumështit të Kosovës të funksionojë për të gjithë njësoj.

Për të arritur këtë objektiv, janë identifikuar pesë drejtimet e mëposhtme të veprimeve:

- Forcimi i kapaciteteve të SHPQK për të qenë qendër kombëtare për regjistrimin e qumështit
- Rritja e kapacitetit të SHPQK për të zbatuar legjislacionin për grumbullimin e mostrave të qumështit në terren
- Krijimi i qendrës së trajnimit për sektorin e qumështit
- Krijimi i laboratorit të analizave të ushqimit për testimin e cilësisë së ushqimit
- Zhvillimi i programit të monitorimit të fermave të qumështit për anëtarët e SHPQK.
- Mbështetje për fermat "inteligjente" të mundësuar nga TIK (Teknologjitë e inovacionit dhe komunikimit) për të rritur prodhimin e qumështit
- Avokim dhe lobim

6.2 Shoqata e Përpunuesëve të Qumështit në Kosovë (SHIQK)

Shoqata e Përpunuesve të Qumështit të Kosovës SHIQK-ës përfaqëson 19 nga 35 përpunues të licencuar në Kosovë. Është një organizatë jofitimprurëse. SHIQK-ës lobon për përmirësimin e kornizës ligjore të industrisë së qumështit dhe kanë kontakte të rregullta me insitucionet qeveritare. SHPQK-ës dhe SHIQK-ës janë palët kryesore të dialogut shoqëror në sektorin e qumështit dhe janë partner të besueshëm për qeverinë lidhur me çështjet e qumështit. Është shumë e rëndësishme për zhvillimin e sektorit të qumështit që Kosova të fut në përdorim një sistem laboratorik publik transparent dhe neutral i cili pranohet gjerësisht nga prodhuesit dhe përpunuesit, por edhe nga konsumatorët të cilët kanë një interes të madh në qumësht me cilësi të lartë, si dhe qeverinë si përgjegjëse për të garantuar sigurinë e ushqimit në Kosovë. Gjithashtu, një sistem efektiv i kontrollit duhet të lehtësojë dhe përmirësojë pagesën e kualitetit për qumështin e Kosovës, duke përdorur ndëshkimin për cilësinë e qumështit që është nën standardet minimale dhe stimulimet e çmimit për kualitetin e jashtëzakonshëm të qumështit. Sektori i qumështit në Kosovë ka një treg të drejtë, neutral, transparent dhe publik të kontrolluar për qumështin e papërpunuar në favor të prodhimeve vendore të qumështit të kualitetit të mirë dhe të sigurt, si bazë kryesore për një skemë të pagesës të drejtpërdrejtë dhe subvencioneve për fermerët e qumështit.

Marrja e mostrave të qumështit të papërpunuar, testimi i tij dhe kontrolli i cilësisë si dhe mënyra e pagesës është transparente dhe gjerësisht e pranuar në Kosovë nga fermerët e qumështit, qumështoret dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës – AUV-it, Sistemi i marrjes së mostrave dhe testimi i sistemit për qumështin e papërpunuar në Kosovë bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ MA – Nr. 20/2006. Të gjithë shitësit e qumështit dhe produkteve të qumështit në Kosovë e kanë lejen e lëshuar nga AUV, jo vetëm për qumështore të licencuara. Sektori i qumështit në Kosovë mbështetet nga subvencioni publik dhe skema e pagesës së drejtpërdrejtë i cili mbështet fermerët e qumështit që e prodhojnë qumështin mbi standardet minimale të cilësisë të përcaktuara nga AUV.

7 Politika qeveritare për sektorin e gjedhtarisë (qumështit dhe mishit)

Politika e bujqësisë në sektorin e qumështit është udhëhequr kryesisht nga nevoja për të përmirësuar produktivitetin dhe për të rritur konkurrencën e produkteve të qumështit vendas. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës alokoi buxhetin prej €83.80 milion, për pagesat direkte (€57.5 milionë) dhe për grantet e investimeve (€26.3 milion), dhe në vitin 2021, alokoi buxhetin prej €48.5 milionë nga ku buxheti i planifikuar për pagesa direkte ishte €21.6 milion dhe €23.5 milionë për programin e zhvillimit rural.

Gjatë vitit 2022, Programi i pagesave direkte ka pasur disa kritere që fermeri duhej të mbarështonte të paktën 5 lopë qumështore ose buallica ose 5 lopë qumështore ose buallica krerë së bashku dhe përfitonte €90 /krerë, për mëshqerra për riprodhim €50 /krerë. Këto kritere kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2023, por ka pasur një ndryshim për buallica €180/krerë dhe pagesat direkte për viqat për majmëri janë €25/krerë por së paku fermeri të ketë 10 krerë. Por gjatë Programit për pagesa direkte 2024 me qëllim që të rritet numri i fermerëve përfitues, rritja e madhësisë së fermave dhe të hyrat e tyr, ka një ndryshim substancial që fermeri për ti plotësuar kriteret duhet ti ketë 5 lopë qumështore, buallica ose mëshqerra ose 5 lopë qumështore ose buallica krerë, dhe mëshqerra së bashku, moshja tyre nga 20 muaj deri në 12 vjet ose mëshqerra për riprodhim moshja nga 14-20 muaj. Premitë mbesin të njëjta në vitin 2023. Të gjitha kategoritë e kafshëve duhet të jenë të regjistruar në sistemin për identifikimin e kafshëve në AUVK.

Pagesa direkte (premitë) për qumështin sipas kategorisë së cilësisë - Fermerit duhet të dorëzonte të paktën 3,000 litra qumësht në qumështoret e licencuara brenda periudhës gjashtë mujore (sipas tremujorëve të vitit kalendarik). Fermeri përfitoi €0,07 /litër për qumështin e kategorisë ekstra, €0,04 /litër për qumështin e kategorisë së parë dhe €0,02 /litër për qumështin e kategorisë së dytë. Në vitin 2022, programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural i dha prioritet investimeve në diversifikimin rural; Ai gjithashtu ofroi mbështetje për prodhimin primar bujqësor dhe për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Masat mbështetëse duhet të sillen në përputhje me acquis të BE-së²⁹.

Në vitin 2022, mbështetja totale e alokuar përmes pagesave direkte për sektorin e qumështit ishte €7.08 milionë ose 13% e mbështetjes totale të alokuar përmes pagesave direkte për të gjitha kulturat bujqësore. Në vitin 2021, mbështetja totale e alokuar përmes pagesave direkte për sektorin e qumështit ishte 7,25³⁰. Ka një ndryshim signifikantë krahasuar me vitet tjera, viti 2020. Në vitin 2020, mbështetja që u dha në kuadër të masës 4A të Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike është përfshirë gjithashtu, por për shkak se mbështetja ka qenë e dyfishtë për shkak të COVID 19 (€14,3 milion). Në 2022-ën, shumica më e madhe e subvencioneve nga totali i subvencioneve të alokuara për sektorin e qumështit, të alokuar për krerë lopë qumështore ishte €4,7 millio, që është 62% e totalit të subvencioneve të alokuara për sektorin e qumështit. Por krahasuar numri fermerëve përfitues për krerë ndërmjet vitit 2022 dhe vitit 2018, kemi një diferencë, një ulje të numrit të përfituesëve prej -24.4% dhe po ashtu numri i krerëve në këto dy vite krahasuese ka rënë prej -23.80, dhe shume totale e pagua është rrit prej 0.40% ose shprehur €4.7milion. Pra si përfundim kemi një rënie të lartë të numrit të fermerëve dhe numrit të krerëve. Sa i përket cilësisë së qumështit numri përfituesëve në mes dy viteve krahasuese 2018 dhe 2022 ka një rënie shumë të lartë të numrit të përfituesëve prej -58% kurse në të kundërtën numri litrave të paguara ka një rritje prej 34%, që dmth numri fermerëve është zvogluar dhe numri krerëve të lopëve qumështore por është rrit sasia e qumështit e dorëzuar nga fermerët, te një numër i caktuar i fermerëve është rrit sasia e qumështit të dorëzuar, kuptohet janë rritë edhe të hyrat. Në lidhje me therrjet e raportuara të gjedhit nëse krahasohen brenda një periudhe 5 vjeqare në vitet krahasuese 2022 dhe 2018 numri i përfituesëve (në këtë rast therrtove) ka një rënie prej -54%. Nga 24 përfitues/therrtove në vitin 2018 në 11 përfitues/therrtove në vitin 2022, kurse trend pozitiv që është për të vlerësuar se numri i krerëve të paguar është rrit me 15% në vitet krahasuese 2018 dhe 2022. Krejt në fund viqat e mbështetur financiarisht janë analizuar vetëm në dy vite qysh prej kur ka filluar mbështetja financiare 2021 dhe 2022. Kemi një rënie sa i përket numrit të përfituesëve prej -14.5%, po ashtu një rënie të numrit të krerëve prej -2.5%, por që kjo don të thotë se fermerët e caktuar kanë rrit tufat e tyre, kurse krejt në fund kemi një rritje të shumës së paguar të përgjithshme për shkak se kemi një rritje signifikante të mbështetjes nga 10 në €25 për krerë.

²⁹https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf,

³⁰ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 109

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Tabela 7-1. Pagesat direkte 2018-2022, në €

Lopë qumështore	2018	2019	2020	2021	2022	Differenca
Numri i përfituesve	7,395	6,606	6,905	6,105	5,589	(24.40)
Numri i krerëve të paguar	67,811	62,478	67,295	57,571	52,527	(23.80)
Pagesa për krerë	70	70	140	85	90	
Shuma totale e paguar	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535	4,727,430	(0.40)
Qumësht	2018	2019	2020	2021	2022	
Numri i përfituesve	3,055	1,798	1,245	1,149	1,286	-58
Numri i litrave të paguara	34,522,414	38,664,480	47,515,642	44,835,136	46,183,417	34
Pagesa për litër	0.06/0.04/ 0.02	0.06/0.04/ 0.02	0.12/ 0.08/ 0.04	0.06/ 0.04/ 0.02	0.07/0.04/ 0.02	
Shuma totale e paguar	1,736,944	1,736,944	4,906,204	2,358,351	2,358,351	36
Therje të raportuar të gjedhit	2018	2019	2020	2021	2022	
Numri i përfituesve	24	13	9	7	11	-54
Numri i krerëve të paguar	978	971	706	701	1,122	15
Pagesa për krerë	50	50	100	50	50	
Shuma totale e paguar	48,900	48,550	70,600	35,050	56,100	15
Viça për majmëri	2018	2019	2020	2021	2022	
Numri i përfituesve				462	395	-14.5
Numri i krerëve të paguar				7,938	7,732	-2.5
Pagesa për krerë				10	25	
Shuma totale e paguar				79,380	193,300	144

Tabela më lartë tregon buxhetin e disponueshëm për vitin 2022, i cili ndryshon shumë nga vitet e mëparshme kryesisht viti 2021. Kjo ka ndodh sepse gjatë vitit 2022 janë rrit pagesat për kultura bujqësore, mbështetja në pleh, në naftë dhe sasin e dorëzuar të drithërave.

Por nje analizë me e detalizaur në lidhje me pagesat direkte, numrin e perfituesëve, numrin e krerëve të paguar, ndikimi në ngritjen e prodhimit primar, trendet e lëvizjes së sektorit, arsyeshmërinë e perkrahjes do ta gjeni në vazhdim.

Rezultatet e studimit të sektorit të blegtorisë zbuluan se programi i qeverisë për pagesa direkte (Subvencione për krerë) nuk përformoi mirë në rritjen e përdorimit të tokës, në të ardhurat bruto, në zëvendësimet e importit ose në numrin e lopëve qumështore në fermë midis fermave të mbështetura dhe jo të mbështetura. Për më tepër, përkundër mbështetjes së qeverisë përmes pagesave direkte për vitet 2018-2022, importet e produkteve blegtorale u rritën në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa nga ana tjetër përdorimi i tokës dhe numri i lopëve pati një rënie të lehtë për të njëjtën periudhë. Pika e vetme e fortë e programit të qeverisë për pagesat direkte për prodhimin e qumështit ishte pagesa direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar. Rritja e numrit të mostrave të qumështit të papërpunuar në kategorinë ekstra është një tregues i mirë që pagesa direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar po ndikon në përmirësimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe kjo është një situatë fituese për të gjithë zinxhirin e furnizimit të qumështit.

Blegtorët e ndiejnë rëndësinë e mbështetjes së qeverisë për ruajtjen e situatës aktuale në sektorin e blegtorisë në Kosovë duke qenë se pa mbështetjen e qeverisë sektori i blegtorisë do të përkeqësohet më tej.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh rezultatet e qeverisë dhe analizën e vlerësimit të ndikimit të programit të pagesave direkte, është thelbësore që MBPZHR-ja ta riprojektojë politikën e blegtorisë, veçanërisht skemën e subvencioneve për krerë, duke mbajtur pagesat direkte për krerë lope qumështore (pagesat e ndara nga prodhimi), edhe pse kjo praktikë nuk dha rezultatet e pritshme. MBPZHR duhet të transferoj/ngrit fondet nga pagesat direkte për krerë dhe kultura bujqësore në subvencione të cilësisë së qumështit të papërpunuar, duke rritur çmimin premium për çdo kategori të qumështit të papërpunuar. Reforma e cilësisë së qumështit të papërpunuar subvencionin çmimin duke përfshirë skemën e subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe fermerët e qumështit të cilët janë në kategorinë e tretë. Kjo vlen për dhënien e një stimuli për fermerët e vegjël të qumështit që janë në kategorinë e tretë për formalizimin e kanaleve të marketingut dhe për raportimin e prodhimit të tyre të qumështit dhe të shitjeve të qumështit, si dhe për rritjen e numrit të fermerëve të regjistruar të qumështit. Mbështetja e kombinuar me pagesat direkte të bazuara në cilësinë e qumështit të papërpunuar do të rrisë formalizimin e sektorit të blegtorisë dhe do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave të fermave të qumështit në lopë qumështore për analiza dhe studime sektoriale në të ardhmen. Kjo do t'i motivojë blegtorët të përmirësojnë praktikën e ushqimit të bagëtive, të ndryshojnë strukturën e shumimit dhe të rrisin numrin e lopëve.

Përveç pagesës direkte për promovimin e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe për rritjen e konkurrencës së tregut, Qeveria e Kosovës ofron mbështetje përmes granteve për investime. Masa 101: Investimi në asetet fizike të njësive ekonomike familjare bujqësore është pjesë e mbështetjes së granteve për investime në zhvillimin rural. Mbështetja me grante synon rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në agrobizneset lokale, krijimin e vende të reja të punës, rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së produkteve bujqësore, zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së jetës. Për shkak se shumica e fermave janë shumë të vogla, vërehet nevoja e përqendrimit të mbështetjes e investimeve në asetet fizike të fermave të orientuara në treg dhe që janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme. Në 2022-ën numri i përfituesëve për masën 101 në sektorin e qumështit (lopë) ishte 34 me një vlerë prej €1,95 milion,

Tabela 7-2. Numri përfituesëve në vitin 2022, në nëmasat 1.7 dhe 1.9 shprehur në €

Masa 1: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore				
Nën-masat:	Nr. Përfituesëve	Shuma paguar (million), €	Shuma totalit të paguar (million), €	%
1.7 Prodhimi qumështit/lope	34	1.85		
1.9 Pikat grumbulluese të qumështit	2	0.10		
Gjithësejt		1.95	13	15

Masa 103 mbështet investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në katër nën-sektorë: përfshirë përpunimin e qumështit, në 2022-ën. Numri i përfituesëve për masën 103 në sektorin e qumështit ishte 1 me një vlerë prej €0.15 milion. Për më shumë detaje shih tabelën në vijim.

Tabela 7-3. Numri përfituesëve në vitin 2022 në nëmasat 3,1, shprehur në €

Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore				
Nën-masat:	Nr. Përfituesëve	Shuma paguar (million), €	Shuma totalit të paguar (million), €	%
Përpunimi qumështit	1	0.15		
Gjithësejt		0.15	5.8	2.59

Buxheti i përgjithshëm për mbështetjen e këtyre masave dhe nënmasave është €26.3 milionë, i ndarë për Masën 1 (€13 milionë), masën 3 (€5.8 milionë), masën 7 (€7.2 milionë) dhe masën 5 (€200,000). Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të detajuar buxheti i ndarë sipas masave dhe nënmasave³¹.

Marrë parasysh rëndësin dhe të hyrat e këtyrë 2 nënsektorëve % e pjesëmarrjes në masat 1 dhe 2 është modeste, nënmasat e masës 1 përfshijnë 15% të investimeve në këtë masë kurse 6% të Masa 3.

Pavarësisht reformave thelbësore dhe rritjes së buxhetit për periudhën 2018 - 2022, struktura joadekuate e tregut, fragmentimi i tokës dhe prodhimtaria e ulët e pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe të zonave rurale. Përqindja më e madhe e buxhetit për përmirësimin e konkurrencës së sektorit bujqësor shkon për masat që synojnë ristrukturimin e fermave. Mbështetja për ristrukturimin në fermë është zbatuar kryesisht në formën e mbështetjes për investime të përqendruara në disa nënsektorë bujqësorë (shpezë, fruta, perime dhe vreshta, qumësht dhe mish, drithëra, mjaltë) dhe në ristrukturimin e fermave të tjera. Në vitin 2022, fondet për investimet në fermë u rritën duke treguar ndërgjegjësimin e politikave për nevojën e rritjes së produktivitetit të fermës dhe të cilësisë së produkteve bujqësore, si dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës. Mbështetja për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor ka për qëllim përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Mbështetja ka për qëllim të përmirësojë përdorimin e produkteve bujqësore përmes përmirësimit të prodhimit me vlerë më të lartë, krijimit të qendrave të grumbullimit, paketimit dhe magazinimit dhe prezantimit të HACCP në lidhje me sigurinë e ushqimit dhe për të përmbushur kërkesat e BE-së. Fondet e ekzekutuara për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor nuk kanë ndryshuar shumë ndër vite. Ndërkohë, shumë projekte të implementuara nën këtë masë u mbështetën edhe nga fondet e BE-së.

Mbështetja e qeverisë përmes pagesave direkte në sektorin e mishit është marginale. Përveç pagesës direkte për promovimin e raportimit të gjedheve të therura në thertore me €50 për kafshë të therur dhe me buxhetin total vjetor prej €56,100 për vitin 2022. Politika e përgjithshme e MBPZHR-së për sektorin e mishit është përqendruar vetëm në mbështetjen e prodhuesve dhe përpunuesve të mishit përmes investimeve qeveritare të granteve për përmirësimin e fermave të bagëtive (akomodimi, pajisjet e prodhimit përfshirë sanën dhe ushqimin për bagëtitë). Në vitin 2022, numri i aplikimeve të miratuara për masën 101 në sektorin e mishit të vëçit ishte 39 projekte të miratuara në vlerën prej €2,24 milio.

Tabela 7-4. Numri përfituesëve në vitin 2022 në nënmasat 1.5, në €

Masa 1: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore				
Nën-masat:	Nr. Përfituesëve	Shuma paguar (million), €	Shuma totalit të paguar (million), €	%
1.5 Prodhimi mishit/rritja e viqave	39	2,24		
Gjithësejt		2,24	13	17

Masa 103 mbështet investimet në industrinë e përpunimit të mishit. Objektivat specifike të kësaj mase për sektorin e mishit përfshijnë zbatimin e standardeve kombëtare dhe të BE-së për produktet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, mbrojtja e mjedisit etj.). Në vitin 2022, kishte vetëm një përpunues i mishit përfitues i një grant prej €200,000 përmes masës 103.

³¹ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, page 134

Tabela 7-5. Numri përfituesëve në vitin 2022 në nëmasat 3.2, në €

Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore				
Nën-masat:	Nr. Përfituesëve	Shuma paguar (million), €	Shuma totalit të paguar (million), €	%
Përpunimi mishit	1	0.2		
Gjithsëejt		0.20	5.8	3.45

Zhvillimi i përgjithshëm i politikës bujqësore në Kosovë drejtohet kryesisht nga perspektivat e integritit në BE. Siç u përmend në seksionet e mëparshme, bujqësia është një nga sektorët më kërkuar dhe kompleks në zhvillimin e politikave të Kosovës, si dhe në lëvizjen drejt pajtueshmërisë me PPB të BE-së dhe acquis të BE-së.

7.1 Përpunimi i qumështit

Grantet për përpunimin e qumështit duhet të përqendrohen në diversifikimin e produkteve dhe në përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore. Grantet nuk duhet të jepen për rritjen e kapaciteteve përpunuese për të paktën 3 vitet e ardhshme. Sipas informacionit, rreth 36% e kapacitetit të instalimit po përdoret për përpunimin e qumështit. Në sektorin e përpunimit të qumështit duhet të mbështeten përpunuesit që tregojnë interes për përpunimin e qumështit të deleve dhe dhive, por që kanë nevojë për kontroll shumë rigoroz para se të firmosin kontratën e mbështetjes. Aplikantët duhet të vërtetojnë se qumështi do të mblidhet nga fermerët lokalë të paktën për tre vjet.

Propozohet që në masën 103 – Përpunimi - procedurat për vlerësimin e planit të biznesit duhet të ndryshojnë dhe të analizojnë planin e biznesit nga ekspertë të pavarur (vendas ose ndërkombëtarë) në këtë sektor. Me rëndësi të veçantë duhet parë nëse projekti do të ndikojë në diversifikimin e produkteve, jo si deri më tani kur aplikanti raportonte vetëm se do të prodhonte produkte të reja dhe në fakt ato produkte po prodhoheshin edhe para aplikimit. Prioritet duhet t'u jepet aplikantëve që kanë në plan të prodhojnë produkte me jetë të gjatë në pikat e shitjes dhe të investojnë në Rregulloret e Standardeve të Identitetit të Qumështit. Ky është hap shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e konsumatorëve dhe prodhuesve vendas.

7.2 Përpunimi i mishit

Qendrat e përpunuesve të mishit aktualisht janë duke punuar me mish të ngrirë të importuar. Ata nuk shohin interes në përpunimin e mishit të freskët lokal për shkak të çmimit më të lirë të mishit të ngrirë, por edhe për shkak se vet-mjaftueshmëria për mish në Kosovë është vetëm 40%. Edhe pse ky sektor është mbështetur me grante investive, ka pasur rezultate të limituara në integrimin e fermerëve në sektorin e mishit. Mbështetja me ndihmën e sektorit të përpunimit të mishit duhet të rishikohet dhe studjohet me kujdes. Investimi duhet të përqendrohet në procesin e thërjes, implementimin e standardeve të sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe stimulimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit. Vet-mjaftueshmëria e mishit është vetëm 40% në KS, ska gjase me vazhdue aktivitetin e tyre përpunuesit e mishit, pa import të mishit. Propozohet të kryhet një studim se si veprojnë vendet rajonale, vendet e Ballkanit Përendimor dhe disa vende të BE).

Në tre vitet e ardhshme, mbështetja duhet të përqendrohet tek thertoret që të përmirësojnë infrastrukturën, të modernizojnë linjat e thertoreve dhe të zbatojnë standardet e sigurisë ushqimore. Fokusi kryesor duhet të vihet te linjat e thertoreve të qengjit në mënyrë që të merret licenca e eksportit për eksportimin e mishit të qengjit. Për eksportimin e qengjave në tregun e BE-së, AUV-ja duhet të zbatohet procesin me dy hapa

- Çrënjësja e sëmundjes së kafshëve
- Marrja e licencës së BE-së për thertoren e qengjit

8 Tregu dhe Tregtia e produkteve Blegtorale

8.1 Sektori i qumështit

Republika e Kosovës ka një nga tregjet më liberale në Ballkanin perëndimor, dhe është vendi më i ri i Evropës dhe një nga më të varfrit, por që ka mbajtur norma pozitive të rritjes ekonomike për më shumë se një dekadë. Pas rimëkëmbjes ekonomike nga COVID-19, PBV-ja e Kosovës u rrit me 3.5% në vitin 2022, një normë e nxitur kryesisht nga eksportet dhe konsumi privat. Rritja e PBV-së së Kosovës pritet të mbetet e qëndrueshme me aktivitetin ekonomik për vitin 2023 që parashikohet të rritet në 3.5% nga FMN. Sipas Doganës së Kosovës, partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës janë vendet e BE-së (afërsisht 44% e importeve dhe 30% e eksporteve) dhe fqinjët e saj të Ballkanit Perëndimor, me të cilët Kosova tregon pa tarifa sipas kushteve të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).). Vendet e CEFTA-s janë burimi i afërsisht 19% të importeve dhe destinacioni i 38% të eksporteve. Përveç remitancave, të cilat vlera afro 15 për qind të BPV-së, ekonomia e Kosovës nxitet edhe nga turizmi i diasporës në muajt e verës. Remitancat, megjithatë, janë shumë të orientuara drejt konsumit dhe investimeve të pakta.

Që nga pavarësia, Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm ekonomik, megjithatë mbetet disa sfida, veçanërisht një ekonomi e madhe joformale, varësia e madhe nga remitancat dhe shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht në mesin e grave, të rinjve dhe pakicave etnike. Integrimi i kufizuar ekonomik rajonal dhe tensionet e vazhdueshme me Serbinë fqinje shërbejnë si barriera kryesore për tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Megjithatë, politikat ekonomike jokonsistente, ndërhyrja politike dhe dialogu i kufizuar publiko-privat paraqesin gjithashtu sfida për investitorët dhe punojnë për të kufizuar IHD-të thelbësore për zhvillimin ekonomik. Në qershor 2023, qeveria e Kosovës, duke përmendur shqetësimet e sigurisë, vendosi një ndalim për mallrat me origjinë serbe që ka shkaktuar konfuzion të madh te importuesit dhe ka dëmtuar kompanitë në pronësi të subjekteve të huaja në Kosovë për shkak të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit.

Të dhënat jozyrtare të punësimit në Kosovë, të vlerësuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, tregojnë një rënie premtuese nga 25.9 % në vitin 2020 në 12.6 % në vitin 2022. Kushtet e vështira të tregut të punës prekin në mënyrë disproporcionale të rinjtë dhe gratë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm një në pesë gra në Kosovë merr pjesë në fuqinë punëtore, një nga normat më të ulëta në botë. Ndërsa është bërë përparim në adresimin e informalitetit, një ekonomi e madhe informale ekziston ende dhe mund të mos përfshihet në të dhënat zyrtare, veçanërisht në sektorin e bujqësisë.

Përkundër këtyre sfidave, popullsia relativisht e re e Kosovës, me mbi 50 % nën moshën 25 vjeçare, kapaciteti i gjuhës angleze, kostoja e ulët e punës dhe burimet e bollshme natyrore kanë tërhequr disa investime të rëndësishme dhe disa firma ndërkombëtare dhe ekskluzivitete janë të pranishme në treg.

Disa karakteristika të dobishme të tregut përfshijnë:

Regjimi liberal tregtar i Kosovës, mundëson eksporte pa doganë për shumicën e eksporteve kosovare në tregun e BE-së. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në ka përforcuar më tej liberalizimin e tregtisë dhe ka hequr shumë nga barrierat e mbetura tregtare dhe tarifore. Vendndodhja e Kosovës në zemër të Ballkanit ofron qasje të lehtë në tregjet fqinje dhe anëtarët e CEFTA-s, një treg prej rreth 28 milionë banorësh. Infrastruktura e Kosovës është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme vitet e fundit, duke përfshirë përfundimin e autostradave moderne për në Shqipëri dhe gjithashtu për në Maqedoninë e Veriut.

Kostot e punës në Kosovë dhe politikat tatimore janë konkurruese. Agjencia e Statistikave të Kosovës raporton se paga mesatare mujore e Kosovës para tatimit për punëtorët e sektorit publik dhe privat është €521; mesatarja vetëm për sektorin privat është €473. Këto paga janë ndër më të ulëtat në Evropë dhe regjimi aktual i taksave është i favorshëm për biznesin me një taksë të sheshtë prej 10% mbi të ardhurat e korporatave.³²

Si një anëtare e rrjetit kryesor të transportit të financuar nga BE-ja, 6 vendet e Ballkanit Përendimore (WB6: Kosova, Serbia, Bosnja dhe Hercegovica, Mali i Zi, Shqipëria, dhe Maqedonia Veriore), i cili synon përmirësimin e lidhjes rajonale, Kosova planifikon të rigjallërojë autostradat dhe linjat hekurudhore kyçe si për transportin e brendshëm, ashtu edhe për lidhjet me vendet fqinje.

Me mbështetjen e qeverisë së SHBA-së, Gjykata Ekonomike e Kosovës filloi shqyrtimin e rasteve në gusht të vitit 2022 dhe synon të përmirësojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare, të forcojë zbatimin e vendimeve dhe të krijojë një mjedis të favorshëm për investime dhe rritje ekonomike. Duke festuar përvjetorin e saj të parë, gjykata tashmë ka demonstruar sukses në reduktimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve komplekse tregtare në kohën e duhur dhe efikase.

Qumështi total i gjedhit i prodhuar në Kosovë gjatë vitit 2022 është 309,343,479 litra qumësht, ky qumësht shitet në tre segmente të ndryshme tregut: Konsumi në shtëpi rreth 41%, Tregu i gjelbër (i freskët) rreth 27% dhe tregu i përpunuar rreth 33%.³³ Kosova importon një sasi të konsiderueshme të produkteve të qumështit për të përmbushur nevojat e saj për konsum. Gjatë periudhës 2018-2022, Kosova ka importuar qumësht dhe produkte qumështi në sasi të ndryshme. Sipas të dhënave të importit të siguruara nga ASK, nëse shikohet ndër vite, importet e qumështit kanë pasur oscilime sa i përket rritjes dhe uljes së importeve nga 2018 në 2022 çdo vit, por në vitin 2022 ka një rënie të lartë të importeve të produkteve të qumështit në vlerë prej 11%. Gjatë këtyre viteve vëllimet më të mëdha të importeve janë në vitin 2019, me gjithsej 51,139 t produkte qumështi të importuara, ndërsa më e ulta është në 2022 me 64,666 tonë. Nga 2018 në 2022 importet e produkteve të qumështit patën rritjen më të lartë me 11%. Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2022 importet e produkteve të qumështit kanë rënë me 11% në vëllim. Është interesante të theksohet se rritja e vlerës së importeve është më e madhe se rritja e vëllimit të importeve. Kështu që edhe pse në vitin 2022 ka pasur një rritje të vëllimit të importeve me 11% në krahasim me vitin 2021, por në aspektin e vlerës monetare ka pasur një rritje të vlerës prej 8.3% në krahasim me vitin 2021. Rritjet ndërkombëtare të çmimeve për artikujt bazë të ushqimit, siç janë qumështi, kanë pasur ndikim dramatik edhe në bilancin tregtar për Kosovën dhe tendenca e rritjes së deficiteve tregtare duhet të jetë shqetësuese në nivelin e qeverisë.

Nëse shikohet eksporti në raport me importin, ekziston një ndryshim i madh në vëllim, sepse kemi një rritje të eksporteve lineare. Kosova krahasuar me eksportet, importon vëllime dhe vlera shumë më të larta të qumështit. Tabela më poshtë tregon sasinë për tonë të produkteve të qumështit të eksportuara nga viti 2018 në 2022. Siç mund të shihet, sasia më e lartë e produkteve të qumështit është eksportuar në 2022-ën me 1,195 tonë.

³² <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-market-overview>

³³ <https://askapi.rks-gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>

Tabela 8-1. Importet dhe eksportet e produkteve të qumështit 2018-2022

		2018	2019	2020	2021	2022
Lopë qumështore	Heads	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Qumështi Prodhuar	t	277,599	277,138	281,960	278,746	276,058
Importet	t (p.e)	70,596	76,139	71,129	72,642	64,666
Furnizimi	t (p.e)	348,195	353,277	353,089	351,388	340,724
Exportet	t (p.e)	572	866	984	1,018	1,195
Konsumi shtëpiak	t (p.e)	347,623	352,411	352,105	350,370	339,529
Vetë-mjaftueshmëri	t (p.e)	79.9	78.6	80.1	79.6	81.3
Humbja	t (p.e)	5,552	5,543	5,639	5,575	5,521
Konsumimi për ushqimin e viqave të fermës	t (p.e)	40,807	40,739	41,448	40,976	40,581
Përpunimi	t (p.e)	26,848	27,340	27,172	27,090	26,083
Konsumi njerzor	t (p.e)	274,416	278,789	277,846	276,730	267,345
Cmimet prodhues (në fermë)	€/kg	0.31	0.32	0.33	0.31	0.34
Vlera prodhimit	mil EUR	71.7	73.9	77.5	72.0	78.2
Bilanci Tregtar	mil EUR	-30	-29.9	-29.4	-31.7	-36.7
Konsumi për kokë	kg (p.e.)	168	172	170	171	165

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22); p.e. – product equivalent

8.2 Niveli i cilësisë së produktit

Konsumatorët gjithnjë e më shumë po kërkojnë që të gjitha ushqimet, përfshirë produktet e qumështit, të jenë të sigurta, ushqyese dhe të freskëta. Fakti që fëmijët konsumojnë afërsisht 50% të të gjithë qumështit në shumicën e vendeve është i rëndësishëm jo vetëm për të siguruar, por edhe për të përfutur një përshtypje të favorshme për qumështin dhe për produktet e qumështit kështu që ata do të vazhdojnë të jenë konsumatorë të produkteve tona kur të rriten dhe të kenë familjet e tyre. Është e rëndësishme të kuptohet se cilësia e qumështit që arrin në fabrikën e përpunimit të qumështit përcaktohet nga cilësia e qumështit që merret nga fermat e qumështit. Prodhimi i qumështit të papërpunuar me cilësi të lartë dhe përpunimi i produkteve të qumështit me cilësi të lartë mund të përcaktohet si një situatë me fitim për të gjitha palët sipas formulës “win-win”. Konsumatorët fitojnë sepse: (1) marrin produkte që kanë shije të parashikueshme; (2) produktet janë më ushqyese dhe më të sigurta; dhe (3) produktet e ruajnë cilësinë më shumë gjatë magazinimit. Përpunuesit e qumështit fitojnë sepse: (1) produktet e tyre plotësojnë standardet e cilësisë së konsumatorëve, duke rezultuar në më pak ankesa dhe në rritje të konsumit të markës së tyre të produkteve të qumështit; dhe (2) mund të prodhojnë më shumë djathë dhe produkte të tjera të qumështit të fermentuar nga i njëjti vëllim qumështi i papërpunuar. Fermerët e qumështit fitojnë për shkak të rritjes së kërkesës për qumështin e tyre të papërpunuar, i cili do të përkthehet në të ardhura më të larta dhe në rritje të fitimeve. Pagesa e primeve për qumështin e papërpunuar me cilësi të lartë dhe vendosja e penaliteteve për qumështin me cilësi të ulët kanë rezultuar të jenë stimuj të fuqishëm për motivimin e fermerëve për të përmirësuar cilësinë e qumështit të tyre të papërpunuar.

Programi për pagesën e primeve për qumështin e papërpunuar me cilësi të lartë përqendrohet në pagesën e primeve dhe parametrat e cilësisë së qumështit të papërpunuar që përfshihen në pagesën e primeve përmes programit të subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar të prezantuar nga MBPZHR-ja përfshijnë: (1) Numrin e plotë të bakteve dhe (2) Numrin e qelizave somatike (SCC - the number of cells per ml of milk).

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Zbatimi i programit të subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar të MBPZHR-s bazohet në standardet e përcaktuara me dekretin 20/2006 për cilësinë e qumështit të papërpunuar. Falë programit të subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar, cilësia e qumështit të papërpunuar që shkon për përpunim të mëtejshëm në fabrikat e qumështit po përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme. Sipas informatave që janë marr në SHPQK për afërsisht numri mostrave ka pas njëtrajshmëri sa i përket numrit të mostrave me përjashtim të vitit 2020 në periudhën e COVID 19 numri mostrave ka qene më i vogël. Krahasuar numrin e mostrave në vitin 2019 (para COVID 19) dhe mostrat e marra në vitin 2020, ka qenë një rënie prej 18.2%.

Tabela 8-2. Kategorizimi i qumështit sipas cilësisë nëpër vite 2019 - 2023 shprehur në litra & %

Klasifikimi	Viti									
	2019	%	2020	%	2021	%	2022	%	2023	%
Extra	8,352	44	7,138	44	8,777	44	8,778	47	8,778	50
Klasa I	606	3	543	3	697	3	637	3	597	3
Klasa II	2,880	15	2,487	15	3,063	15	2,824	15	2,416	14
Klasa III	7,167	38	5,901	37	7,473	37	6,331	34	5,675	32
Totali	19,005		16,069		20,010		18,570		17,466	

Që nga viti 2015 kur MBPZHR-ja për herë të parë shpalli thirrjen për aplikim për akses në fonde për programin e subvencionimit të cilësisë së qumështit, numri i fermerëve të qumështit të interesuar për t'u bërë pjesë e projektit po rritet në mënyrë të vazhdueshme. Po ashtu, progresi në përmirësimin e cilësisë së qumështit me të cilin furnizohen përpunuesit e qumështit për zhvillimin e produkteve të qumështit të fermentuar është duke avancuar dhe ka një përmirësim të knaqshëm. Së pari, numri i mostrave të qumështit të testuar në shkallë vendi është i vogël. Testet mesatare të qumështit në vitet që po analizohen një mesatare vjetore 18,224 ishin mostra qumështi të testuara. Sa i përket mostrave të analizuara nëpër vite ka një progres në përmirësimin e cilësisë. Në vitin 2019, 2020 dhe 2021, rreth 44% e mostrave totale të qumështit të testuar ishin në kategorinë ekstra ndërsa në vitin 2021, 47% e numrit të mostrave të qumështit ishin në kategorinë ekstra dhe në vitin 2022, rreth 50% e mostrave totale të qumështit të testuar ishin në kategorinë ekstra .Nëse krahasojmë vitin 2023 me periudhën kohore tri vjeqare (2019, 2020 dhe 2021), përmirësimi i cilësisë së qumështit ka një përmirësim signifikant, 6.81% më shume e mostrave i takojnë kategorisë së qumështit ekstra. Nuk ka ndryshime signifikante në mostrat që i takojnë kategorisë klasa 1 dhe 2. Kurse sa i përket kategorise së 3, nëse krahasohen % së mostrave që i takojnë kësaj kategorije ndryshon nëpër vite. Kështu që nëse krahasohet % e mostrave në vitin 2019 që ishte 38% kurse në vitin 2022, mostra në këtë kategori ishin 34% kurse në vitin 2023 ishte 32%. Kjo flet se më së shumti se janë fermerët që kanë bërë përmirësim, ata që kanë qenë më herët në kategorin e tretë. Kjo është një arsye që duhet të mbështetet edhe kategoria e tretë e cilësisë së qumështit me të vetmin qëllim përmirësim dhe formalizimin e sektorit të qumështit.

Një shqetësimi i konsiderueshem për MBPZHR-në që ishte më herët, gjatë kësaj analize është se tani nga qumështi total i tesuar akoma 50% e qumështit total të testuar në vend është në kategorinë I dhe qumështi i tesuar që renditet në kategorinë e tretë është zvogluar në 32%. Konkurrenca dhe suksesi i ardhshëm i industrisë së qumështit në Kosovë varet kryesisht nga aftësia e fermerit të për të prodhuar lëndë të parë me cilësi të lartë që përpunuesit mund ta përdorin për gjenerimin e produkteve të qumështit me cilësi të lartë. Aftësia për të adoptuar teknologji të re dhe për të zbatuar praktikatat që gjenerojnë lëndë të parë me cilësi të lartë është një domosdoshmëri për mbijetesën e industrisë së qumështit.

Përpunuesit e qumështit duhet të jenë të interesuar për prodhimin e një produkti që është i dëshirueshëm dhe i përballueshëm nga konsumatorët e Kosovës. Qeveria e Kosovës duhet të jetë e gatshme të përcaktojë standarde dhe rregullore që do të rezultojnë në një produkt më të sigurt ose të paktën të perceptuar të sigurt nga konsumatorët.

8.3 Sektori i mishit

Kosova importon një sasi të konsiderueshme produktesh mishi për të përmbushur nevojat e saj për konsum. Llojet e mishit të cilat konsumohen në Kosovë janë kryesisht mish pule, pasuar nga mishi i viçit, deleve, dhive dhe mishi i derrit. Gjatë periudhës 2018-2022, Kosova ka importuar mish në sasi të ndryshme. Importet totale të mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme në vitin 2022 ishin rreth €125 milionë, që përbënte rreth 10.4% të importeve totale të bujqësisë ose përqindja e dytë më e madhe e importeve totale bujqësore për vitin 2022 (Pije, pije alkoolike dhe uthull kodi 22). Nga gjithsej €125 milionë importe të produkteve të mishit, në vitin 2022, importet e mishit të freskët dhe të ngrirë të gjedhit ishin €44 milionë, që është 59% e importeve totale të mishit. Konsumi i përgjithshëm i mishit për frymë në Kosovë vlerësohet rreth 50 kg/vit. Sipas importit, të dhënat e siguruar nga "Raporti i Gjellbër" nëse analizohen vitet, mund të zbulohet se importet e mishit janë rritur vazhdimisht nga 2018 në 2022. Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për importet dhe eksportet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme për vitet 2018 deri në vitin 2022.

Tabela 8-3. Importi dhe eksporti i produkteve të mishit për vitet 2018-2022, në 1000 €³⁴

	2018	2,020	2020	2021	2022
Importet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme	64,878	74,391	60,824	82,618	125,315
Eksportet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme	127	333	337	654	7,828

Importet e mishit dhe të brendshmeve të ngrënshme janë rritur vazhdimisht që nga viti 2018. Në vitin 2022 importet e mishit dhe brendshmeve të ngrënshme të mishit u rritën me 93% krahasuar me 2018, ndërsa në krahasim me vitin 2021 importi i mishit u rrit me rreth 51%. Nëse shikojmë eksportet dhe importet, vërehet një ndryshim i madh pasi eksportet mbulojnë vetëm 6.24% të importeve totale të mishit për vitin 2022.

Një trend negativ u regjistrua në katër vitet e fundit në çmimet mesatare në fermë për demat dhe mështjerrat. Bazuar në Raportin e Gjellbër 2022, çmimi për dem dhe mjeshtërr në fermë midis viteve 2021 deri në 2022 u ul me 7%. Çmimi me pakicë për dema dhe mështjerra ka një rënje 18.6% midis viteve 2019 dhe 2022, ndërsa çmimet me shumicë për demat midis viteve 2018 dhe 2019 u rritën me 2%.

Tabela 8-4. Çmimet mesatare vjetore të demave dhe mështjerrave, €/kg, - 2019-2022³⁵

Kategoria	Lloji i çmimit	2019 (€)	2020 (€)	2021 (€)	2022 (€)
Demat dhe mështjerrat	Çmimi në fermë	1.97	2.21	2.53	2.71
Demat dhe mështjerrat	Çmimi me shumicë	3.31	2.93	2.65	2.89
Demat dhe mështjerrat	Çmimi me pakicë	3.75	3.02	2.49	3.05

³⁴ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 95

³⁵ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 31

8.4 Pikat mbizotëruese të tregut, efektiviteti dhe mundësitë e tyre

Ashtu si në shumë vende të tjera fqinje dhe evropiane, sektori i supermarketeve po rritet me shpejtësi në Kosovë. Ekzistojnë një sërë zinxhirësh supermarketesh, të cilët gradualisht po diferencohen nga njëri-tjetri. Tre zinxhirët më të mëdhenj të supermarketeve, ETC, Viva Fresh dhe Interex e kanë dyfishuar ose shumëfishuar siq është Viva Fresh, numrin e pikave të tyre të shitjes me pakicë në tre vitet e fundit dhe zinxhirët e tjerë po zgjerohen me shpejtësi, si Meridian Express. Të gjithë këta zinxhirë supermarketesh kanë hapur dyqane të shumta të mëdha në qytetet kryesore të Kosovës; Zinxhirët e supermarketeve kanë një sërë strategjish blerjeje; të gjitha supermarketet marrin produkte qumështi të prodhuara në vend direkt nga fabrikat e përpunimit të qumështit. Zinxhirët e supermarketeve importojnë gjithashtu drejtpërdrejt disa produkte qumështi nga vendet fqinje dhe nga BE-ja, ndoshta me qëllim rritjen e marzhit të fitimit. Një problem që pengon marrëdhëniet midis pikave të tregut dhe fabrikave të përpunimit të qumështit është vonesa e pagesave për më shumë se tre muaj, duke dëmtuar kështu likuiditetin e të gjithë aktorëve në zinxhirin e vlerës së qumështit.

Sasi të mëdha të mishit të viçi importohen, kryesisht për produktet e përpunuara të mishit, p.sh., sallamet dhe mishrat e tymosur. Furnizuesi kryesor është Brazili si për shpendët ashtu edhe për mishin e ngrirë të vicit. Procedura është që thertoret i sjellin disa krerë në dyqanin ku ata theren në ambiente të jashtme, mishi nuk ka gjasa të kontrollohet. Mishi i viçit, mishi i lopës dhe sallamet janë artikuj të rëndësishëm të mishit që ofrohen në dyqanet e mishtoreve.

Çmimet në fermë janë në parim çmimet e marra nga fermerët për prodhimin e tyre në fermë. Nga 2019 në 2022 çmimet mesatare vjetore të qumështit në fermë u ngritën me 61%, dhe çmimi mesatar në demave dhe mëshqerrat nga 2019 në 2022 u rrit me 37.5%. Në krahasim me 2018, në vitin 2019 u regjistrua një trend pozitiv në çmimet mesatare vjetore në fermë për qumështin me 9.6%, kurse viçat dhe mëshqerrat me 7.1%. Tabela më poshtë tregon çmimet mesatare vjetore në fermë në €/kg për vitet 2019 deri në 2022.

Tabela 8-5. Çmimet mesatare vjetore në fermë në €/kg, - 2019-2022³⁶

	2019	2020	2021	2022
Qumësht	0.21	0.23	0.31	0.34
Viçat dhe mëshqerrat	1.97	2.21	2.53	2.71

Me çmime të paqëndrueshme ushqimi me bazë bujqësinë, qeveritë kanë qenë nën presion të shtuar për të rritur mbrojtjen e tarifave ose për të siguruar ndihmë shtetërore për të garantuar çmime shpërblyese dhe për të ruajtur të ardhurat e fermave brenda vendit, shpesh në kurriz të vendeve më të vogla që nuk mund të konkurrojnë me aktorët e mëdhenj të bujqësisë të importeve. Duke parë zhvillimin e shpejtë të supermarketeve në vend, prodhuesit e qumështit, dhe mishit në Kosovë duhet të përgatiten për një sistem tjetër me pakicë, për shkak të çmimeve të paqëndrueshme të konsumit në të cilat shumë më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet cilësisë dhe qëndrueshmërisë (plotësimi të standardeve), Niveli i ulët i organizimit/integrimit të fermerëve të vegjël, fermerëve të mishit dhe mjedisi i papërshtatshëm i kontraktimit po paraqesin sfida të mëtejshme për zhvillimin e sektorit të blegtorisë në Kosovë. Ndërsa trendi i çmimeve mesatare vjetore në nivel ferme, ishte pozitiv për vitet 2019 - 2022, një trend shumë më i favorshëm u regjistrua në çmimet mesatare të konsumit për të njëjtën periudhë. Nga 2019 në 2022, çmimet mesatare vjetore të konsumit u ulë me 18.6%, qumështi me 17.6%.

³⁶ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 29

Tabela 8-6. Çmimet mesatare vjetore të konsumit në €/kg

		2018	2019	2020	2021	2022
Qumësht	€	0,47	0,48	0,47	0,49	0,51
Viçat dhe mëshqerrat	€	3.8	3.65	3.7	3.8	3.75

Me rënien e çmimeve mesatare vjetore të qumështit në nivel ferme dhe me rritjen e çmimeve mesatare të konsumit të qumështit duket se shpërndarja aktuale e fitimit në zinxhirin e furnizimit të qumështit, mishit dhe vezëve nuk është e ekuilibruar: supermarketet dhe fabrikat e përpunimit të qumështit dhe mishit janë duke shënuar marzhin më të lartë të fitimit.

8.5 Disponueshmëria e produkteve

Zhvillimi i shpejtë i zinxhirëve të supermarketeve ka pasojë të rëndësishme për rritjen e shitjeve dhe për rritjen e pjesës së tregut për industrinë lokale të qumështit. Pjesa më e madhe e shitjeve të produkteve të qumështit vendas kalon nëpër zinxhirët e supermarketeve (diskutime me fermer komercial, përpunuesit e qumështit, supermarketet) të cilat furnizohen mirë me markat vendase dhe ndërkombëtare të produkteve të qumështit. Nuk ka të dhëna të disponueshme për të ditur saktësisht se cilat janë shitjet e produkteve të qumështit vendas në zinxhirët e supermarketeve në Kosovë. Disponueshmëria e produkteve të qumështit për konsum të brendshëm po llogaritet me formulën: "Prodhimi, plus Importet, minus Eksportet". Shifrat më të fundit, nga 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, mbi prodhimin, importet dhe eksportet, disponibilitetet e brendshme paraqiten në tabelën vijuese.

Tabela 8-7. Disponueshmëria e produkteve të qumështit³⁷

	Njësitë	2018	2019	2020	2021	2022
Prodhimi i qumështit	Ton	277,599	277,138	281,960	278,746	276,058
Importet	Ton	70,596	76,139	71,129	72,642	64,666
Furnizimi total	Ton	348,195	353,277	353,089	351,389	340,724
Eksportet	Ton	572	866	984	1,018	1,195
Vetëmjaftueshmëria (për konsum)	Ton	347,624	352,411	352,105	350,371	339,529

8.6 Modelet e konsumit

Sektori i qumështit në Kosovë po bëhet më i përparuar për shkak të kërkesave të shitësve me pakicë dhe konsumatorëve për standarde dhe investime më të larta nga fabrikat e përpunimit të qumështit. Përmes pranisë së gjerë të pikave moderne të shitjes me pakicë vendore dhe ndërkombëtare (Spar), modelet e konsumit të konsumatorëve kosovarë janë larguar nga blerja e produkteve të qumështit në tregun e gjelbër të parregulluar dhe dyqanet e shitjes me pakicë të lagjeve në shkallë të vogël drejt blerjes së produkteve të qumështit në zinxhirët e mëdhenj të supermarketeve.

Konsumatorët e Kosovës janë shumë të ndjeshëm ndaj çmimeve. Për shkak të fuqisë së ulët blerëse të modeleve të konsumit, konsumatorët në Kosovë janë drejtuar drejt konsumimit të produkteve të qumështit me çmim më të ulët si kos i thjeshtë, djathë i bardhë dhe gjizë. Bazuar në të dhënat e varfërisë së Bankës Botërore 2017, vlerësohet se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5% të popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme.

³⁷ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf, faqe 71

Varfëria dhe nivelet ekstreme të varfërisë kanë qenë sistematikisht më të larta në zonat rurale sesa në zonat urbane (Banka Botërore, 2019).

Mishi është produkti më i rëndësishëm i blegtorisë dhe gjithashtu një nga artikujt kryesorë ushqimorë mishi përfaqëson 19% të një shporte mesatare konsumit të familjeve në Kosovë (MBPZHR, 2014). Mishi i viçit dhe mishi i pulës janë llojet më popullore të mishit. Produktet kryesore të përpunuara të mishit të viçit janë sallami tradicional dhe proshuta. Edhe pse konsumi i përgjithshëm i mishit në Kosovë është më i ulët se mesatarja e BE-së, ai është më i lartë se në vendet e tjera fqinje. Kjo është për shkak të konsumit të mishit të viçit dhe mishit të pulës, ndërsa konsumi i mishit të derrit është i papërfillshëm, për shkaqe fetare dhe kulturore. Ndërsa niveli i të ardhurave është rritur, ka të ngjarë që në vitet e ardhshme të rritet edhe konsumi i mishit.

Konsumi botëror i mishit është rritur në vitet e fundit dhe pritet të rritet me një mesatare prej 1% në vit në periudhën 2017-2030 (një normë pak më e ulët krahasuar me vitet e fundit). Tregjet me rritje të konsiderueshme janë në Azi, Afrikën Sub-Sahariane dhe Lindjen e Mesme (kryesisht për shpendët).

Në vitin 2020, në vendet e BE-së konsumi i mishit për kokë banori ishte rreth 69 kilogramë mish të shprehur në ekuivalentin vjetor të peshës me pakicë dhe 236 kilogram qumësht në litra ekuivalent të qumështit. Mishi i derrit ishte në vendin e parë (31 kg) i ndjekur nga shpezët (25 kg) dhe mishi i ripërtpësve (11 për mishin e viçin dhe 1.8 kg për mishin e deleve). Konsumi i mishit në BE për frymë u rrit për disa dekada përpara se të fillonte të binte në vitet e fundit. Konsumi i mishit pritet të bjerë më tej deri në vitin 2030. Rënia shoqërohet me një zhvendosje në shportën e konsumatorit me uljen e konsumit të mishit të viçit dhe me një zëvendësim të vazhdueshëm të mishit të derrit me mishin e shpendëve. Shifrat mesatare në të gjithë BE-në mbulojnë pabarazi të konsiderueshme kombëtare, si për mishin ashtu edhe për qumështin, për sa i përket konsumit aktual dhe tendencave me kalimin e kohës. Ky heterogjenitet mund të ilustruhet duke vërejtur se konsumi vjetor për frymë ndryshon për mishin nga 34 kilogramë në Bullgari në 62 kilogramë në Luksemburg. Që nga viti 2011, ka pasur rënie të ndjeshme të konsumit të mishit në Itali (-8 kg), Gjermani (-10 kg) dhe Belgjikë (-26 kg) por ndryshime më të vogla në Francë gjatë së njëjtës periudhë, megjithëse ka pasur një zhvendosje nga mishi i gjedhit tek mishi i pulës.

Sipas intervistave me ekspertë, lloji i vetëm i mishit për të cilin Kosova ka një potencial për eksport (duke supozuar heqjen e ndalimit të eksportit në BE) është mishi i qengjit, duke marrë parasysh rritjen e pritshme të konsumit të mishit në BE.

8.7 Kuadri ligjor për tregtinë

Kosova është anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe ka nënshkruar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë (MTL) me Shqipërinë, Maqedoninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Turqinë. Që nga prilli 2016, Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) ka qenë në fuqi, e cila eliminon detyrimet doganore për mbi 1,044 importe bujqësore dhe 487 importe peshkimi nga BE-ja. Sipas së njëjtës marrëveshje, tarifatat doganore për importet industriale do të hiqen gradualisht për një periudhë prej 10 vjetësh, me heqjen e plotë të që pritet të ndodhë në 2026-ën. Kosova nuk ka kufizime të përgjithshme mbi importet. Sipas rastit, produkteve u kërkohet t'i nënshtrohen inspektimeve sanitare, fitosanitare ose veterinare në kontrollin e kufirit. Ligji dhe sistemi i TVSH-së në Kosovë bazohet në Direktivën e BE-së për TVSH-në (Direktiva 2006/112/E). Kosova ka miratuar një Kod Doganash dhe Akcize në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe të Organizatës Botërore të Doganave. Kosova përdor një plan të integruar tarifor të ndarë në kategori të mallrave dhe norma të zbatueshme. Kosova i zbaton standardet evropiane dhe ndërkombëtare si standardet e Kosovës (International Trade Administration, 2020).

Kodi i Doganave dhe i Akcizave të Kosovës është miqësor ndaj biznesit me qëllim lehtësimin e tregtisë dhe stimulimin e rritjes së eksportit. Ai është në përputhje me standardet e BE-së dhe Organizatës Botërore të Doganave (US Department of Commerce, 2017). Kosova ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët dhe procedurat standarde të funksionimit për kontrollet e ushqimit.

8.8 Pengesat ekzistuese të tregtisë

Kosova nuk ka kufizime të përgjithshme në importe dhe është një nga tregjet më liberale në Ballkanin Perëndimor. Pengesat jo-tarifore janë një nga pengesat më të zakonshme për tregtinë. Shumë vende përballen me pengesa të ndryshme jo-tarifore nga vendet e tjera për arsye të ndryshme. Problemet politike shumë herë ishin arsye për vendosjen e barrierave jo-tarifore si një pengesë ose protestë kundër marrëdhënieve të këqija politike. Zbatimi i barrierave jotarifore për problemet politike është rasti i Serbisë kundër prodhuesve të Kosovës me fokus në produktet ushqimore bujqësore. Pengesat dhe barrierat e ndryshme janë përdorur vazhdimisht nga autoritetet e Serbisë për të penguar eksportet e Kosovës sepse Serbia ende nuk i njihte disa dokumente të eksportuesve të Kosovës. Të gjitha këto probleme të natyrave të ndryshme që Serbia zbaton kundër eksportuesve të Kosovës, po i bëjnë ata më pak konkurrues dhe përbëjnë shkelje të rregullave dhe rregulloreve të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Pengesat jotarifore po zbatohen edhe për produktet bujqësore të Kosovës të eksportuara në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut në bazë të Rregullit të Origjinës, Çmimeve të Referencës dhe Procedurave Sanitare dhe Fitosanitare.

9 Niveli i përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të BE-së

Megjithëse Kosova është në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE, legjislacioni duhet ende të harmonizohet me acquis të BE-së dhe të zbatohet përkatësisht. Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të vazhdojë të hartojë dhe të implementojë një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me kërkesat e Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve. Planifikimi dhe zbatimi afatgjatë i programeve për zhdukjen e sëmundjeve endemike në Kosovë ka ende nevojë për përmirësim. E njëjta gjë vlen për kontrollet e shëndetit të kafshëve në nivelin e fermës dhe transportin e kafshëve, transportin në tregjet e bagëtive dhe transportin e kafshëve endacake. Zbatimi i programeve në këto zona nuk është i kënaqshëm.

Bashkimi Evropian dihet që ka kërkesat dhe standardet më të larta të sigurisë dhe cilësisë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve agro-ushqimore; BE-ja pret që përfituesit që do të kenë akses në tregun e saj të përbashkët të zhvillojnë dhe të zbatojnë masa sigurie dhe cilësie të ngjashme ose ekuivalente me ato të BE-së. Kosova, në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE, ka harmonizuar plotësisht legjislacionin bujqësor me acquis të BE-së. Sidoqoftë, zbatimi i ligjeve është i dobët. Kosova ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët dhe ka zhvilluar procedura standarde operimi për inspektimet dhe kontrollet e ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Ajo ka hartuar 19 akte ligjore dhe nënligjore (Komisioni Evropian, 2020). Në situatën aktuale, Kosova nuk lejohet të eksportojë kafshë të gjalla dhe ushqime me origjinë shtazore në BE dhe eksporti i produkteve të tjera bujqësore i nënshtrohet kërkesave të sigurisë dhe cilësisë. Problemi me eksportet nuk është te përpunuesi, por tek agjencia veterinarë për mos eliminimin e disa sëmundjeve të kafshëve ose mbajtjen nën kontroll të këtyre sëmundjeve. Kryesisht përpunuesit e qumështit dhe të mishit kanë investuar në mjete të teknologjisë së lartë dhe përmbushin kriteret në standardet e sigurisë ushqimore.

Kjo nuk e lejon Kosovën të përfitojë plotësisht nga mundësia për të eksportuar në BE dhe vendet në rajon të cilat po e harmonizojnë politikën e tyre kombëtare me kërkesat e acquis të BE-së sipas Kapitullit 12 Siguria e ushqimit, politika fitosanitare dhe veterinare (Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, 2020). Për sektorin e sigurisë ushqimore, AUV është një agjenci ekzekutive pjesë integrale e MBPZHR, përgjegjëse për zbatimin e sistemit të integruar të Kontrollit të Ushqimit, i njohur më mirë në BE si "nga ferma te piruni". Objektivi kryesor i Agjencisë është të sigurojë që ushqimi i prodhuar ose i importuar në Kosovë të jetë i sigurt për konsum dhe me cilësi të përshtatshme. Në vitin 2016 Kosova kishte disa shpërthime sëmundjesh dhe problemet e sëmundjeve endemike janë të dukshme. Kjo situatë po shkakton: probleme në shëndetin publik kur kemi të bëjmë me sëmundje zoonotike; humbje ekonomike në nivel ferme dhe kosto për kontrollin dhe zhdukjen e sëmundjeve; kufizime tregtare dhe të lëvizjes për kafshët e gjalla dhe për ushqimin me origjinë shtazore etj. Për më tepër, MBPZHR duhet të krijojë Kodet e Praktikave të Mira Bujqësore që do të implementohen nga fermerët blegtoralë mbi baza vullnetare. Masat për kufizimin e periudhave të aplikimit të plehrave azotike në tokë, masat për kufizimin e kushteve të aplikimit të plehrave në terrene me pjerrësi të madhe, kriteret për kapacitetet ruajtëse minimale për plehun e bagëtisë, kufijtë e aplikimit të azotit nga plehu organik në bazë të direktivave të BE-së përshkruajnë se sasia më e lartë e azotit nga plehu organik që mund të aplikohet çdo vit është 170 kg/ha.

Ndonëse produktet e kafshëve konsiderohen mjaft të rëndësishme në negociatat e MSA-së dhe gëzojnë zero taksë doganore, për fat të keq, prodhuesit e produkteve të kafshëve nga Kosova nuk kanë qenë në gjendje të eksportojnë produkte të tilla sepse Kosova nuk ishte vend i pranueshëm për BE-në për eksportimin e produkteve shtazore. Shumë herë, eksportuesve të mjaltit, kosit, mishit dhe produkteve të tjera të kafshëve u ishte refuzuar hyrja në vendet e BE-së ose madje edhe tranziti për shkak të rregullores BE 605/2010 (Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian, 2010).

Zhvillimet të reja ndodhën më 09 korrik 2020, ku Bashkimi Evropian përmes vendimit të botuar L 220/5 njofton përfshirjen e Kosovës në listën e vendeve me të drejtë eksportimi të produkteve me origjinë shtazore në vendet e Bashkimit Evropian. Nisur nga ky vendim, Drejtoria për Shëndetin dhe Sigurinë e Ushqimit DG SANTE e konsideron Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Republikës së Kosovës si një partner kontraktual. Një vend ka të drejtë të eksportojë ushqim me origjinë shtazore në BE, vetëm nëse ka marrë miratimin nga Komisioni për planet e mbetjeve që paraqet çdo vit pranë Komisionit për speciet e ndryshme të kafshëve me interes. Kjo do të thotë që Kosova ka të drejtë të paraqesë brenda datës 31 mars të çdo viti çdo kërkesë të re për produkte të reja shtazore që i plotëson standardet e BE-së për eksport.

9.1 Cilësia e prodhimit primar dhe sekondar

Suksesi më i madh deri më tani sa i përket mbështetjes së një industrie konkurruese dhe të sigurt të qumështit në Kosovë ka qenë udhëzimi administrativ 20/2006 në lidhje me vendosjen e standardeve të cilësisë së qumështit të papërpunuar. Nënshkruar në shtator 2006, udhëzimi administrativ për cilësinë e qumështit të papërpunuar 20/2006 vendosi një korrigjim pagese për qumështin e papërpunuar bazuar në standardet e cilësisë së qumështit. Ai krijoi një diferencë në çmim prej 35% midis kategorive më të larta dhe më të ulta të qumështit të shitur përmes kanaleve tregtare. Ky dekret ofron një stimul ekonomik për prodhuesit për përmirësimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe adreson një nga dobësitë kryesore funksionale në zinxhirin e vlerës së qumështit në Kosovë: sasinë dhe cilësinë e pamjaftueshme të qumështit të papërpunuar. Që nga 1 janari 2009, standardet e cilësisë së qumështit për qumështin e papërpunuar janë të ngjashme me standardet e BE-së. Numri i baktereve <80,000 për ml dhe numri i qelizave somatike <300,000 për ml. .

9.2 Higjiena dhe siguria ushqimore në fermë dhe nivelet e përpunimit, duke u përqendruar në standardet për mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë

Kosova punon vazhdimisht drejt përditësimit të legjislacionit të saj në përmbushjen e kërkesave të BE-së. Sipas Ligjit të Ushqimit në Kosovë, të gjithë operatorët e bizneseve ushqimor, përveç nivelit të prodhimit primar duhet të vendosin dhe të zbatojnë kontrollin e rregullt të kushteve higjienike të prodhimit në çdo objekt nën kontrollin e tij me anë të zbatimit të procedurave parandaluese të vetëkontrollit, të hartuara sipas parimeve të sistemit të Analizave të Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik (HACCP). Pavarësisht miratimit të ligjit për mirëqenien e kafshëve, Kosova nuk ka standarde minimale dhe masa për ndër-përputhshmërinë në fushat e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Përmirësimi i shëndetit veterinar dhe përditësimi i laboratorit do të përfshijnë masat e përshtatjes ndaj standardeve më të larta të qëndrueshmërisë mjedisore (p.sh. mbetjet e kafshëve). Mbetjet e rrezikshme mund të shkaktojnë kërcënime për shëndetin e njeriut ose për mjedisin nëse menaxhohen në mënyrë jo të duhur.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se legjislacioni i Kosovës në fushën e shëndetit të kafshëve dhe të sigurisë së ushqimit është pothuajse plotësisht i harmonizuar me Acquis të BE-së me fusha të caktuara që ende duhet të rregullohen siç janë, siguria e ushqimit të kafshëve dhe produktet me origjinë shtazore. Sidoqoftë, legjislacioni zbatohet pjesërisht në terren për shkak të mungesës së burimeve njerëzore të mjaftueshme nën kontrollin e AUV-së. Në këtë situatë, rialokimi i inspektorëve komunalë është me prioritet të lartë dhe se është implementuar. Personeli që punon në nivel qendror duhet gjithashtu të rritet në mënyrë që të përballlet me ngarkesën në rritje të punës në lidhje me procesin e pranimit në BE. Për më tepër, një përpjekje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të institucionit aktual të ngritur në lidhje me: vendosjen e funksionit të auditimit në nivelin qendror, rajonal dhe lokal; vlerësimin e rrezikut dhe komunikimin e rrezikut; transparencën; sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve që mbarten nga ushqimi; autorizimin e laboratorëve zyrtarë dhe të referencës; trajnimin e stafit.

Një nga kriteret e pranueshmërisë së IPARD III është: Kushti që përcakton se "investimet duhet të kontribuojnë në përmirësimin e situatës së sektorit bazë të prodhimit bujqësor në fjalë" mund të përkthehet në kriteret e përzgjedhjes duke i dhënë prioritet më të madh projekteve me përqindje të lartë lëndësh të para të marra përmes kontratave të lidhura drejtpërdrejt me fermerët. Të gjitha furnizimet e blera sipas kësaj mase do të vijnë nga një vend i pranueshëm. Megjithatë, ato mund të vijnë nga secili vend kur sasia e furnizimeve që do të blihen është nën pragun për përdorimin e procedurës së negociuar konkurruese (aktualisht €100,000).

Sipas të dhënave, sasia më e madhe e mishit të importuar që shkon për përpunim vjen nga shteti jo i pranueshëm/jo anëtar dhe deri më tani investimet në përpunimin e mishit nuk kanë kontribuar në përmirësimin e situatës bazike të sektorit për prodhimin e mishit.

9.3 Mirëqenia e kafshëve

Komisioni Evropian ka promovuar mirëqenien e kafshëve për më shumë se 40 vite duke përmirësuar gradualisht jetën e kafshëve të fermës. Në vitin 1998, një hap i rëndësishëm ishte Direktiva e Këshillit 98/58/KE mbrojtja e kafshëve të mbajtura për qëllime bujqësore, e cila siguron rregulla të përgjithshme për mbrojtjen e kafshëve të të gjitha llojeve të mbajtura për prodhimin e ushqimit, leshit, lëkurës ose gëzofit ose për qëllime të tjera bujqësore, duke përfshirë peshqit, zvarranikët ose amfibët. Rregulla bazohen në Konventa Evropiane për

Mbrojtjen e kafshëve të mbajtura për qëllime bujqësore dhe pasqyrojnë të ashtuquajturat “Pesë Liritë”:

- Liria nga uria dhe etja
- Liria nga shqetësimi
- Liria nga dhimbjet, lëndimet dhe sëmundjet
- Liria për të shprehur sjellje normale
- Liri nga frika dhe shqetësimi

Kosova, në vitin 2005, ka miratuar ligjin për mirëqenien e kafshëve, por deri më tani nuk ka rregullore specifike që përcaktojnë kriteret dhe kushtet për secilën kategori të kafshëve.

Normat për standardet e higjienës dhe mirëqenien e kafshëve kanë arritur nivel të mirë harmonizimi me *aquis* të BE-së dhe praktikat e mirëqenies së kafshëve janë përgjithësisht të pranueshme, me disa kufizime. Përgjithësisht, furnizimi me ujë vjen nga burime disi të kontrollueshme (puse të dedikuara, ujësjellës etj.). Legjislacioni sipas harmonizimit me *aquis* të BE-së për aktivitetet blegtorale parashikohet nga një direktivë e përgjithshme ombrellë 98/58/BE që mbulon të gjitha llojet e kultivuara blegtorale dhe katër direktiva specifike që mbulojnë përkatësisht viçat, derrat, pulat për prodhimin e vezëve dhe pulat për prodhimin e mishit (broilerat) ndërsa transporti dhe therrja e kafshëve mbulohen nga rregulloret, të cilat vendosin kërkesa të ngjashme për të gjitha shtetet anëtare. Në lidhje me sektorin e qumështit dhe mishit të gjedhit përveq direktivës së përgjithshme janë specifiike: Direktiva e BE-së 2008/1193: Viçat, dhe dy rregullore: Rregullorja 1/20059: Transporti i kafshëve dhe Rregullorja 1099/200910: Therrja e kafshëve

Nuk ekziston realisht asnjë sistem inspektimi për blegtorinë në nivel ferme, duke penguar të gjithë procesin e kontrollit dhe respektimit të rregullave e kriterëve. Disa aktivitete kryhen nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Standardet mjedisore janë më pak të zhvilluara se standardet e tjera. Aktualisht, cilësia e ujit të përdorur për kafshët nuk kontrollohet.

9.4 Siguria ushqimore

Siguria ushqimore është e lidhur ngushtë me faktin që ushqimi është një nga mënyrat më të zakonshme të futjes së substancave të padëshiruara në zinxhirin ushqimor përmes kafshëve nga të cilat prodhohet ushqimi. Kriza e fundit e BE-së si dioksina dhe BSE – “sëmundja e lopës së çmendur” erdhi nga ushqimi i kontaminuar i përdorur në bujqësinë industriale. Prandaj është shumë e rëndësishme të kemi një sistem që garanton sigurinë e ushqimit që përdoret në terren.

AUV angazhohet fuqimisht në zbatimin e sistemit të sigurisë së ushqimit të kafshëve në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Për këtë qëllim, sektori i ushqimit është futur tashmë në organigramën e Agjencisë por nuk është ende funksional. Në të njëjtën kohë AUV po punon me draft rregulloret për higjienën e ushqimit për kafshë me mbështetjen e projektit të financuar nga BE-ja. Aktivitetet në këtë fushë do të lidhen me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm (udhëzime), alokimin e burimeve njerëzore të përshtatshme, trajnimin dhe zbatimin e kontroleve në terren (Burimi: vlerësimi i institucionit aktual të AVUK-ut, 2017).

9.5 Niveli aktual i përputhshmërisë me standardet përkatëse kombëtare dhe të BE-së dhe numri i ndërmarrjeve të miratuara nga BE-ja për eksporte (certifikatat e eksportit të BE-së)

Aktualisht, produktet e qumështit ose produkte e tjera me origjinë shtazore të prodhuara nga fabrikat e përpunimit të qumështit në Kosovë nuk lejohen të eksportohen në tregjet e BE-së për shkak të kriterëve të sigurisë dhe cilësisë (BE-ja për Sigurinë e Ushqimit në Kosovë) Prandaj asnjë nga fabrikat e qumështit në Kosovë nuk kanë licencë eksporti për eksportin e produkteve të qumështit në tregjet e BE-së.

9.6 Programe të tjera për përditësimin e standardeve të BE-së në Kosovë

Politika e përbashkët bujqësore e BE-së mbështet fermerët dhe siguron sigurinë ushqimore të Evropës. Nëpërmes këtyre politikave ndihmohet në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve kombëtare; mirëmbajten e zonave rurale dhe peizazhet në të gjithë BE-në; dhe mban gjallë ekonominë rurale duke promovuar vende pune në bujqësi, industri agroushqimore dhe sektorë të lidhur. Kjo kërkon sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të përbashkëta të BE-së për standardet e marketingut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike. Këto fusha përfshijnë: Rekomanimet që gjenden në raportin e progresit 2024, janë të lidhur me Klusterin 5. Ky kluster përmban 5 kapituj, ku janë edhe 3 kapituj të lidhur me fermerët dhe sigurinë ushqimore: (Kapitulli 11 - Bujqësia); Kapitulli 12 - siguria ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare dhe kapitulli 13 – Peshkataria dhe akuakultura. Në vazhdim do të gjeni të gjitha rekomandimet që janë të lidhura më këta tre kapituj që janë përmendur më lartë, që janë të lidhura me sektorin e blegtorisë.

1. Bujqësia (Kapitulli 11)³⁸

- Për çështjet horizontale, programi kombëtar për bujqësinë dhe zhvillimin rural për 2023-2027 u miratua në tetor 2023. Masat mbështetëse duhet të përputhen me acquis të BE-së.
- Kosova duhet të forcojë dhe ruajë kapacitetet e saj dhe të ndërmarrë hapa drejt zhvillimit të një sistemi të integruar të administrimit dhe kontrollit, rrjetit të të dhënave për qëndrueshmërinë e fermave.
- Për organizimin e tregut të përbashkët, Ligji për organizimin e tregut të produkteve bujqësore është miratuar në dhjetor të vitit 2023. Legjislacioni zbatues i tij duhet të përgatitet.
- Kosova vazhdoi të përparojë në politikën e cilësisë duke regjistruar një tregues të dytë gjeografik. Megjithatë, procesi i regjistrimit dhe kontrolli duhet të përafrohet me acquis të BE-së.
- Për bujqësinë organike, legjislacioni duhet të përafrohet me acquis të BE-së, duhet të zbatohet plani kombëtar i veprimit organik 2023-2026 dhe duhet të ndërmerren veprime për t'i dhënë përparësi bujqësisë dhe prodhimit organik si një element ndërsektorial në kuadër të programit kombëtar për bujqësinë. dhe zhvillimin rural.
- Kosova ende duhet të ndryshojë ose shfuqizojë Ligjin për tokën bujqësore dhe një plan veprimi për të adresuar humbjen dhe degradimin e tokës bujqësore.

³⁸ Kosovo* 2024 Report, faqe 84

2. Siguria ushqimore, Politikat veterinare dhe fitosanitare (Kapitulli 12)³⁹.

- Acquis i BE-së për ushqimin, duke përfshirë rregullat e higjienës së BE-së për prodhimin e produkteve ushqimore, sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe një mbrojtje të nivelit të lartë të interesave të konsumatorëve.
- Në fushën e sigurisë ushqimore, Kosova ende duhet të miratojë legjislacionin dytësor për Ligjin për ushqimin dhe strategjinë për harmonizimin e acquis të BE-së në fushën e politikave veterinare dhe fitosanitare.
- Burimet financiare dhe njerëzore të AUV-së mbeten të pamjaftueshme për zbatimin e acquis të BE-së.
- Sistemi i gjurmueshmërisë dhe menaxhimit të kontrollit të ushqimit dhe sistemi i menaxhimit të informacionit laboratorik janë funksionalë, por nevojiten më shumë burime për t'i forcuar dhe mirëmbajtur në mënyrë sistematike. Pas transferimit të 58 inspektorëve në Ministrinë e Shëndetësisë, agjencia duhet të rekrutojë me ngulm inspektorët e ushqimit, të krijojë një njësi epidemiologjike dhe të zbatojë legjislacionin përkatës lidhur me qasjen e bazuar në rrezik në inspektimet brenda Kosovës si dhe në importe.
- Agjencia vazhdoi punën e saj për zbatimin e planit kombëtar për kontrollin dhe monitorimin e ushqimit dhe të sëmundjeve të kafshëve dhe përfundoi me sukses skemat e detyrueshme të testimit të aftësisë me laboratorët referencë të BE-së si pjesë e akreditimit laboratorik.
- Në fushën e politikës veterinare, përderisa Kosova mori nga BE-ja financimin e fushatës për çrrënjosjen dhe vaksinimin e tërbimit, qeveria ende duhet të miratojë një ligj për shëndetin e kafshëve dhe të shfuqizojë Ligjin për veterinarin e vitit 2004 me një të ri.
- Agjencia ende nuk ka miratuar planin pesë-vjeçar të zhvillimit për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe nuk ka caktuar burime për zbatimin e tij.
- Burimet për kontrollet e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve në nivel ferme, gjatë transportit mbeten të pamjaftueshme, duke përfshirë thertoret dhe tregjet e bagëtive.
- Kosova miratoi një udhëzim të ri administrativ për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve. Megjithatë, lëvizjet e kafshëve mbeten të nën-raportuara dhe kontrollet ende nuk janë forcuar.
- Kosova duhet të përfundojë harmonizimin e legjislacionit të saj me legjislacionin e BE-së për mirëqenien e kafshëve dhe të sigurojë burime adekuate për zbatimin e tij.
- Kosova ka bërë disa përparime në identifikimin e masave bazë të ndër-përputhshmërisë në fushat e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. U përgatitën lista kontrolluese dhe udhëzime përkatëse.
- Për hedhjen në treg të ushqimeve, ushqimeve për kafshë dhe nënprodukteve shtazore, vendimtar mbetet zbatimi i një sistemi për grumbullimin dhe asgjësimin e sigurt të nënprodukteve shtazore si dhe miratimi i modelit për funksionimin e fabrikës ekzistuese të përpunimi mbeturinave shtazore. Kosova adresoi gjetjet e Komisionit Evropian për planin e tyre kombëtar të monitorimit të mbetjeve.

³⁹ Kosovo* 2024 Report, faqe 84

3. Peshkataria dhe akuakultura – Kapitulli 13⁴⁰

Politika e përbashkët e peshkimit përcakton rregulla për menaxhimin e peshkimit, mbron burimet e gjalla të detit dhe kufizon ndikimin mjedisor të peshkimit. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të kapjes, menaxhimin e kapacitetit të flotës, rregullat për kontrollin dhe inspektimin, rregullat për tregjet dhe akuakulturën, si dhe mbështetjen për peshkimin dhe komunitetet bregdetare. Më tej, ajo promovon një akuakulturë të qëndrueshme.

Pasi që Kosova ka vetëm peshkim dhe akuakulturë në brendësi të vendit, acquis për kuotat e peshkimit dhe inspektimin dhe kontrollin është vetëm pjesërisht e zbatueshme. Kosova duhet të hartojë një ligj për peshkim dhe akuakulturë për t'u përafuar me acquis të BE-së.

Miratimi i një strategjie shumëvjeçare kushtuar akuakulturës dhe harmonizimit të legjislacionit me acquis është ende në pritje.

Kosova duhet të fokusohet në zhvillimin e një politike tregu dhe mbledhjen e të dhënave në përputhje me acquis, si dhe një inventar të llojeve të peshqve. Kosova gjithashtu duhet të rrisë ndjeshëm kapacitetin administrativ për menaxhimin e politikave dhe inspektimin dhe kontrollin.

10 Trendet e kaluara dhe zhvillimet e ardhshme në aspektin e investimeve

10.1 Analizë e investimeve në nivelet primare dhe të përpunimit të sektorit të qumështit dhe mishit

Masa 101: Investimi në asetet fizike të njësive ekonomike familjare bujqësore ishte pjesë e programeve të granteve të investimeve të MBPZHR-së për periudhën implementuese në strategjinë zhvillimore 2014-2020 dhe do të jetë pjesë e programeve të granteve të investimeve në strategjinë e cila është në fazën e implementimit 2022-2028. Investimet kumulative të planifikuara dhe aprovuar të MBPZHR-së në asetet fizike të fermave të qumështit për vitet 2020/2021 (për shkak të COVID 19, Programi i zhvillimit rural 2020 dhe 2021 është bashkuar), viti 2022 dhe 2023, shume e përgjithshme e investimeve nëpër në këtë periudhë kohore ka arritur në €9,95 milion. Do të shfrytëzohet një metodologji e tillë në kalkulimet e investimet në sektorin e qumështit, investimet primare dhe përpunimit, do të llogariten në atë formë që për vitet 2014-2019 do të konsiderohen shumat e aprovuara për investim (meqenëse janë siguruar të dhënat) kurse për vitet 2020/2021-2023 shumat e granteve të planifikuara. investimet në asetet fizike të fermave të qumështit janë në bazë të ndarjes së kostos me pjesëmarrjen e fermerëve të qumështit (bashkëfinancim), mesatarisht 35% e investimeve totale kumulative. Bashkëfinancimi të Masa 101 ka qenë nga 30-40% nga ana e fermerit, varësisht nëse fermeri ka qene më i ri se 40 vjet ose ka jetuar në zonat malore.

Tabela 10-1. Masa e 101 e investimeve në fermat e qumështit 2020/2021 – 2023

Viti	Sektori i qumështit (€)
Prodhimi i qumështit/lopë	9,000,000
PGQ	950,000
Investimi total kumulativ me 35% pjesëmarrje të fermerëve 2021-2023	9,950,000

Burimi: Programet e zhvillimit rural 2020/2021, 2022 dhe 2023, Vlerësimi i ekspertit

Bazuar në investimet për masën 103 në investime në asetet fizike dhe përpunim dhe tregtim të produkteve bujqësore të planifikuara për periudhën e përmendur shuma e investuar tek përpunuesit e qumështit është 500,000 € për tri programet e shpallura në periudhën e përmendur më lartë, atëherë del se investimi total për një vit është €1.5 milion.

⁴⁰ Kosovo* 2024 Report, faqe 85

Tabela 10-2. Masa e 103 e investimeve në asetet fizike dhe përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore të planifikuara në sektorin e qumështit për periudhën 2020/2021 – 2023

Bashkëfinancimi te Masa 103 ka qenë nga 50% nga ana e përfituesit.

Programi	Sektori i qumështit (€)
Investimi total në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore 2021-2023	1,500,000

Tabela 10-3. Masa 101 e 103 e investimeve në asetet fizike në fermat qumështore dhe përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore të planifikuara në sektorin e qumështit për periudhën 2014-2019

Në tabelën në vijim shifet totali i investimeve të miratuara është për prodhimin primar në vlerë prej €27 milion dhe për përpunim qumështi në vlerë prej €10.6 milion.

Nënmasat në sektorin e qumështit 2014 - 2019 miratuara	Totali investuar €
Prodhimi i qumështit nga lopët dhe Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	27,312,791
Përpunimi i qumështit	10,698,118
Investimi përgjithshëm 2014-2019	38,010,909

Krejt në fund nëse i bashkojmë investimet e planifikuara 2020/2021 – 2023 dhe investimet e miratuara nga nga 2014-2019 shume e investuar në këto dy nënmasa të prodhimit dhe përpunimit të qumështit do të duket kështu: se shuma totale e investimit në asetet fizike në fermat qumështore është €37.2 milion dhe shuma totale e investimit në asetet fizike të përpunuesit është €12.19 milion. Që në total investimet në sektorin e qumështit është €49.4 milion.

Tabela 10-4. Masa 101 e 103 e investimeve në asetet fizike në fermat qumështore dhe përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore të planifikuara në sektorin e qumështit për periudhën 2014-2019 dhe 2020/2021-2023

Nënmasat në sektorin e qumështit 2014 - 2019 miratuar	Totali investuar €
A1. Prodhimi i qumështit nga lopët dhe Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	27,312,791
A2. Përpunimi i qumështit	10,698,118
Nënmasat në sektorin e qumështit 2020/2021 - 2023 planifikuara	Shuma e investuar €
B1. Prodhimi i qumështit nga lopët dhe Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	9,950,000
B2. Përpunimi i qumështit	1,500,000
A1+A2. Totali investimeve në prodhimin i qumështit nga lopët dhe Investimi në pikat grumbulluese të qumështit 2014-2023	37,262,791
B1+B2. Totali investimeve në përpunimi i qumështit 2014-2023	12,198,118
Totali investimeve (A+B) 2014-2023	49,460,909

Investimet e MBPZHR-së në sektorin e mishit ishin të vogla krahasuar me sektorët e tjerë të bujqësisë. Masa 101: Investimi në asete fizike të njëjësive ekonomike familjare bujqësore është pjesë e granteve të investimeve të MBPZHR-së për Zhvillim Rural. Investimet kumulative të miratuara të MBPZHR-së në asetet fizike të fermave të majmërisë së viçave. Për rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit të mishit në Qeverinë e Kosovës duhet të rriten investimet për grante dhe të zbatohet skema e pagesave direkte për sektorin e mishit. Nëse analizohet tabela në vazhdim investimi total i planifikuar dhe miraturar për periudhën vjetore 2020/2021-2023 është €5.5 milion. Bashkëfinancimi te Masa 101 ka qenë nga 30-40% nga ana e fermerit, varësisht nëse fermeri ka qene më i ri se 40 vjet ose ka jetuar në zonat malore.

Tabela 10-5. Masa e 101 e investimeve të planifikuara në fermat e mishit të gjedhit 2020/2021 – 2023

Viti	Sektori i mishit (€)
Investimi përgjithshëm Investimi në fermat e mishit 2021-2023	5,500,000

Tabela 10-6. Masa e 103 e investimeve të planifikuara në asetet fizike të përpunuesëve të mishit 2020/2021 – 2023

Investimet në masën 103 janë planifikuara të investohen në total €1,8 milion. Bashkfinancimi ka qenë 50%.

Viti	Sektori i mishit (€)
Investimi përgjithshëm investimeve të planifikuara në asetet fizike të përpunuesëve të mishit 2021-2023	1,800,000

Tabela 10-7. Masa 101 e 103 e investimeve në asetet fizike në fermat për trashjen e viçave (për mish dhe përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore të planifikuara në sektorin e mishit për periudhën 2014-2019 dhe 2020/2021-2023

Shuma totale e investimit në bashkëfinancim për një periudhë kohore 2014-2023 është 33.6 milion per masat 101 dhe 103

Nënmasat në sektorin e mishit 2014-2019	Shuma e investuar €
A1. - Trashja (majmëria) e viçave	15,908,423
B1. Përpunimi i mishit	10,393,009
Nënmasat në sektorin e mishit 2020/2021 - 2023 planifikuara	Shuma e investuar €
A2. Trashja (majmëria) e viçave	5,500,000
B2. Përpunimi i mishit	1,800,000
A1+A2.Totali investimeve - Trashja (majmëria) e viçave	21,408,423
B1+B2.Totali investimeve - Përpunimi i mishit	12,193,009
Totali investimeve (A+B) 2014-2023	33,601,432

Përveq investimeve nga MBPZHR një investim i konsiderueshëm ka ndodhur me mbështetjen nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, nga thirrjet për aplikim për grante në për asete fizike të fermave për prodhim primar të qumështit, investimi në përpunuesit e mishit dhe qumështit. Gjithësejt janë shpallur 5 thirrje për vitet 2011-2015. Bashkëfinancimi ka qenë tek prodhimi primar, 35% nga përfituesi dhe te përpunimi i mishit ose qumështit ka qenë 50% nga ana e përfituesit. Në tabelën e mëposhtme në kolonën për shumën e investuar janë të përfshirë: Përfituesi dhe Autoriteti Kontraktues në rastin konkret zyra e Bashkimit Evropian.

Tabela 10-8. Mbështetja financiare nga zyra e Bashkimit Evropian për mbështetjen në asete fizike për fermat e lopqëve qumështore dhe përpunuesit e qumështit nën IPA I dhe IPA II

Investimet në sektorin e qumështit dhe mishit	Shuma e investuar €
Përpunimi qumështit - asete	4,013,094
Prodhimi qumështit - asete	3,179,073
A. Totali investimeve në qumësht (prodhim primar dhe përpunimi)	7,192,167
B. Totali investimeve në përpunimi mishit	2,754,288
Investimi total (A+B)	9,946,455

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Nga investimet e përgjithshme në sipas Masës 101 -investime në asete fizike në ferma për prodhimin e qumështit dhe mishit dhe përpunuesëve të qumështit dhe mishit nga MBPZHR gjatë periudhës 2014-2023 dhe BE gjatë periudhës 2011-2015 (5 thirrjeve të BE për aplikim) ku implementimi i këtyre thirrjeve të fundit nga BE ka zgjatë deri në fund të vitit 2022. Totali investimeve sipas këtyre kritereve që u përmendën në sektorin e mishit ka qene €36.3 milion, në sektorin e qumështit ka qene 56.6 kurse investimi total në të dy sektorët ka qenë 93 Milion. Kurse nëse ndahen sipas Masave për të dy tipet e fermave dhe përpunuesëve, të dhanët e investimeve janë si në vijim.Prodhimi primar është përkrahur me €61.8 milion kurse përpunimi është përkrahur €31.5 milion. Nëse prodhimit primar i shtohet bashkëfinancimi në një mesatare prej 35% shuëm totale e investimit në këtë sektor është €83.4 milion kurse te Masa 103 shumë e përgjithshme e bashkëfinancimit me 50% mbështjete është €46.7 milion. Total investimi donatorët dhe bashkëfinancimi është €130 milion.

Tabela 10-9. Përmbledhje e investimit nga MBPZHR dhe fondet IPA të BE 2014-2023

Mbështetja e sektorit të mishit dhe qumështit MBPZHR + BE (IPA)	Shuma e investuar €
Totali investimeve - Trashja (majmëria)	21,408,423
Totali investimeve - Përpunimi i mishit	12,193,009
Totali investimeve në prodhimin e qumështit nga lopët dhe Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	37,262,791
Totali investimeve në përpunimin e qumështit	12,198,118
A. Total investimit në sektorin e mishit MBPZHR	33,601,432
B. Totali investimit në sektorin e qumështit MBPZHR	49,460,909
C. Investimet e në sektorin e mishit të IPA-së	7,192,167
D. Investimet në sektorin e mishit të IPA-së	2,754,288
Gjithësejt Investime (A+B+C+D)	93,008,796

Në mbështetjen e sektorit të gjedhtarisë ka qenë i mbështetur nga të gjithë donatorët ndërkombtar dhe vendor, por mbështetja më e madhe financiare ka ndodhur nga këto dy institucione që janë përmendur në tabelën e mësipërme. Donator të shumtë që kanë mbështetur këtë sektor nëpërmes investimeve në asete fizike dhe investime të buta (trajtime dhe këshillime). Në aspektin financiar ka qenë e pamundur që të kumulohen investimet financiare nga këto institucione që u përmendën më lartë. Zakonisht ka munguar një përmbledhje e investimeve dhe është diskutuar në vazhdim që ka nevojë të mbledhen këto të dhëna, dhe kjo nuk ka ndodhur asnjherë. Mbetet në të ardhmen që të dedikohen një studim gjithpërfshirës në lidhje me investimet që kanë ndodhur në sektorin e gjedhtarisë, pas luftës. Është shumë e mireseardhur që të tentohet të kryhet një investim në sektorin e gjedhtarisë në fazën emergjente dhe në fazën zhvillimore.

Masat e sigurisë bio do të mbështeten gjithashtu me investime që synojnë mbrojtjen e shëndetit të kafshëve duke kontrolluar hyrjen në ambiente dhe duke krijuar sisteme përkatëse dezinfektimi për kamionët dhe vizitorët. Kompanit e përpunimit primar dhe sekondar do të investojnë gjithashtu në mbrojtjen e mjedisit përmes krijimit të sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza, impianteve për asgjësimin e sigurt dhe prodhimin e produkteve me origjinë shtazore nga përpunimi i mishit (sistemet e prodhimit dhe djegejes/incinerimit).

10.2 Ndikimi i PBZHR-së 2014-2020 dhe 2020/2021 – 2023 në zhvillimin e deritanishëm të sektorit

Mbështetja e MBPZHR-së për pagesat direkte për sektorin e qumështit ndahet në tri kategori në gjedhtari. Pagesa direkte për krerë lopë qumështore, pagesa direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar dhe Therje të raportuar të gjedhit. Mbështetja kumulative përmes pagesës direkte për sektorin e qumështit nga 2015 në 2023 ishte €69,3 milionë, nga të cilat €48,2 milionë ishin pagesa direkte për krerë lope qumështore dhe buallica (llogaritje e eksperit) ose 69.65% e pagesës totale direkte për prodhimin e qumështit., cilësia e qumështit €20.6 milion ose 29,8% dhe therje të raporutara të gjedhit €0.38 milion ose 0.55% të pagesave kumulative për periudhën kohore 2014-2023 Mbështetja për krerë lopqë qumështore ka ndryshuar nga 70 në €95 për krerë, për buallica nga 70 në €180 /krerë dhe për cilësin e qumështit 0.04 në €0.07 për litër për klasën ekstra kurse për klasën I mbetet €0.02 për litër aq sa mbeten edhe për klasën II.

Nëse supozojmë një kumulative të investime në grante nga MBPZHR dhe BE, dhe mbështetja me pagesa direkt nga MBPZHR, shuma kumulative është €169.1 milion.

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Tabela 10-10. Pagesat direkte 2014 – 2023⁴¹⁴²

Nësektori	Viti										Mbështetja kumulative 2015-2019
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	
Lopë qumështore	2,211,750	3,790,990	4,609,990	4,777,500	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535	4,727,430	4,651,560	48,204,285
Buallica						17,920	48,580	2,635	2,340	3,780	75,255
Cilësia e qumështit	491,884	711,644	1,082,829	1,712,609	1,736,944	2,041,145	4,906,204	2,358,351	2,840,801	2,777,848	20,660,259
Therje të raportuar të gjedhit		2,520	15,780	18,350	48,900	48,550	70,600	35,050	56,100	86,000	381,850
TOTALI	2,703,634	4,505,154	5,708,599	6,508,459	6,532,614	6,481,075	14,446,684	7,289,571	7,626,671	7,519,188	69,321,649

⁴¹https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_2019_13120.pdf, faqe 144

⁴² https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_2023.pdf, faqe 112

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Një llogaritje tjetër në lidhje me të ardhurat nga pagesat direkte merr parasysh se mesatarisht 52,000 lopë qumështore mbështeten me pagesa direkte në vit dhe nëse ky numër i fundit shumëzohet me 0,7 rezulton se sipërfaqja totale e përdorur nga fermerët për prodhimin e kafshëve. ushqimi për sipërfaqe të kultivuar për 10 vjet (2014-2023) është 358,669 ha që nëse shumëzohet me një pagesë mesatare prej 150 € për ha, është diku rreth 53.8 milion €. Investimet totale të Kosovës direkt nga Qeveria dhe pagesa (2014-2023,) BE (grante 2009 – 2020), dhe nepermes bazes ushqimore €53.8 milion, investimet totale dalin të jenë €222.9 milion. Nëse supozojmë se donatorët tjerë ndërkombtar, vendor dhe komunat kanë dhënë sipas vlerësimit të ekspertit 10% të shumës së mbështetjes së granteve del se shuma e investuar nga donatorët tjerë do të jetë €22.29 milion, atëherë investimi i përgjithshëm do të jetë €245.19 milion brenda një dekade.

Me qëllim që të analizohet efekti pagesave direkte në subsektorin e qumështit do të supozojmë një fermer prej 10 krerëve të lopëve qumështore, një fermer që zbaton praktikën e mira bujqësore. Zakonisht pronarët e fermave të lopëve qumështore përfitojnë nga 3 kategori të pagesave direkte:

- a) Pagesa direkte për krerë të lopëve qumështore
- b) Pagesa direkte për cilësinë e qumështit
- c) Pagesa direkte për sipërfaqe të tokës së kultivuar,

Nëse konsiderojmë dhe që ndodh zakonisht se pronarët e fermave qumështore kanë në pronësi tokën bujqësore që kultivojnë ushqimin për lopët e tyre qumështore, vlen të theksohet se është reale se edhe shumica e fermerëve posedojnë mekanizmin themelor për punimin bazik të tokës së tyre bujqësore. Numri mesatar i Njesisë Blegtorale (NjB) për hektar të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në Kosovë është 0.7. Po ashtu nëse e konsiderojmë se prodhimi mesatar për lopë qumështore një mesatare nëse fermeri aplikon praktikën e mira bujqësore është 5,000L qumësht për krerë. Tabela në vijim shpjegon politikat shumë të favroshme të MBZPHR, që fermeri vetëm nga pagesat direkte ka një të hyrë shtese prej €7,116. E njëjta qasje sa i përket pagesave direkte të shumëfishta vlen edhe për fermat e prodhimit të mishit të gjedhit.

Tabela 10-11. në vijim shpjegon politikat shumë të favroshme të MBZPHR në fermat e prodhimit të qumështi.

Përshkrimi	€/copë/L	LQ/L/Ha	Shuma €	
Subvencioni për krerë	95	10	950	
Subvencioni për litër qumështi ekstra klasë	0.07	50,000	3,500	
Subvencioni për ha misër 8 ha	297	6	1,782	€175 /ha - direkt; €0.36 /L derivat (60L); €100 në ha plehra
Subvencioni për ha gruri 2 ha	442	2	884	€150 /ha - direkt; €0.03 në rendiment mesatar (4,000 kg/ha), €0.36 /L derivat në 60 L; €150 në ha plehra
Jonxhë ose livadhë	0	0		
Totali			7,116	

11 Identifikimi i potencialeve dhe nevojave të sektorit

Tabela 11-1. Prodhimi i qumështit të lopës - analizat SWOT

Analiza SWOT Prodhimi i qumështit të lopës		Nevojat e identifikuar bazuar në analizën SWOT	
Pikat e forta		Nevojat për rritjen e pikave të forta të sektorit/biznesit?	
1	Traditë e gjatë në prodhimin blegtoral në përgjithësi;		Duhet të vazhdojë mbështetja e fermerëve me përvojë në këtë sektor
2	Një numër i madh fermerësh që merren me prodhimin e qumështit ka përvojë praktike		Fuqizimi i shoqatës së prodhuesve të qumështit dhe rritja e numrit të fermerëve në programin për cilësinë e qumështit
3	Shoqata e Prodhuësve të Qumështit po luan rol aktiv, p.sh. në mbledhjen e mostrave të qumështit dhe nxitjen e futjes së skemës së cilësisë së qumështit, mbajtjen e trajnimeve, konferencave		Duhet të vazhdojë në sistemin e mirëmbajtjes së identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve
4	Kushtet e favorshme të prodhimit mjedisor dhe ekologjik.		Subvencionet për cilësinë e qumështit duhet të vazhdojnë të mbështeten
5	Ekziston identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve		AUV-së i nevojitet mbajtja e sistemit funksional matrikulimit
6	Sistem i konsoliduar i mbledhjes së qumështit dhe sistemi i kontrollit të cilësisë		Rritja e kontrollit të cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe produkteve përfundimtare
Pikat e dobëta		Nevojat për zvogëlimin e pikave të dobëta të sektorit/biznesit?	
1	Shumica e prodhuesve të qumështit janë ferma me përmasa të vogla (1 deri në 9 lopë) 65%;		Fermerët me më pak se 5 lopë duhet të jenë prioritet i komunave për mbështetje me grante dhe skema të tjera sociale që qeveria mund të zhvillojë.
2	Rendimente mesatare të ulëta vjetore për lopë dhe kosto e lartë prodhimi		Identifikimi i problemeve në fermë dhe adresimi i tyre përmes trajnimit direkt në fermë në mënyrë që të rritet prodhimi i qumështit
3	Higjiena e ulët e fermave, cilësia e ulët e qumështit të papërpunuar		Vazhdimi i subvencioneve për cilësinë e qumështit dhe marrja e mostrave për cilësinë e qumështit nga të gjithë fermerët që dorëzojnë qumësht për përpunim.
4	Pikat e grumbullimit të qumështit janë ende të pakënaqura me furnizimin e qumështit duke marrë parasysh numrin e madh të furnitorëve të qumështit që vështirëson kontrollin e cilësisë së qumështit		Marrja e mostrave për të gjithë fermerët që furnizojnë qumësht (i detyrueshëm); Mbështetja e fermave depozitë ftohjeje dhe me dhomë mjeljeje.
5	Cilësia e ulët e ushqimit për foragjere		Trajnimi i fermerëve për përmirësimin e ushqimit për foragjere dhe mbështetja me mekanizmat e duhur për përgatitjen e ushqimit për kafshë.
6	Çmim me kosto të lartë për shkak të rendimenteve të ulëta vjetore për lopë dhe kosto e lartë ushqimi		Mbështetja e fermerëve me pajisje bujqësore, konkretisht teknologji të reja të ujitjes në mënyrë që të përmirësohet racioni i ushqimit.
7	Jo shumë specializim (qumështi ose mish) në prodhim.		Nxitja e fermerëve për mbajtjen e racave produktive për qumësht dhe mish

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

8	Mos zbatimi praktikave të mira bujqësore në deponimin e plehut të ngurtë dhe lëngët të lopët qumështore	Të vazhdoj në MBPZHR, që të përkrah ndërtimin e depove për plehrat e ngurta dhe lëngta, sepse këto ndikojnë direkt në mitigimin e ndryshimeve klimatike.
9	Niveli i ulët arsimor në menaxhimin e fermave (në veçanti fermerët e vegjël), gjë e cila ka çuar në praktika të këqija menaxhimi të tufave dhe në sasi e cilësi më të ulët të qumështit të papërpunuar.	Shërbime të drejtpërdrejta këshilluese për fermat. Trajnimet duhet të jenë praktike dhe në nivel ferme. Duhet të organizohen trajnime specifike në grupe të vogla fermerësh. Po ashtu, trajnimet duhet të zhvillohen sipas kërkesave të fermerëve.
10	Bazat e të dhënave për informacione të besueshme mbi mbarështimin nuk përdoren si duhet	Fermerët që marrin subvencione dhe grante duhet të raportojnë për mbajtjen e të dhënave
11	Fuqia negociuese e prodhuesve të qumështit me përpunuesit është e vogël dhe joefektive	Forcimi i shoqatave në nivel kombëtar dhe lokal
12	Disponueshmëria e ulët e asistencës teknike përmes shërbimit të zgjerimit të qeverisë	Ndryshimi i ofrimit të shërbimeve këshilluese; Sigurimi i shërbimeve këshilluese nga shoqatat e fermerëve
13	Shëndeti dhe Mirëqenia e Kafshëve - mungesa e kontratave fermer-veteriner, mungesa e standardeve mjedisore (rregullat e menaxhimit të plehrave në bazë të Direktivës për nitratet.	Trajnim tjetër për mirëqenien e kafshëve, për kushtet në stalla, kërkesat për ushqim, dritë, hapësirë brenda stallave, sipas direktivave, rregullativës së BE dhe ligjeve në fuqi në Kosovë.
Mundësitë		Nevojat për vlerësimin e mundësive
1	Modernizimi i detyruar në të ardhmen do të përmirësojë cilësinë dhe të ardhurat e qumështit	Duhet të bëhet vlerësimi i hollësishëm i planit të ndërtimit të fermës, nëse projekti i ndërtimit i plotëson kriteret për lopët. Vlerësimi duhet të bëhet nga eksperti i blegtorisë
2	Prodhimi dhe përpunimi i qumështit konsiderohen ndër prioritetet më të mëdha për politikën e zhvillimit rural.	Kontroll dhe riprogramim më i madh i subvencioneve; subvencionimi duhet të bazohet në prodhimin dhe cilësinë e qumështit
3	Mbështetja e përmirësimit të infrastrukturës në prodhimin e cilësisë së foragjereve	Vlerësimi i detajuar i planit të biznesit në aspektin ekonomik të kthimit të investimit
4	Programi i subvencioneve ekziston dhe është lehtësisht i arritshëm	Programi i pagesave direkte duhet të orientohet drejt rritjes së prodhimit dhe përmirësimit të cilësisë së qumështit, rritjes së mirëqenies së kafshëve dhe përmbushjes së standardeve të sigurisë ushqimore.
5	Skema e granteve ekziston dhe është e aksesueshme	Investimet në energjinë e rinovueshme duhet të analizohen në bazë të kapacitetit të fermës. Duhet të përcaktohet standardi i kapacitetit të fermës për instalimin e kapacitetit të energjisë së rinovueshme
6	Ndërgjegjësimi dhe tregtimi për produktet e qumështit	Duhet të promovohen më shumë produkte lokale bulmeti
7	Investimet në energjinë e rinovueshme	

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Kërcënimet		Nevojat për zbutjen e kërcënimeve?
1	Migrimi i fuqisë punëtore bujqësore; fermat e vogla do të mbyllen; më pak punësim	Krijimi i kushteve të mira në ferma dhe në zonat rurale
2	Sëmundje të ndryshme infektive	Krijimi i kushteve dhe lidhja e tregut me prodhuesit dhe përpunuesit, duke favorizuar zonat rurale
3	Fatkeqësitë natyrore nga kushtet klimatike për shkak të ndryshimeve	Kontroll i vazhdueshëm dhe vaksinimi i kafshëve
4	Ndryshimi i destinacionit të tokës bujqësore	Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e tokës bujqësore
5	Migrimi masovik i të rinjëve sidomos pas liberalizimit të vizave nga zonat rurale në vendet urbane dhe jashtë vendimit	Investimi i qeverisë në nxitjen e punësimit për të rinjtë me qëllim të zvogëlimin të këtij trendi. Ky trend zvogëlon zhvillimin ekonomik të vendit.

Tabela 11-2. Përpunimi i qumështit - analizat SWOT

Analiza SWOT - Përpunimi i qumështit		Nevojat e identifikuara bazuar në analizën SWOT	
Pikat e forta		Nevojat për forcimin e pikave të forta të sektorit/biznesit?	
1	Kompanitë e mëdha përdorin pajisje moderne për përpunimin e qumështit dhe kanë kapacitete të larta përpunuese		Rritja e cilësisë së produkteve dhe rritja e promovimit të produkteve vendase
2	Kompanitë e mëdha të qumështit kanë nivel higjenik (BE)		Zbatimi dhe mirëmbajtja e standardeve të sigurisë ushqimore
3	Trendi i tkurrjes së madhësisë së sektorit informal		Rritja e kontrollit dhe zyrtarizimit të tregut të qumështit
4	Sektor dinamik: konsolidimi po ecën relativisht mirë		Përfshirja e të gjithë fermerëve në programin për cilësinë e qumështit
5	Infrastrukturat dhe njohuritë teknike për testimin në shkallë të gjerë të cilësisë së qumështit janë në funksion dhe përdoren plotësisht		Rritja e kontrollit të cilësisë së mostrave të qumështit dhe e analizave të qumështit të papërpunuar
Pikat e dobëta		Nevojat për zvogëlimin e pikave të dobëta të sektorit/biznesit?	
1	Cilësia e ulët mesatare e qumështit të papërpunuar të marrë në fabrikën e qumështit.		Përpunuesit duhet të punojnë më ngushtë me fermerët me qëllim rritjen e cilësisë së qumështit
2	Industria përpunuese nuk është e gatshme/në gjendje të paguajë më shumë sesa çmimi aktual për qumësht me cilësi më të mirë. Nxitja për cilësinë e qumështit në periudhën afatshkurtër drejtohet nga subvencionet		Përpunuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së qumështit dhe duhet të bashkëpunojnë më shumë me fermerët në mënyrë që të rritet cilësia e qumështit
3	Kosto të larta, në veçanti për mbledhjen e qumështit		Subvencionimi i kostos së mbledhjes së qumështit
4	Përpunuesit e qumështit shpesh në pozitë të dobët negociuese kundër supermarketeve të mëdha		Forcimi i shoqatës së përpunuesve të qumështit, gjatë procesit të negociimit me supermarketet
5	Gama e kufizuar e produkteve të qumështit		Mbështetje për përpunuesit e produkteve specifike
6	Nuk ka asnjë instrument përkatës që t'u ofrohet përpunuesve nga shteti dhe që i cili të rregullojë tepricën e tregut duke mbështetur ruajtjen e produkteve të qumështit që magazinohen për periudha më afatgjata		Mbrojtja e produkteve vendase në sezona të caktuara dhe mbështetja për eksportin e produkteve të qumështit
7	Sektori informal është ende i madh dhe ka nivel të lartë konsumi në fermë dhe e nivel të lartë shitjeje të qumështit të papërpunuar në tregjet e gjelbra		Rritja e kontrollit dhe moslejimi i shitjes së qumështit të papasterizuar
8	Nuk ka qasje sistematike për diversifikimin e prodhimit dhe zhvillimit të produkteve të reja		Stimulimi i produkteve të qumështit në zhvillimin e produkteve të reja
9	Kontrolle të pamjaftueshme për produktet e importuara		Rritja e kontrollit të produkteve të importuara për cilësinë e tyre dhe deklarimi i përmbajtjes së produkteve

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

10	Nuk ka eksporte të konsiderueshme deri më sot - probleme të kufizuara me furnizimin dhe sigurisë	Fuqizimi i kompanive të orientuara drejt eksportit
11	Humbja e punonjësve të kualifikuar për shkak të migrimit	Rritja e bashkëpunimit me qendrat e formimit profesional për përgatitjen e stafit të ri
12	Niveli i ulët i punonjësve të kualifikuar	Organizimi i trajnimeve praktike për përpunimin e qumështit dhe për sigurinë e ushqimit
13	Trajtimi i ulët i ujërave të zeza	Përgatitja e studimit të fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza dhe investimi në trajtimin e ujërave të zeza
Mundësitë		Nevojat për të vlerësimin e mundësive
1	Akses më i mirë në tregun rajonal dhe treg i hapur në BE	Përmirësimi i standardeve të sigurisë ushqimore, rritja e kontrollit dhe e raportimit
2	Rritja e kërkesës së brendshme përmes zëvendësimit të importit	Rritja e cilësisë dhe promovimit të produkteve
3	Mund të zhvillohen produkte niche (qumësht deleje dhe dhive)	Formalizimi i tregut të qumështit të deleve dhe dhive
4	Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit për konsumimin e produkteve vendore të qumështit	Organizimi i fushatave sensibilizuese për konsumimin e produkteve vendore
5	Rritja e kontrollit të cilësisë për produktet e importuara	Rritja e kontroleve mbi produktet e importuara për sa i përket cilësisë, deklarimit të përmbajtjes dhe afatit të përdorimit
6	Shtimi i vlerës së produkteve të qumështit përmes përpunimit, përmirësimit të cilësisë, markës etj.;	Prioriteti në investime duhet t'i jepet projekteve që zhvillojnë produkte të reja dhe investimeve në rritjen e sigurisë ushqimore
7	Potenciali i eksportit, veçanërisht në vendet fqinje	Subvencionimi i eksportit të produkteve të bulmetit në mënyrë që të reduktohet kostoja e transportit dhe kostot e tjera
8	Rritja e kërkesës për produkte cilësore	Promovimi i produkteve lokale, rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit për produktet e bulmetit me origjinë shtazore
Kërcënimet		Nevojat për zbutjen e kërcënimeve
1	Më shumë konkurrencë e drejtpërdrejtë nga produktet e qumështit të importuara nga BE-ja	Rritja e prodhimit dhe cilësisë së produkteve vendore, ulja e kostos së prodhimit
2	Konkurrenca e brendshme dhe presioni i çmimeve	Orientimi i produkteve vendore drejt produkteve unike dhe diversifikimi i tyre
3	Përpunuesit e vegjël me fuqi të ulët konkurruese do të mbyllen	Orientimi i përpunuesve të vegjël drejt përpunimit të qumështit të deleve dhe dhive
4	Kosto më të larta për kontrollet e sigurisë ushqimore	Zbatimi i ligjit për tregtinë e brendshme dhe mbrojtjen e produkteve vendore
5	Mungojnë rregulloret e duhura të tregut; import i produkteve më të lira të qumështit nga BE-ja dhe nga vendet e tjera të treta është i lartë.	

Tabela 11-3. Prodhimi i mishit - analizat SWOT

Analiza SWOT Prodhimi i mishit		Nevojat e identifikuar bazuar në analizën SWOT	
Pikat e forta		Nevojat për forcimin e pikave të forta të sektorit/biznesit?	
1	Traditë e gjatë në blegtorinë		Mbështetja e fermerëve me përvojë në këtë sektor
2	Disponueshmëria e zonave të konsiderueshme për kullotjen dhe prodhimin e foragjereve.		Promovimi i majmërisë së viçit në përdorimin e kullotave
3	Kushtet e favorshme mjedisore dhe ekologjike të prodhimit		Nxitja e prodhimit lokal të mishit
Pikat e dobëta		Nevojat për zvogëlimin e pikave të dobëta të sektorit/biznesit?	
1	Struktura e vogël e shkallëzuar e fermës dhe shtallat e vjetra		Mbështetja e fermerëve me minimumi 5 viça me grante dhe vazhdimi i zbatimit të skemës së subvencioneve për krerë/viça
2	Prodhimi i mishit të gjedhit me racat me qëllim të dyfishtë		Futja e racave të pastra për prodhimin e mishit
3	Nuk ka shoqatë për këtë sektor		Stimulimi i organizimit të fermerëve në shoqata
4	Kostoja e lartë e inputit, në veçanti e ushqimi për shkak të sasive të pamjaftueshme të grurit të prodhuar në ferma (burime të importuara proteinash) (por edhe misri)		Mbështetja e fermerëve me teknologji të ujitjes dhe varietete rezistente nda thatësisë, për shkak të ndryshimeve klimatike.
5	Efikasiteti i përgjithshëm i ulët i prodhimit dhe çmimet e ulëta në fermë për mishin e vicit		Trajnimi i fermerëve me qëllim përmirësimin e menaxhimit të fermave dhe uljen e kostove të prodhimit
6	Copëzimi i tokës po pengon zhvillimin e bujqësisë dhe prodhimin e foragjereve		Konsolidimi i tokës është thelbësor për përmirësimin e bujqësisë
7	Thertoret në shkallë të vogël po punojnë në ambiente të vjetra dhe me higjienë të dobët		Investimi në modernizimin e thertoreve të gjedheve
8	Mungesa e besimit dhe e bashkëpunimit reciprok midis prodhuesve të mishit dhe përpunuesve/tregtarëve;		Krijimi i një zinxhiri tregu
9	Regjistrimi dhe identifikimi i kafshëve funksionon mjaft mirë për të dhënat "brenda" (d.m.th. identifikimi i kafshëve shtesë), por akoma jo mjaft mirë në regjistrimin e lëvizjeve dhe të dhënave "jashtë" (thertoreve)		AVUK duhet të sigurojë mirëmbajtjen e duhur të sistemit dhe të të bëjë regjistrimin e kafshëve të therrura

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

Mundësitë		Nevojat për vlerësimin e mundësive	
1	Zhvillimi i zinxhirëve të shpërndarjes do të nxisë konsolidimin e fermave tregtare		Lidhjet e tregut me prodhuesit e mishit dhe thertoret dhe dyqanet e mishtoreve
2	Konsolidimi i industrisë së përpunimit të mishit do të krijojë më shumë kërkesa për mish lokal		Rritja e kontrollit mbi mishin e importuar
3	Kërkesa e përgjithshme për mish viçi pritet të rritet paralelisht me rritjen e të ardhurave		Subvencione për majmërinë e viçave për krerë dhe mbështetja e fermerëve që mbajnë viça me grane investimesh
Kërcënimet		Nevojat për zbutjen e kërcënimeve...?	
1	Mish i importuar i ngrirë me cilësi të ulët		Rritja e kontrollit të cilësisë, duke filluar që nga doganat dhe deri në zinxhirin e fundit të shitjeve dhe të mishit të importuar
2	Sëmundjet infektive të kafshëve ose bruceloza paraqesin kërcënim të vazhdueshëm		Vaksinimi i kafshëve në bashkëpunim me veterinerë të licencuar
	Migrimi masovik i të rinjëve sidomos pas liberalizimit të vizave nga zonat rurale në vendet urbane dhe jashtë vendit		Investimi i qeverisë në nxitjen e punësimit për të rinjtë me qëllim të zvogëlimit të këtij trendi. Ky trend zvogëlon zhvillimin ekonomik të vendit.

Tabela 11-4. Përpunimi i mishit - analizat SWOT

SWOT analiza – Përpunimi i mishit		Nevojat e identifikuar bazuar në analizën SWOT	
Pikat e forta		Nevojat për rritjen e pikave të forta të sektorit/biznesit?	
1	Kompanitë e mëdha përdorin pajisje moderne të përpunimit të mishit dhe kanë kapacitete të larta përpunimi		Rritja e cilësisë së produkteve dhe rritja e promovimit të produkteve vendore
2	Sektori i përpunimit të mishit është zhvilluar mirë, duke rritur investimet në sektorët e përpunimit të mishit		Rritja e monitorimit dhe investimi në trajtimin e mbetjeve
Pikat e dobëta		Nevojat për zvogëlimin e pikave të dobëta të sektorit/biznesit?	
1	Therje e paregjistruar, therje të mëdha jashtë thertoreve të licencuar		Rritja e kontrollit të inspektimit
2	Mungesa e besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet prodhuesve dhe përpunuesve		Forcimi i shoqatës së përpunuesve dhe prodhuesve të mishit
3	Kosto të larta, veçanërisht për prodhimin vendas të mishit		Subvencionimi i prodhimit vendor të mishit
4	Kushtet e përgjithshme të këqija në therrje		Mbështetja e therrtove me investime grante
5	Kontrolle të pamjaftueshme për produktet e importuara		Rritja e kontrollit të produkteve të importuara në cilësinë e tyre
Mundësitë		Nevojat për vlerësimin e mundësive	
1	Qasje më e mirë në tregun rajonal dhe hapja e tregut në BE		Përmirësimi i standardeve të sigurisë ushqimore, rritja e kontrollit dhe raportimit
2	Rritja e kërkesës së brendshme përmes zëvendësimit të importit		Rritja e cilësisë dhe promovimi i produkteve
3	Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për konsumimin e produkteve vendore të mishit		Mbajtja e fushatave sensibilizuese për konsumin e produkteve vendore
4	Rritja e kontrollit të cilësisë për mishin e papërpunuar të importuar që shkon për përpunim		Rritja e kontrolleve për produktet e importuara për sa i përket cilësisë, deklarimit të përmbajtjes dhe afatit të përdorimit
Kërcënimet		Nevojat për zbutjen e kërcënimeve	
1	Konkurrencë më e drejtpërdrejtë nga produktet e mishit të importuar		Rritja e prodhimit dhe cilësisë së produkteve vendase, duke ulur koston e prodhimit
2	Konkurrenca e brendshme dhe presioni i çmimeve		Orientimi i produkteve vendore në produkte unike dhe diversifikimi i tyre
3	Kosto më të larta për kontrollet e sigurisë ushqimore		Zbatimi i ligjit për tregtinë e brendshme dhe mbrojtjen e produkteve vendore

11.5 Analizimi i nevojave të sektorit për nga pikëpamja e planifikimit të politikave

Sipas Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (PPB), lidhja midis marrjes së pagesave për mbështetjen e të ardhurave dhe prodhimit të produkteve specifike është hequr në mënyrë progresive (pagesat e ndara/“të shkëputur”). Kjo është bërë për shmangien e prodhimit të tepërt të produkteve të caktuara dhe për t'u siguruar që fermerët po i përgjigjen kërkesës së mirëfilltë të tregut. Sidoqoftë, në disa situata mund të jetë e nevojshme ndihma e synuar për një sektor ose nën-sektor të veçantë bujqësor pasi bujqësia po kalon nëpër vështirësi. Skema e Mbështetjes së Kombinuar Vullnetare të Komisionit Evropian synon të parandalojë përshkallëzimin e këtyre vështirësive, të cilat mund të shkaktojnë braktisjen e prodhimit dhe mund të ndikojnë në pjesë të tjera të zinxhirit të furnizimit ose të tregjeve të lidhura me to. Prandaj, vendet e BE-së mund të vazhdojnë të lidhin (kombinojnë) një sasi të kufizuar të pagesash për mbështetjen e të ardhurave për sektorë ose produkte të caktuara. Sidoqoftë, kjo i nënshtrohet kushteve të ndryshme dhe kufizimeve të rrepta për të zbutur rrezikun e deformimit të tregut. Kjo skemë mbështetjeje njihet si mbështetja e kombinuar vullnetare (E. Commission, 2020).

https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/food-farming-fisheries/key_policies/documents/voluntary-coupled-support-note-revised-july2020_en.pdf

Bazuar në diskutimet me akteret kryesor, MBPZHR duhet të shqyrtojë ridizajnimin e politikës për pagesat direkte duke mbajtur pagesat direkte për kokë lopë qumështore dhe të rialokojë gradualisht fondet për futjen e pagesa direkte bazuar në rendimentin e qumështit të lopëve qumështore dhe duke ngritur premit për kategoritë e qumështit sipas cilësisë. Duhet të përgatitet një plan i detajuar i zbatimit të programit dhe të rritet kapaciteti për marrjen e mostrave të qumështit dhe kapacitete e laboratorit për cilësinë e qumështit. Reforma e cilësisë së qumështit të papërpunuar subvencionon çmimin duke përfshirë skemën e subvencionimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar edhe fermerët e qumështit të cilët janë në kategorinë e tretë. Kjo vlen për sigurimin e një stimuli për fermerët e vegjël që merren me prodhimin e qumështit, të cilët janë në kategorinë e tretë, për formalizimin e kanaleve të marketingut dhe për raportimin e prodhimit dhe shitjeve përkatëse të qumështit, si dhe për rritjen e numrit të fermerëve të regjistruar të qumështit. Për t'u dhënë fermave të vogla dhe të mesme të qumështit një shans real për qëndrueshmëri ekonomike, MBPZHR-ja duhet të vazhdojë të mbështesë investimet në asetet fizike të fermave të qumështit, veçanërisht duke u përqendruar në fermat me madhesi mesatare blegtorale të orientuara nga tregu me më shumë se 10 lopë për tufë, bazuar në strategjinë e bujqësisë dhe zhvillim rural 2022-2028 që fermeri në fund të investimit të ketë 15 lopë qumështore. – mbështetja e konsolidimit të fermave.

12 Identifikimi i nevojave për trajnim në sektor

Sipas diskutimeve aktorët e ndryshëm në zingjirin e vlerës së qumështit në baza individuale, fermerët që merren me prodhimin e qumështit nuk janë të kënaqur me shërbimet këshilluese publike. Prandaj, lind nevoja e reformimit të shërbimeve aktuale këshilluese publike në mënyrë që të ofrohen kurse trajnimi të rëndësishme, veçanërisht për fermerët e qumështit në shkallë të vogël dhe të mesme.

12.1 Sektori i qumështit

a. Nevojat për trajnim për sektorin, të grupuara nga fermerë dhe përpunues

Temat kryesore të trajnimit nevojiten për fushat vijuese:

- Trajnim në higjienën e fermave të qumështit
- Programi i menaxhimit të plehut në fermën e qumështit
- Cilësia e ujit (Direktiva e nitrateve - kërkon që shtetet anëtare të BE-së të monitorojnë cilësinë e ujërave dhe të identifikojnë zonat që derdhen në ujërat e ndotura ose në rrezik ndotjeje. Këto kanë të bëjnë me ujërat që për shkak të aktiviteteve bujqësore janë eutrofike (mungesë oksigjeni) ose mund të përmbajnë një përqendrim prej më shumë se 50 mg/l nitrate. dhe Direktiva kornizë e ujit - fokusohet në sigurimin e shëndetit të mirë cilësor dhe sasior, d.m.th në uljen dhe largimin e ndotjes)
- Mbjajtja e të dhënave të menaxhimit të fermës së qumështit për:
 - Programin e ushqimit të lopës qumështore
 - Programin e riprodhimit të lopës qumështore
- Programi i thjeshtë për mbajtjen e pasqyrave financiare të fermave të qumështit për shitjen e produkteve dhe blerjen e inputeve për fermat.
- Zbatimi dhe mirëmbajtja e kushteve higjienike gjatë mjeljes dhe ruajtjes së qumështit të papërpunuar.
- Trajnimi në fabrikën e përpunimit të qumështit për diversifikimin e linjës së produkteve të qumështit
- Trajnimi për menaxhimin e trajtimit të ujërave të zeza

Është shumë e rëndësishme të theksohet se të gjithë fermerët e intervistuar dhe aktorët tjerë të zingjirit të vlerës së qumështit, kanë përmendur se trajnimet duhet të mbahen nga ekspertë të kësaj fushe, jo nga profesor universitar. Trajnimet duhet të jenë shumë praktike dhe të zgjidhin problemet e fermerëve. Gjithashtu, fermerët model në sektorin përkatës duhet të përdoren si model e duhet të ndahen praktikata e mira me fermer tjerë, ku duhet të u tregohen mënyrat e zhvillimit të fermës ose mënyrat e zgjidhjes së një problemi të caktuar në fermë.

12.2 Sektori i mishit

Nevojat për trajnim të fermerëve (prodhuesit kryesorë)

Nevojat për trajnim për fermerët e mishit të gjedhit përfshijnë fushat e mëposhtme:

- Praktikata e mira bujqësore:
 - Masat e sigurisë bio (kërkesat strukturore për fermat, procedurat standarde të funksionimit, menaxhimi i kafshëve të ngordhura)
 - Menaxhimi i plehut organik (trajtimi, ruajtja dhe përpunimi i plehut) dhe mbrojtja e mjedisit
 - Cilësia e ujit (Direktiva e nitrateve dhe Direktiva kuadër e ujit)
 - Mirëqenia e kafshëve, shëndeti i kafshëve dhe blegtorja
 - Praktikata e mira veterinarë (Përdorimi/ruajtja e ushqimeve medicinale)
 - Praktikata e mira të prodhimit, mënyrat e rritjes së efikasitetit të bujqësisë
 - Përmirësimi gjenetik
 - Menaxhimi dhe përmirësimi i kullotave

- Përgatitja e ushqimit të ekuilibruar
- Teknologjitë e reja të bujqësore
 - Ndërgjegjësimi i fermerëve për rolin dhe forcimin e shoqatave në një fushë të caktuar, organizata e prodhuesve
- Menaxhimi i fermës: kontabiliteti, financimi, planifikimi i biznesit, llogaritja e kostos
- Marketingu

Nevojat për trajnim për përpunuesit primar dhe sekondar (thertoret, dyqanet e therjes dhe përpunuesit e tjerë të mishit)

- Praktikant e mira të prodhimit
- Kriteret e kombetare dhe të BE-së sa i përket sigurisë dhe higjienës së ushqimit
- Mirëqenia e kafshëve gjatë transportit dhe therjes
- Zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në parimet e HACCP
- Teknologjitë e reja të përpunimit dhe zhvillimi i produkteve të reja
- Menaxhimi i ndërmarrjeve: kontabiliteti, financimi, planifikimi i biznesit
- Shëndeti dhe siguria në punë
- Mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i mbetjeve
- Marketingu dhe shpërndarja

Shërbimet këshilluese

Sistemi aktual në vend parashikon tashmë mbështetjen e fermerëve me anë të një rrjeti konsulentësh që përgatisin propozimet në emër të tyre. Nuk ka kritere specifike për t'u bërë këshilltar dhe për këtë arsye niveli i ekspertizës së këshilltarëve të disponueshëm në treg nuk është uniform.

13 Përafrimi me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së

Zbatimi i Agjendës së Gjellbër për Kosovën do të kërkojë transformim afatgjatë të sektorit të bujqësisë, duke minimizuar ndikimin e tij negativ mjedisor dhe klimatik dhe duke ruajtur ushqimin e përbalueshëm dhe të shëndetshëm për qytetarët e Kosovës dhe për tregjet e eksportit. Ky transformim do të ketë pashmangshmërisht pasoja në modelin socio-ekonomik të zonave rurale në Kosovë, pasi bujqësia luan rol kryesor në ekonominë dhe mjetet e jetesës rurale. Paralelisht me ndryshimet në sektorin agroushqimor, është e rëndësishme të sigurohet transformimi i qëndrueshëm i zonave rurale, duke rritur kënaqësinë për jetesë në këto zona.

Kosova, si një vend i vogël dhe me sektor të pazhvilluar bujqësie, nuk ka shumë ndikim negativ në mjedis, por megjithatë duhet të punojë në zbatimin e Agjendës së Gjellbër. Për të zbatuar Agjendën e Gjellbër, Kosova duhet të shfrytëzojë përvojat evropiane në këtë drejtim dhe duhet të përdorë fondet IPA dhe IPARD e fonde të tjera të donatorëve.

Sisteme të caktuara të prodhimit blegtoral përdorin sasi të mëdha burimesh natyrore dhe prodhojnë sasi të konsiderueshme emetimesh të gazrave serrë (GHG). Meqenëse kërkesa për mish dhe qumësht po rritet, pyetja është nëse ekzistojnë opsione lehtësimi të kostos efektive për t'i përmbushur ato brenda objektivave të negociuara në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme të emetimeve të gazeve serrë. Në fakt, emetimet e sistemeve të blegtorisë mund të reduktohen ndjeshëm nëpërmjet teknologjive, politikave dhe dhënies së stimujve të duhur për zbatimin e tyre.

Lista e mëposhtme - jo e zgjeruar e veprimeve është më e rëndësishme për Masën 1 për "Sektorin e Blegtorisë":

1. Përafrimi i sektorit agro-ushqimor dhe i atij të prodhimit primar në mënyrë progresive me standardet e BE-së për sigurinë ushqimore, shëndetin e bimëve dhe kafshëve, mirëqenien dhe mjedisin, si dhe adresimi i menaxhimit të derdhjes së ujërave të zeza, plehut organik dhe mbetjeve

- Mirëqenia e kafshëve për lopët, viçat, derrat, zogjët për mish (broilerët) dhe pulat me udhëzime dhe rregullore për prodhimin dhe përpunimin. Edhe në nivel të Bashkimit Evropian egzistojnë direktiva dhe rregullore vetëm për këto lloje të kafshëve.
- Futja e praktikave bujqësore miqësore me mjedisin përmes mbështetjes së kontraktorëve të makinerive bujqësore, teknologjisë efikase për plehrat dhe makinerive për shpërndarjen e plehut organik.
- Përdorimi i racave më produktive të kafshëve, ose i llojeve të tjera. Në këtë aspekt, fermat e Kosovës me përmirësim racor që i stimulojnë fermerët për mbajtjen e racave produktive të qumështit dhe mishit do të kenë një numër më të vogël kafshësh për të prodhuar më shumë qumësht dhe mish. Kjo do të ndikojë në përmbushjen e kërkesave për këto dy produkte thelbësore dhe në të njëjtën kohë do të kemi kontroll mbi emetimin e gazeve serrë.
- Efikasiteti i përdorimit të ujit dhe ujitjes në prodhimtarinë blegtorale, në prodhimin e ushqimor foragjer për shkak se kohëve të fundit kemi thatësira të mëdha gjatë periudhës së vegjetacionit.
- Lloji dhe sistemi në depot ruajtse së plehrave si dhe mënyra e trajtimit – depot e vjetruata janë faktore që krijojnë më tepër emetime të CH₄ me sistemet e trajtimit të plehurat të lëngt ose ngurtë, të cilat mbështesin kushtet anaerobe. Në menaxhimin e plehurat organik të ngurtë, si p.sh. sistemet e shpendëve ku brojlerat mbahen në pako plehu organik të thatë (rreth 25% lagështi) janë raportuar emetime më të ulëta të CH₄.
- Lloji dhe koha e aplikimit të plehurat organik në tokë - është vënë re se aplikimi i plehurat organik në vjeshtë mund të çojë në nivel të lartë denitrifikimi para dimrit dhe në fillim të pranverës. Ka rezultuar se plehu i lëngshëm i aplikuar në brez mund të prodhojë më shumë N₂O sesa plehu organik i aplikuar në mënyrë uniforme në sipërfaqen e tokës, pasi i pari krijon kushte më të favorshme për denitrifikimin duke përqendruar azotin dhe karbonin. Injektimi i plehurat organik direkt në tokë ose kultivimi i tokës menjëherë pas aplikimit mund të reduktojë avullimin N me rreth 90% në krahasim me përhapjen normale në sipërfaqe.

2. Intensifikimi i kontroleve zyrtare sanitare përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor dhe përmirësimi i gjurmueshmërisë e etiketimit të produkteve ushqimore për të garantuar sigurinë ushqimore, për të përmirësuar informacionin e konsumatorëve dhe për të promovuar ushqimin e qëndrueshëm

- Fuqizimi i një kuadri rregullator kombëtar dhe i përpjekjeve të vazhdueshme për përafrimin e *acquis*
- Duhet të vendoset një sistem i harmonizuar për gjurmueshmërinë dhe certifikimin elektronik.
- Informacioni i konsumatorit për promovimin e ushqimit të qëndrueshëm dhe rëndësisë së sigurisë ushqimore të standardeve të cilësisë.

3. Promovimi i bujqësisë miqësore me mjedisin dhe promovimi i bujqësisë organike, si dhe reduktimi i produkteve kimike sintetike të përdorura në prodhimin e ushqimit: pesticidet, ilaçet veterinarë dhe plehrat
 - Nxitja e përfundimit të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së për lëndët organike.
 - Promovimi i foragjereve me cilësi të lartë në sistemet e ushqimit dhe i kullotjes së ripërthypësve - përdorimi i foragjereve me cilësi të lartë, përdorimi i bishtajoreve në rotacionet e kullotjes.
 - Menaxhimi i mirë në ushqimi e kafshëve (Efiçenca e Përmirësuar e Kafshëve) - Një mënyrë shumë efektive për të reduktuar gazërat serrë nga kafshët dhe adaptimi ekonomikisht fitimprurës për prodhuesit. Në përgjithësi, kur produktiviteti i kafshës përmirësohet, emetimi i CH₄ për njësi prodhimi zvogëlohet, sepse zvogëlohet energjia e ushqimit që lidhet me mirëmbajtjen e kafshës.
4. Bashkëpunimi me institucionet shkencore, arsimore, dhe ekonomit bujqësore për të lehtësuar transferimin e inovacionit dhe përdorimin teknologjisë miqësore ndaj mjedisit dhe përdorimi e metodave inovative në bujqësi.
 - Forcimi i sistemeve këshillimore dhe i shoqatave lokale dhe nxitja e bashkëpunimit të tyre të ngushtë me komunitetin shkencor dhe arsimor, me prodhuesit dhe përpunuesit bujqësorë me synimin për të vendosur sisteme efektive për njohuritë dhe informacionet bujqësore (*acquis*).
 - Masat e trajnimit dhe shërbimeve këshillimore IPARD duhet të jenë plotësisht funksionale dhe të financuara për të ofruar programe efektive trajnimi dhe këshillim për sipërmarrësit në zonat rurale.
 - Programet e arsimit të të rriturve duhet të trajtojnë nevojat e trajnimit të aplikantëve të mundshëm të PZHRB-së.
 - Krijimi i programit të trajnimit në punë për të rinjtë në sektorin e blegtorisë, të cilët synojnë të aplikojnë për grante.
5. Përcaktimi i veprimeve për reduktimin e mbetjeve në zonat rurale (përgjatë rrugëve, në lumenjtë rural).
 - Lloji i sistemit të ruajtjes së plehut organik - sistemi i ruajtjes dihet se ndikon në sasinë e emetimeve të gazeve serrë. Humbja e karbonit përmes CO₂ ishte rreth 29% e përmbajtjes totale të karbonit për plehun e lopës qumështore dhe 20% për plehun e viçit. Emetimet e metanit, CO₂ dhe N₂O të shprehura në ekuivalentin e CO₂ ishin më të vogla për kompostet sesa për metodën tjetër të ruajtjes. Plehu ngurtë emeton më së shumti me 3.9 herë më shumë se komposti në plehut të shtallës së lopëve qumështore dhe rreth 17 herë më shumë se komposti në plehun e gjedhit. Stoku emetonte 2-3 herë më shumë gaze serrë ekuivalente të CO₂ sesa komposti i plehrave. Rezultatet tregojnë se ruajtja aerobike si kompostimi mund të zvogëlojë gazet serrë nga plehu i bagëtive. Metani ishte gazi dominues si në plehun e ngurtë ashtu edhe në rezervë, ndërsa N₂O përfaqësonte shumicën e emetimeve të kompostit dhe një pjesë të konsiderueshme të emetimit të stokut. Emetimi jo i drejtpërdrejtë nga sektori i blegtorisë është nga plehu në vendruajtje dhe në tokë. Nëse plehu dekompozohet në mënyrë anaerobike (ngarkesa ose ruajtja e lëngjeve/plehut të ngurtë), pjesa më e madhe e karbonit në pleh organik shndërrohet në gaz CH₄. Oksidi i azotit prodhohet në kushte aerobike si rezultat i nitrifikimit të NH₄ në NO₃ - ose në mënyrë anaerobike nga denitrifikimi i NO₃ - në N₂ kur lëvizja e oksigjenit është e kufizuar.

- Prodhimi i biomasës për përdorimin e energjisë me bazë plehun organik dhe materiale të tjera organike.
6. Mbështetja e investimeve në prodhimin dhe teknologjitë e energjisë së rinovueshme, si dhe reduktimi i emetimeve dhe përshtatja ndaj masave të ndryshimeve klimatike në bujqësi
- Grant për makineri me efikasitet energjetik në përgjithësi.
 - Grant për energji diellore për projekte investimi
 - Investimet në ferma dhe në përpunim kryesor.
 - Diversifikimi dhe zhvillimi i biznesit në zonat rurale.

14 Rezultatet

14.1 Sektori i qumështit

Rekomandimet kryesore për MBPZHR-në në sektorin e qumështit në Kosovë janë bërë për të përmbushur tre objektiva themelore që do të katalizojnë transformimin e sektorit të qumështit në sektor më efikas, i cili mund të konkurrojë me efikasitet për të fituar një pjesë të tregut të brendshëm shtesë dhe potencialisht hapjen e tregjeve të reja të eksportit. Këto objektiva themelore identifikohen si:

- I. Rritja e produktivitetit në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit
- II. Rritja e diversitetit në impiantet e përpunimit të qumështit
- III. Rritja e vlerës në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit

Rritja e produktivitetit në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit luan rol vendimtar në përcaktimin e qëndrueshmërisë së industrisë së qumështit në Kosovë. Produktiviteti i përmirësuar nënkupton rritje të kthimit të investimeve, rrezik më të ulët biznesi dhe rritje të stimujve të rëndësishëm për vazhdimin e investimeve në kohë dhe në paranë (të holla) industrinë e qumështit në Kosovë.

Rritja e diversitetit në fabrikat e përpunimit të qumështit përqendrohet në diversifikimin e linjave të produkteve të qumështit, si dhe diversifikimin e lidhjeve të tregut në tregun vendas dhe atë të eksportit për të siguruar një platformë solide për rritje të qëndrueshme të zinxhirit të vlerës së qumështit në Kosovë.

Rritja e vlerës në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit përqendrohet në rritjen e vlerës së sektorit të qumështit, nga rritja e vëllimit të prodhimit dhe çmimit për njësi të prodhimit. Rezultati do të jetë rritja e shitjeve në tregun vendas, rajonal ose të eksportit të BE-së. Një vlerë e tillë e rritur do të shërbejë si burim energjie për rritje të vazhdueshme. Strategjia për rritjen e produktivitetit në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit mund të arrihet përmes mbështetjes së aktiviteteve të mëposhtme nga MBPZHR-ja:

- Vazhdimi i pagesës së drejtpërdrejtë për cilësinë e qumështit përmes ruajtjes së vrullit të fituar gjatë pesë viteve të fundit dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë së qumështit të papërpunuar përmes zbatimit të dekretit të cilësisë së qumështit të papërpunuar 20/2006

MBPZHR-ja duhet të rialokojë disa fonde nga pagesat direkte në subvencione për cilësinë e qumështit të papërpunuar, duke rritur çmimin premium për çdo kategori qumështi të papërpunuar. Eksperti propozoi reformimin e pagesës direkte për cilësinë e qumështit të papërpunuar siç tregohet në tabelën e mëposhtme por edhe propozon ndryshimin e udhëzimit administrativë 20/2006, duke e përshtatur me premittë e reja të propozuara.

Tabela 14-1. Propozimi i vlerës në € për litër qumështi sipas cilësisë

Kategoria ekstra	€0.08 /litër
Kategoria 1	€0.06 /litër
Kategoria 2	€0.04 /litër
Kategoria 3	€0.02 /litër

Burim: Eksperti në bazë të rezultateve të studimit

Por edhe në momentin kur është duke u kryer ky studim dhe në bazë të Programit të Pagesave direkte për vitin 2024, mbështetja mbetet e njëjtë, për klasës extra - €0.07 /litër; kategoria 1 – €0.04 në litër dhe kategoria 2 – €0.02 /litër, kurse kategoria 3 nuk mbështetet fare. Në vitin 2023, sektori i prodhimit të qumështit të lopës subvencionohet me rreth €7.4 milionë (€4,6 milion për lopë/krerë dhe €2,7 milion për cilësinë e qumështit). Nëse krahasohet përqindja e rritjes së pagesave direkte për krerë të lopëve qumështore. në mes viteve 2014 me €2.2 milion në raport me vitin 2023 me €4.6 milion, kemi një rritje prej 109% të hyrave për fermer nga pagesat direkte. Kjo flet më shumë për faktin se kemi rritjen e numrit të krerëve për lopë qumështore brenda kopesë që plotësojnë kriteret për mbështetje nëpërmes pagesave direkte, por edhe rritjen e premisë për krerë. Nëse krahasohet përqindja e rritjes së pagesave direkte për cilësi të qumështit. në mes viteve 2014 me €0.49 milion në raport me vitin 2023 me €2.7 milion, kemi një rritje prej 451% të hyrave për fermer nga pagesat direkte. Nëse kumulohen pagesat direkte për krerë dhe pagesat për cilësi të qumështit në vitet e marr për krahasim, kemi një rritje të mbështetjes me pagesa direkte prej 171%. Kjo flet më shumë për faktin se kemi rritjen e numrit të krerëve për lopë qumështore brenda kopesë, përmirësim në cilësin e qumështit dhe sasisë së tij.

Sipas analizës së cilësisë së qumështit për vitin 2023, rreth 50% e qumështit është në kategorinë ekstra, 3% në kategorinë e parë, 15% në kategorinë e dytë dhe rreth 32% në kategorinë e tretë, Këto informacione janë marr nga SHPQK. Krahasuar me cilësin e qumështit të kategorisë extra 2018 që ishte 40%, tani kemi një rritje në kualitetit për një periudhë të shkurtër në 10%.

Bazuar në këto të dhëna marr nga SHPQK dhe në qumështin që hyn në përpunim në vitin e parë pas aplikimit të këtij propozimi, rreth €5.4 milionë duhet të planifikohen për subvencionim. Krahasuar me vitin e kaluar rreth €2 milionë më pak. Gjithashtu, me këtë skemë subvencioni, agjencia e pagesave do të ulë kostot administrative në drejtim të monitorimit të fermerëve në terren (kostot e transportit, mirëmbajtjen e automjeteve, pagat e punëtorëve etj.). Ose nëse krahasohet buxheti planifikuar për cilësi të qumështit atëherë fermerët që dorëzojnë qumësht do të përfitojnë €2.7 milion.

Në këtë skemë subvencionimi, duhet të subvencionohen vetëm fermerët që dorëzojnë qumësht për përpunim dhe të cilët deklarojnë me fatura të rregullta shitjen e qumështit, për prodhuesin e qumështit nën prapun e TVSH-së. Fatura është numri identifikues i fermerit (NIF). Gjithashtu, përpunuesi duhet të provojë që ky qumësht është mbledhur dhe të bëjë pagesën në bazë të faturës të lëshuar nga fermeri. Në këtë rast agjencia e pagesave duhet vetëm të kontrollojë faturat që deklaron fermeri. Me këtë formë subvencionimi, dihet saktësisht se sa qumësht prodhohet dhe sa qumësht i freskët po përpunohet nga përpunuesit.

Tabela 14-2. Skema e propozuar e subvencioneve për cilësinë e qumështit nga lopët qumështore

Prodhimi i qumështit në litër/vit (ASK)	309,343,478			
Qumështi që shkon për përpunimin litra/vit (SHIQK)	100,539,724			
Kategorizimi i qumështit	Cilësia e qumështit në 2023 në (%)	Qumësht/litër	UI/litër	€
Kategoria ekstra	50	50,269,862	0.08	4,021,589
Klasa 1	3	3,016,192	0.06	180,972
Klasa 2	15	15,080,959	0.04	603,238
	32	32,172,712	0.02	643,454
TOTALI në EUR				5,449,253

Burim: Eksperti në bazë të rezultateve të studimit

- Vazhdimi i mbështetjes për investimet në asetet fizike të fermave të qumështit

MBPZHR-ja duhet të vazhdojë të mbështesë investimet në përmirësimin e ambienteve dhe infrastrukturës së fermave të qumështit veçanërisht për ato ferma të mesme dhe më të madhe, të cilat janë të orientuara drejt tregut. Për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve të BE-së për mirëqenien e kafshëve, përparësi duhet t'u jepet fermave të qumështit me sistem të lirë për mbajtjen e lopëve qumështore.

- Kompensimi i fermerëve prodhuesë të qumështit për shkak katastrofave natyrore – thatësitrat ekstreme

MBPZHR-ja duhet të kompensojë prodhuesit e qumështit të cilët kanë humbje jashtëzakonisht të mëdha për shkak të temperaturave të larta (sikurse që ishin thatësitë në vitet 2023 dhe 2024). Zakonisht mënyra e kompensimit është shumë transparente sepse të gjithë fermerët që përfitojnë në pagesa direkte për lopë qumështore ose buallica (krerë ose cilësi qumështit) duhet të kompensohen me 20% të humbjeve të sasive mujore të qumështit të dorëzuar në muajin korrik – gusht si dhe nëse ata kanë aplikuar për sipërfaqen e tyre të mbjellë me misër, kompensohen për 50% të rendimentit të misrit sipas rendimentit mesatar 4 ton në ha. Në të kundërtën fermerët prodhues qumështi nga lopët qumështore nuk do të jenë konkurent me fermerët në rajon dhe më gjerë. Ky propozim duhet të detajzohet edhe më shumë nga stafi ministrisë që merret me politikat bujqësore – pagesat direkte.

- Mbështetja e fermave të qumështit me zbatim dhe certifikim të standardeve dhe praktikave të mira bujqësore/higjienike.

Krijimi i sistemit të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin e furnizimit të qumështit është i nevojshëm për eksportimin e produkteve të qumështit në tregjet e eksportit, rajonale dhe të BE-së. Për hapjen e aksesit të produkteve të qumështit vendas në tregjet e eksportit kur fermerët e qumështit aplikojnë për pagesa direkte për qumështin e prodhuar (mbështetje vullnetare e kombinuar) dhe kur fermerët e qumështit aplikojnë për të marrë mbështetje për investime në asetet fizike të fermave të qumështit, rezultatet më të larta në aplikim duhet t'i jepet fermerit të qumështit që zbaton dhe është i certifikuar me standardet. Praktikave të mira bujqësore/higjienike, përfshirë garantimin e mirëqenies optimale të kafshëve rrisin rezistencën e kafshëve ndaj infeksioneve dhe zvogëlojnë përhapjen e rreziqeve të sigurisë ushqimore në fermë.

- Dixhitalizimi ndërmjet përfituesve të granteve dhe ARD,

Kryesisht përfshin kërkesat për ndryshime të aktiviteteve në kuadër të projektit, zgjatjen e afatit të zbatimit të projektit, ankesa të ndryshme etj. dhe që këto të mundësohen përmes komunikimit elektronik - email. Përvoja e kaluar është se për formalitete të tilla fermerët përfitues humbasin 6-8 ditë pune, kur dihet se ky komunikim është plotësisht i zbatueshëm edhe në projektet e zbatuara nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë. Kini parasysh që komunikimi me email dhe miratimi i kërkesës ka fuqi ligjore. Përfituesi duhet të këshillohet të printojë emailin dhe ta vendosë në dosje në momentin e aplikimit për rimbursim.

- Reformimi i shërbimive keshillimore publike

Shërbimi Këshillimor i Kosovës angazhon ekspertë vendas dhe të jashtëm në fusha të ndryshme, por nuk ka treguar rezultate në këtë fushë sa i përket transmetimit të njohurive mbi praktikën e mira bujqësore dhe mbi kërkesat e tregut. Shërbimi këshillimor publik në Kosovë nuk është i përditësuar me informacionin e praktikës së prodhimit. Nëse industria e qumështit vendas do të modernizohet me sukses, fermerët e qumështit duhet të marrin informacion aktual dhe të synuar për prodhimin dhe menaxhimin e fermës. Shërbimi aktual i ofruar nga qendrat informative komunale për shërbime këshillimore publike është josistematik dhe shumë shpesh nuk arrin të reflektojë prodhimin aktual dhe trendet e tregut. MBPZHR-ja duhet t'i reformojë shërbimet këshilluese përmes angazhimit të shoqatave kombëtare të prodhuesve të qumështit dhe të studentëve praktikantë nga Fakulteti i Bujqësisë për të shërbyer si personel në terren për fermat e qumështit.

Strategjia për rritjen e diversitetit në fabrikat e përpunimit të qumështit mund të arrihet përmes mbështetjes së aktiviteteve të mëposhtme nga MBPZHR:

- Mbështetja e fabrikave lokale të përpunimit të qumështit në diversifikimin e linjave të produkteve të qumështit

Sfida më e madhe për fabrikat e përpunimit të qumështit të Kosovës në këtë pikë është përmirësimi i cilësisë së produkteve të qumështit dhe i gamës së produkteve. Rritja e kohëzgjatjes së ruajtjes së produktit dhe raportet e konvertimit të qumështit do të çojnë në rritjen e konkurrencës dhe rritjen e kategorive të produkteve për përpunuesit e qumështit në Kosovë. Fabrikat lokale të përpunimit të qumështit po humbin mundësitë e rritjes së fitimit përmes diversifikimit të produktit. Ka shumë pengesa për diversifikimin e produktit. Sigurisht që ekzistojnë kërkesa për investime kapitale për shumë alternativa të vlerës së shtuar, por disa nga pengesat më të mëdha mund të jenë mungesa e njohurive mbi mënyrat e prodhimit dhe të marketingut të produkteve të qumështit me vlerë të shtuar. Për mbështetjen e diversifikimit të linjave të produkteve të qumështit kur fabrikat e përpunimit të qumështit aplikojnë për të marrë mbështetje nga MBPZHR-ja për investime në asetet fizike të impianteve të përpunimit të qumështit, rezultatet më të larta në aplikim duhet t'u jepen impianteve të përpunimit të qumështit që kërkojnë mbështetje për investime në teknologji të reja për diversifikimin e linjave të produkteve të qumështit.

- Mbështetja e impianteve lokale të përpunimit të qumështit në trajtimin e ujërave të zeza për energji të rinovueshme

Trajtimi i ujërave të zeza është një problem i madh mjedisor me të cilin përballen fabrikat e përpunimit të qumështit në Kosovë. Prandaj, MBPZHR-ja duhet t'u japë përparësi investimeve në asetet fizike të impianteve të përpunimit të qumështit në fushën e trajtimit të ujërave të zeza dhe investimeve në panelet diellore të fokusuar tek energjia e rinovueshme.

- Mbështetja e impianteve të përpunimit të qumështit me zbatimin dhe certifikimin e standardeve HACCP

Mungesa e certifikimit nga HACCP për impiantet e përpunimit të qumështit është pengesë e qartë për cilësinë e produkteve që vijnë nga Kosova dhe për aftësinë e kompanive të Kosovës për të hyrë në tregjet e huaja.

Strategjia për rritjen e vlerës në të gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit mund të arrihet përmes mbështetjes së aktiviteteve vijuese së bashku nga MBPZHR dhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

- Mbështetja e përpunimit të qumështit për eksport

Forcimi i qumështoreve për marrjen e lejeve të eksporti dhe për rritjen e tij, pasi që deri më tani asnjë përpunues qumështi nuk ka licencë eksporti në BE. AUV-i duhet të punojë në këtë drejtim dhe të përmbushë të gjitha standardet e kërkuara për eksportimin e produkteve me origjinë shtazore.

- Miratimi i rregullores për Identifikimin/specifikimet e Qumështit dhe Produkteve të Qumështit

Një problem i vërtetë ekziston në importimin e qumështit dhe të produkteve të qumështit sepse nuk ka kufizime bazuar në datën e skadimit. Prandaj, disa produkte të importuara qumështi po vijnë në Kosovë në datën e skadencës ose shumë afër asaj date, duke lejuar që ato të shiten me çmime nën koston e prodhimit për produkte të ngjashme të prodhuara në Kosovë. Çmimet e reduktuara nuk e lejojnë as Agjencinë Doganore të Kosovës të mbledhë taksat e duhura të importit, pasi taksat bazohen në çmime fature, të cilat janë rrjedhimisht çmime më të ulta, pasi tregtarët i blejnë këtë produkte të pasigurta me kosto më të ulët. Legjislacioni për specifikimet e produkteve të qumështit duhet të përcaktojë parametrat që një produkt qumështi duhet të përmbushë në mënyrë që të referohet ligjërisht si gjalpë qumështi, kos, djathë etj. Specifikimet e produkteve të qumështit duhet të përfshihen në Ligjin e Ushqimit të Kosovës. Sipas diskutimeve në aktorë të ndryshëm në zingjirin e vlerës në sektorin e qumështit, një nga elementët kryesorë të rekomandimeve të specifikimit të produktit të qumështit ishte që produktet e qumështit të mos lejohen të hyjnë në Kosovë nëse kanë arritur brenda 50% të datës së tyre skadimit. Kjo do të eliminojë me efikasitet dërgesat e "pasigurta", të cilat normalisht shiten në momentin kur nuk kanë asnjë marzh fitimi ose me humbje thjesht për të "pastruar inventarin".

- Vazhdimi i mbështetjes për Pikat Grumbulluese të Qumështit (PGQ)

Investimet në grante të bëra për PGQ-të kanë treguar rezultate domethënëse kur kanë kontribuar në lidhjet e tregut mes prodhuesit dhe përpunuesit të qumështit. PGQ-të duhet të vazhdojnë të mbështeten me grante për ndërtimin e kapaciteteve dhe për përmirësimin e cilësisë së qumështit. Fokusi kryesor duhet t'i kushtohet mbështetjes së PGQ-ve të zotëruara nga fermerë në mënyrë që të përmirësohet cilësia e qumështit. Po ashtu një numër i konsiderueshëm i PGQ nuk shfrytëzojnë kapacitetet e tyre, 56%.

Konkurrenca e fermave të qumështit të lopës

Llogaritja e fitimit të fermës varet nga menaxhimi i fermës duke matur njësinë për prodhimin e qumështit. Bazuar në llogaritjet e marzhit bruto, është llogaritur fitimi i fermave të lopëve qumështore. Në prodhimin e qumështit të lopës, prodhimi i qumështit vlerësohet në 6,000 litra/laktacion tek ato ferma që plotësojnë të gjithë faktorët për një fermë të sukseshme dhe aplikojnë praktikat e mira bujqësore.

Për këtë arsye, rekomandohet që subvencionimi për lopët të fillon të reduktohet për krerë, por të subvencionohet prodhimi i qumështit në bazë të cilësisë së qumështit dhe fermerët të stimulohen për rritjen e prodhimit të qumështit të lopës, por këtu kemi të bëjmë me fermer që dorëzojnë qumështin e papërpunaur ne PGQ.

Rekomandime për kriteret e pranueshmërisë - MASA 1: Prodhimi i qumështit të lopës

Rekomandohet të ruhet mbështetja për sektorin e prodhimit të qumështit me të njëjtat kriteret pranueshmërie të specifikuar në masat 1 për periudhën 2022-2028, sistemit të lirë të fermave të qumështit, toka e punueshme 0.50 ha mos të jetë kriter për mekanizim, sepse e detyron fermerin në kontrata fiktive.

Toka e punueshme 0.50 ha/për lopë qumështore është kriter për fermerët që aplikojnë për mekanizëm bujqësor i cili është duke krijuar probleme për fermerët për përmbushjen e tij dhe e ka detyruar aplikantin të bëjë kontrata fiktive vetëm për të përfituar. Kjo i ka dëmtuar më tej fermerët seriozë që marrin tokë me qira, por të cilët nuk janë në gjendje të lidhin kontrata me pronarin e tokës për shumë arsye. Pas këtij studimi në bazë të intervistave të ekspertit që ka pasur me përfitues të skemës së granteve nga Masa 1, fermer jo përfitues rekomandohet që fermerët aplikant mos të kushtëzohen as në rastin kur aplikojnë për mekanizëm bujqësor që të marrin tokë me qera.

Përvoja e fermerit duhet të mbeten 2 vjet në mënyrë që të parandalohet aplikimi i fermerëve jo seriozë që nuk kanë përvojë në këtë sektor por mos të lejohet më një deklaratë për ndjekjen e trajnimeve, që është deklaratë fiktive si dhe me qëllim deklarimin e mbajtjes së të dhënave në fermë. Përvoja duhet të vërtetohet nga numri NIF në certifikatën e fermerit ose nga certifikata e regjistrimit të biznesit nëse vepron në sektorin e bujqësisë. Numri NIF duhet të rregullohet dhe pronësia të transferohet nga një pronar te pronari tjetër i fermës në të njëjtën pronë, duke e njohur përvojën e mëparshme të fermës. Duhet të tentohet të përcaktohet një standard, ku në bazë të madhësisë së fermës, të bëhet investimi dhe të përcaktohet shuma e grantit, edhe pse është vështirë e menaxhueshme. Në bazë të përvojës dhe dështimeve të pësuar në fermë, fermerët kanë aplikuar për shumën maksimale të grantit duke mos u përputhur investimet me kapacitetin prodhues të fermës. Në këto raste, fermerët kishin probleme me operimin e fermës me kapacitetin e ndërtuar pas investimit.

Periudha e implementimit të projektit që në planin investiv kanë ndërtim shtalle, depo ushqimi, depo plehu dhe sillose metalike të jetë 150 ditë.

Rekomandohet dhënja prioritet mbështetja e fermave vetëm me sistem të lirë mbajtjeje për lopët (shtalla e hapur). Ky sistem ka treguar rezultate më të mira dhe menaxhohet më lehtë, si dhe mirëqenia e kafshëve është më e mirë. Nga përvoja gjatë vizitave në terren, fermat e lopëve me sistem të lirë, në shumicën e rasteve nuk i plotësojnë kërkesat për lopët, kanë nivelin të ulët të higjienës dhe vendet e pushimit të lopëve nuk janë të ndërtuara sipas standardeve. Rekomandohet që plani konceptual i ndërtimit të fermës të kontrollohet nga eksperti i blegtorisë/veterinarisë për të parë nëse ferma plotëson kërkesat për lopët qumështore. Kjo është e një rëndësie të madhe, pasi inxhinierët e ndërtimit nuk kanë shumë njohuri në lidhje me nevojat e lopëve sa i përket ndriçimit, ventilimit dhe vendit ku ato qëndrojnë dhe ushqehen. Nga diskutimet me fermerët rreth arsyeve se pse ata i bënë këto gabime gjatë ndërtimit, thuhet se inxhinieri në planin e ndërtimit e ka parashikuar atë me këto dimensione.

Vlera e investimit duhet të ketë një standard. Fermat me kapacitet të vogël prodhimi prej 15 - 25 lopësh nuk duhet të lejohen të aplikojnë më shumë se €80,000, ndërsa fermat me mbi 25 lopë mund të aplikojnë deri në shumën prej €120,000 nëse fermerët e kanë kaluar pragun e TVSH. Ky rekomandim është nga përvoja në terren ku fermat e vogla që kanë aplikuar për shumën maksimale kanë pasur probleme në mbylljen e investimeve.

Në shumicën e rasteve, ata nuk kanë qenë në gjendje të marrin hua nga bankat tregtare dhe janë detyruar të marrin hua me interes më të lartë nga mikrofinancat dhe kanë pasur probleme në shlyerjen e kredisë.

Shumë mirëkuptim është shprehur nga aplikuesit dhe nga aplikuesit potencialë në lidhje me para-dhënjen/avancin e kërkuar që duhet të plotësojnë para se të rimburohen (pagesa përfundimtare). Vetëm se deri në thirrjen e fundit është kërkuar garancioni bankar që shumë përfitues kanë menduar se ky dokument duhet të nxjerret vetëm nga bankat, pra rekomandohet që të potencohet se ky dokument është i vlefshëm nëse nxjerret nga bankat dhe kompanitë e sigurimit.

Tabela 14-3. Plani i veprimit për mbështetjen e sektorit të lopëve qumështore

Fusha	Veprimet e parashikuara
Ferma	<ul style="list-style-type: none"> • Pagesë direkte për krerë të lopëve qumështore të vazhdohet • Pagesa për cilësi të qumështit, cmimi të rritet për €0.08 për litër Extra klasa, Klasa I €0.04, klasa II €0.04 dhe të fillon mbështetja financiare për kategorin e klasës së 3 të qumështit në vlerë prej €0.02. • Mbështetja e përmirësimit të fermave sa u përket pajisjeve dhe rinovimit/ndërtimit të ambienteve • Prioritet të ju jepet ndërtimi të fermave të lopëve qumështore të mbajtjes në stil të lirë të tyre • Ulja e kostove të bujqësisë duke modernizuar pajisjet (mekanizimi), veqanërisht teknologji inovative në ujitje, me qëllim që fermeri më këtë investim të mitigon efektin negativ të ndryshimeve klimatike gjatë prodhimit të ushqimit voluminoz dhe drithërave për fermën e saj. • Rritja e sigurisë bio përmes ofrimit të pajisjeve të reja dhe trajnimeve të ndërgjegjësimit • Mbështetja e zbatimit të dispozitave për mirëqenien e kafshëve bazuar në direktivën e përgjithshme të BE dhe rregulloret për transport dhe therrje të lopëve qumështore që janë të amorizuara. • Organizimi i trajnimeve profesionale me mbështetjen e shoqatave të prodhuesve, universiteteve/instituteve kërkimore dhe të Aquis
Burimet gjenetike	<ul style="list-style-type: none"> • Nxitja e përdorimit të racave të dedikuara për prodhimin e qumështit si raca e pastër, kryesisht nga vendet e BE-së, sepse do të ndikojnë pozitivisht në zvogëlimin e gazrave serrë. • Zëvendësimi i racave të kombinuara për mish – qumësht të cilët janë tani në fermat e Kosovës me raca tipike të lopëve qumështore
Materiale ushqyese	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e prodhimit vendas të materialeve ushqyese, të tilla si misri kokërr dhe misrit për sillazh me qëllim të uljes së kostos së prodhimit në ferm. Rritja e prodhimit të foragjereve, duke stimuluar investimin në teknologji inovative të ujitjes (sistemi ujitjes pikë-pikë, promovimi tij). Për shkak të ndryshimeve klimatike, thatësirave të ashpra gjatë verës, rendimenti i misrit për sillazhë dhe misrit kokërr është larg nën mesatare.

Përpunimi primar dhe sekondar	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e PGQ - it dhe përpunuesëve në drejtim të rinovimit/ndërtimit të ambienteve për përmbushjen e standardeve të BE-së Mbështetja e zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe përpunimin e nënprodukteve Organizimi i trajnimeve profesionale me mbështetjen e shoqatave të përpunuesëve
Impiantet e menaxhimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza
Marketingu	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e krijimit të organizatave prodhuese/marketingut Koordinimi i procesit të mbledhjes së prodhuesve të vegjël në shoqatat lokale/rajonale në mënyrë që të rritet vizibiliteti dhe kapaciteti i tyre për mbështetjen e anëtarëve të tyre Mbështetja e fushatës së ndërgjegjësimit për informacionin e konsumatorëve në lidhje me cilësitë pozitive të mishit lokal
Legjislacioni	<ul style="list-style-type: none"> Vazhdimi i procesit të përafrimit të legjislacionit dhe standardeve me BE-në dhe zbatimin e legjislacionit në terren duke pasur si prioritet sa më poshtë: rregullimi i mirëqenies së kafshëve, si dhe praktikatat e mira bujqësore në menaxhimin e plehut të shtazëve.

14.2 Sektori i mishit

Prodhimi i mishit të viçit ka filluar të subvencionohet drejtpërdrejt duke filluar nga Programi pagesave direkte të vitit 2022, si dhe vazhdon të subvencionohet therja e viçave në thertoret e licencuara. Në bazë të informacionit të marrë nga fermerët, kjo skemë subvencionimi nuk i ka ndihmuar fermerët e mishit, por kanë përfituar vetëm thertoret. Në shumicën e rasteve, thertoret nuk u paguanin fermerëve pjesën e subvencioneve (Skema e subvencioneve €50 mish viçi të therur, prej tyre €30 shkojnë për fermerët dhe €20 shkojnë për thertoret). Por pas bisedës me pronarët dhe menaxherët e thertoreve, shpesh herë fermerët që prejnë në thertoret nuk e sjellin pasaportën. Po ashtu shpeshherë thertoret ju kryejnë më shumë shërbime fermerëve që therrin kafshët e tyre, sa që dakordohen në lidhje me subvencionimin. Kështu që si përfundim ka mirëkuptim në mes këtyre dy aktorëve.

Bazuar në të dhënat në vitin 2023, €86,000 u ndanë për kafshët e therrura, dhe se numri i kafshëve të therrura të mbuluar nga kjo shumë është 1,720 gjedhe, dhe 11 përfitues kanë përfituar

Mbështetja me ndihmën e sektorit të përpunimit të mishit duhet të rishikohet me kujdes, meqenëse në bazë të diskutimeve të gjithë përpunuesit e mishit në Kosovë përpunojnë mishin e importuar nga vendet e ndryshëm të botës konkretisht Brazili dhe Argjentina. Nëse përpunuesit e mishit shfrytëzojnë mishin e gjedhit nga prodhuesit vendor që cmimi tij në peshtë të gjallë ka arritur afër €3.9 për kg, kështu që cmimi bazuar në randmanin e mishit të gjedhit arrin në €10 për kg. Koeficienti i vetëmjaftueshmërisë në mishit e freskët të gjedhit plotëson vetëm 40% të nevojave për konsum në vend. Pra rekomandohet një studim dhe vazhdimi i mbështetjes së përpunuesëve në investime në asete fizike, në implementimin e standardeve ushqimore – higjienike.

Megjithëse kjo skemë subvencionimi nuk ka treguar rezultate në rritjen e prodhimit dhe rritjen e numrit të kafshëve në sektorin e qumështit, ndërsa sektori i prodhimit të mishit duhet të subvencionohet pasi kostoja e prodhimit është e lartë (€3.9 kg/peshë e gjallë). Subvencionimi i viçave të bëhet nga mosha 4 muajshe deri në moshën 14 muajshe. Kjo duhet të verifikohet nga numri i identifikimit të viçit dhe lista veterinare për numrin e kafshëve.

- Ambientet ku mbahen kafshët janë në përgjithësi të vjetra, veçanërisht në ferma tradicionale, dhe nuk garantojnë kushtet e duhura të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Gjithashtu, pajisjet e përdorura janë të vjetra dhe në gjendje të keqe mirëmbajtjeje.
- Viçat për majmëri vijnë kryesisht nga lopët qumështore dhe nga që përdoren për qëllime të dyfishtë, duke ulur kështu performancën e përgjithëshme të kafshës. Futja e një race të specializuar për majmëri duhet të mbështetet veçanërisht në kullotat (krijimi i rezervave të lopëve për sigurimin e viçave). Për këtë qëllim, sugjerohet raca si Limuzina ose Charolais. Për të parë rezultatet e adaptimit të racës tipike për mish tani ka një numër konsiderueshëm fermerësh që kanë furnizuar fermat e tyre me racat e përmendur më lart dhe duhet të ketë një projekt pilot për testimin e këtyre racave, promovimin e këtyre racave në nivel vendi.
- Në mënyrë që të stimulohen fermerët për mbajtjen e viçave për majmëri, duhet të vazhdohet të mbështetet subvencionimi i fermerëve me subvencione direkte për krerë viçi, dhe se shumë të jetë siq është përmendur më lartë. Kjo do ta ndihmojë këtë sektor në funksionimin e fermave ekzistuese. Kostoja e prodhimit të mishit në Kosovë është shumë e lartë dhe pa mbështetje të konsoliduar drejtpërdrejtë fermerët nuk mund të konkurrojnë më në treg. Mbështetja me €50 nga MBPZHR-ja për raportimin e bagëtive të therura nuk dha rezultatet e pritshme në raportimin e numrit real të bagëtive të therura. Por duhet marr parasysh se vetëmajfueshmëria për mish gjedhi është shumë e ulët dhe se viçat e raportuara si të therrur duhet të jenë të matrikular.
- Fermat e majmërisë së gjedheve duhet të modernizohen me qëllim krijimin e konkurrencës dhe qëndrueshmërisë dhe cilësia e produkteve të mishit duhet të përmirësohet. Këto të dyja së bashku mund të sjellin mundësitë e punësimit.
- Konsolidimi i tokës është thelbësor për përmirësimin e bujqësisë. Rekomandohet ecuria drejt këtij procesi duke inkurajuar rritjen e fermave në mënyrë që të zvogëlohen kostot e prodhimit dhe të rritet produktiviteti i fermave.
- Njohja e praktikave bujqësore dhe e administrimit të gjedheve nga fermerët janë zakonisht shumë të kufizuara. Disa ferma të gjedheve për mish janë vizituar nga eksperti ishin në gjendje të keqe. Ushqimi ishte i shpërndarë gjithandej në tokë, gjë që çon në rritjen e insekteve dhe brejtësve. Si rezultat, kafshët menaxhohen dobët dhe kostot e prodhimit rritet. Rekomandohet organizimi i trajnimit profesional të përshtatshëm për mbështetjen e shoqatave të fermerëve dhe agjencive të zgjerimit.
- Prania/aktiviteti i shoqatës së fermerëve është shumë i kufizuar. Rekomandohet të mbështetet krijimi i një shoqate të tillë përgjegjëse për mbështetjen e fermerëve në sektorin e majmërisë së gjedheve.

Përpunimi primar (thertoret) dhe sekondar (impiantet e prerjes, impiantet e përpunimit të mishit)

- Qendrat e përpunuesve të mishit aktualisht janë duke punuar me mish të ngrirë të importuar. Ata nuk shohin interes në përpunimin e mishit të freskët lokal për shkak të çmimit më të lirë të mishit të ngrirë. Edhe pse ky sektor është mbështetur me grante investimesh, nuk ka pasur rezultate në integrimin e fermerëve në sektorin e mishit.
-

Mbështetja me grante e sektorit të përpunimit të mishit duhet të vazhdohet, por së pari duhet ti paraprijë një studim me përpunuesit e mishit në vendet e Ballkanit Përendimor dhe në disa vende të BE që gjenden në Ballkan. Duhet të ketë një qasje e njëjtë me qasjen e përpunuesëve në mes përpunuesëve në rajon në lidhje se nëse edhe vendet rajonale shfrytëzojnë për përpunim mishin e importuar, atëherë mos të merrët ndonjë vendim që do të ulë njëanshëm konkurrencën e sektorit të përpunimit.

- Cilësia e mishit të importuar që shkon në sektorin e përpunimit duhet të kontrollohet për afatin e ruajtjes, mënyrën e përdorimit dhe magazinimit.
- Nga informacioni i marrë nga fermerët, fermerët nuk janë përpjekur që ta marrin këtë mbështetje, por kanë përfutur vetëm therrtorët dhe fermerëve nuk u është bërë pagesa e parashikuar, ose në bisedë me pronar të therrtores egzisojnë praktika të mira të kompensimit, që don të thotë se fermeri nuk paguan në momentin e prerjes shumë e nevojshme prej €30 për krerë, ose merr shërbime tjera nga pronari therrtores. Shpesh fermeri nuk sjell pasaportën ose matrikulën. Kështu që kjo formë e implementimit duhet rishikuar me kujdes, marr parasysh se me këtë mbështetje financiare tentohet të formalizohet ky sektor.
- Ambientet dhe pajisjet ku kryhet përpunimi primar (therrja) shpesh janë të vjetruara dhe në kushte të këqija mirëmbajtjeje. Rekomandohet të mbështeten investimet për rinovimin e ambienteve dhe pajisjeve (përmirësimi i ndërmarrjeve).

Marketingu

- Zinxhiri i marketingut të mishit është i fragmentuar, sidomos sa i përket mishit të prodhuar nga fermat e vogla që përfaqësojnë pjesën më të madhe të prodhimit. Fermerët zakonisht punojnë në mënyrë të pavarur dhe e nxjerrin vetë produktin në treg. Kjo situatë përfaqëson një barrë për fermerë të caktuar dhe rrit koston totale të prodhimit. Është e nevojshme që fermerët të punojnë së bashku duke krijuar grupe prodhuesish në nivel lokal përgjegjës për marketingut të produkteve të mishit dhe rritjen e vizibilitetit. Rekomandohet krijimi i "produktit të markës" për të siguruar një vlerë të shtuar të prodhimit. Për më tepër, mbështetja për prodhimin tipik vendor është shumë e rëndësishme sepse këto zakonisht janë produkte të mira dhe janë të lidhura me zona të veçanta dhe komunitete lokale. Prandaj, duhet të vihet në dispozicion mbështetja e duhur financiare.
- Mishi i freskët lokal shitet nëpër dyqane të vogla thertorësh/mishtore në të gjithë Kosovën. Duhet të konsiderohet mundësia e krijimit të një lidhjeje më të fortë fermer – thertore/mishtore dhe e mbështetjes së këtij zinxhiri tregut.
- Eksporti në BE nuk lejohet. Një nga arsyt kryesore është statusi aktual i shëndetit të kafshëve me referencë të veçantë për disa sëmundje infektive. Duhet të zbatohen masat e duhura për ta kapërcyer këtë problem (rajonalizimi prodhimtarisë, ku disa rajone brenda vendit lejohet eksporti për produkte të caktuara blegtorale).

Prioritetet e harmonizimit të identifikuar nga ky studim janë si më poshtë:

- Mbledhja e të dhënave të besueshme në lidhje me dimensionin dhe vendndodhjen e fermave të mishit të gjedhit, përpunimin primar dhe sekondar dhe përputhshmërinë e tyre me standardet e BE-së;
- Përgatitja e një strategjie të detajuar dhe e një plani veprimi për përditësimin me standardet e BE-së për institucionet e përpunimit të ushqimit bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale;
- Harmonizimi i planit të kontrollit të sëmundjeve me dispozitat e BE-së me referencë të veçantë rajonalizimin për kontrollin e sëmundjeve infektive të gjedheve dhe ripërthypësve të vegjël;

- Kontrolli i cilësisë së mishit të ngrirë të importuar dhe një studim në lidhje me qasjen e shfrytëzimit të mishit të importuar nga përpunuesit në rajon dhe me gjerë;
- Mbështetja e fermerëve me pagesa direkte më të konsoliduara sa i përketë cmimit në mënyrë që të jenë më të plotësuar në treg;
- Harmonizimi dhe zbatimi i plotë i legjislacionit për mirëqenien e kafshëve gjatë rritjes, transportit dhe therjes;
- Ulja e kostos së lartë të prodhimit përmes përmirësimit të fermave (ambienteve dhe pajisjeve), rritja e dimensionit të fermave të vogla dhe rritja e konsolidimit të tokës;
- Rritja e prodhimit vendas të misrit dhe silazhit të misrit që kërkohet për të mbështetur rritjen e kërkesës për materiale ushqimore me teknologji të ujitjes dhe varietete rezistente
- Përmirësimi i menaxhimit të kullotave.

Konkurrenca e fermave të viçave

Bazuar në këto llogaritje në Anex 2, feramat fitimprurëse të viçave janë feramat 10 viça e më shumë viça për majmëri. Për shkak të numrit të vogël të fermave të specializuara të viçit dhe importimit të madh të mishit të viçit, ekspertët rekomandojnë që të mos ketë kufizime të numrit maksimal të viçave që ata zotërojnë.

Rekomandimet për kriteret e pranueshmërisë - MASA 1: Prodhimi i mishit

Rekomandohet të ruhet mbështetja për sektorin e mishit të gjedhit me të njëjtat kriteret pranueshmërie të specifikuara në masat 1 për periudhën e Strategjisë 2022-2028, duke hjekur kriterin tokës së punueshme në rast aplikimi për mekanizëm dhe përvojës së fermerëve. Në momentin e aplikimit fermeri mund të mos ketë viça për majmëri, por në momentin e aplikimit për riimbursim duhet të kenë 20 viça me matrikuj të Republikës së Kosovës, të regjistruar në Regjistrin e Identifikimit të Kafshëve ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë⁴³.

Toka e punueshme (0.2 ha/viç) është një kriter që në rast se fermerët aplikojnë për mekanizëm duhet ta kenë këtë sipërfaqe në pronësi, me qëllim që mos të krijojnë hapësirë për mashtrim. Ky kriter pas intervistave në terren duhet hjeket, sepse këtë qështje interesin më të madh për një menaxhim më të mire.

Investimi dhe shuma e grantit duhet të bëhen në bazë të një standardi të përcaktuar për madhësinë e fermës. Bazuar në përvojën dhe dështimet që kanë pësuar feramat, fermerët kanë aplikuar për shumën maksimale të grantit duke mos i koordinuar investimet me kapacitetin prodhues të fermës. Në këto raste, pas investimit, fermerët kanë pasur probleme me menaxhimin e fermës në kapacitetin që ata kanë ndërtuar.

Në lidhje me shumën e investimeve të pranueshme, rekomandohet të propozohet vlera totale minimale të jetë €45,000 kurse vlera maksimale mbetet e njëjtë €100,000, për shkak se Ministria ka mungesë të kapaciteteve njerëzore në implementimin e projekteve dhe nga data e shpalljes e deri në implementim e plotë në riimbursim kalojnë nga 12-15 muaj. Projektet me vlera më të vogla njëjtë sikurse ato me vlera të larta i ndjekin të gjitha periudhat administrative, duke fillura nga aplikimi, kontraktimi, implementimi, kërkesa për pagesë. Dëmet nga këto vonesa e dëmtojnë pikërisht fermerin. Arsye tjetër është që aplikantët që kanë aplikuar në Programin e zhvillimit Rural 2024, investimet e planifikuara në momentin e implementimit kanë qenë më të shtrenjta për së paku 30% për shkak të rritjes së kostos së fuqisë punëtore në krahasim me periudhën e aplikimit shtator 2023.

⁴³ Stregjia për bujqësinë dhe zhvillim rural, faqe 72

Tabela 14-4. Plani i veprimit për mbështetjen e sektorit të mishit të gjedhit

Fusha	Veprimet e parashikuara
Ferma	<ul style="list-style-type: none"> • Pagesë direkte për krerë viçi • Mbështetja e përmirësimit të fermave sa u përket pajisjeve dhe rinovimit/ndërtimit të ambienteve • Ulja e kostove të bujqësisë duke modernizuar pajisjet (mekanizimi), veqanërisht teknologji inovative në ujitje, me qëllim që fermeri më këtë investim të mitigon efektin negativ të ndryshimeve klimatike gjatë prodhimit të ushqimit voluminoz dhe drithërave për fermën e saj. • Rritja e sigurisë bio përmes ofrimit të pajisjeve të reja dhe trajnimeve të ndërgjegjësimit • Mbështetja e zbatimit të dispozitave për mirëqenien e kafshëve • Organizimi i trajnimeve profesionale me mbështetjen e shoqatave të prodhuesve, universiteteve/instituteve kërkimore dhe të Aquis
Burimet gjenetike	<ul style="list-style-type: none"> • Nxitja e përdorimit të racave të dedikuara për majmëri si racë e pastër • Promovimi i racave të specializuara për majmëri të cilët janë tani në fermat e Kosovës dhe duhet të mbështetet veqanërisht në kullota (mbajtja e krereve për riprodhim për sigurimin e viçave).
Materiale ushqyese	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e prodhimit vendas të materialeve ushqyese, të tilla si misri kokërr dhe misrit për sillazh me qëllim të uljes së kostos së prodhimit në ferm. Rritja e prodhimit të foragjereve, duke stimuluar investimin në teknologji inovative të ujitjes (sistemi ujitjes pikë-pikë, promovimi tij). Për shkak të ndryshimeve klimatike, thatësirave të ashpra gjatë verës, rendimenti i misrit për sillazhë dhe misrit kokërr është larg nën mesatare.
Përpunimi primar dhe sekondar	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e thertoreve dhe përpunuesëve në drejtim të rinovimit/ndërtimit të ambienteve për përmbushjen e standardeve të BE-së • Mbështetja e zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe përpunimin e nënprodukteve • Organizimi i trajnimeve profesionale me mbështetjen e shoqatave të prodhuesve
Impiantet e menaxhimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza
Marketingu	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e krijimit të organizatave prodhuese/marketingut • Koordinimi i procesit të mbledhjes së prodhuesve të vegjël në shoqatat lokale/rajonale në mënyrë që të rritet vizibiliteti dhe kapaciteti i tyre për mbështetjen e anëtarëve të tyre • Mbështetja e politikës së marketingut/vizibilitetit të mishit të viçit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar • Mbështetja e fushatës së ndërgjegjësimit për informacionin e konsumatorëve në lidhje me cilësitë pozitive të mishit lokal
Legjislacioni	<ul style="list-style-type: none"> • Vazhdimi i procesit të përafrimit të legjislacionit dhe standardeve me BE-në dhe zbatimit të legjislacionit në terren duke pasur si prioritet sa më poshtë: rregullimi i mirëqenies së kafshëve, si dhe praktikat e mira bujqësore në menaxhimin i plehut të shtazëve.

15 Referencat

- ASK (2023). Agricultural Holdings Survey 2023; <https://askapi.rks.gov.net/Custom/73ae2e93-33b4-420f-b556-43a5946486cd.pdf>,
- Kosovo Country Commercial Guide. (2023). <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-market-overview>,
- MBPZHR. (2006), Udhëzim administrativ ma-nr. Udhëzim administrativ ma-nr. 20/2006 standardet e cilësisë dhe kategorizimi i qumështit të freskët
- MBPZHR. (2023), Raporti gjelbër 2023. https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf -
- ASK, (2014) Regjistrimi i bujqësisë në republikën e Kosovës 2014 <https://askapi.rks.gov.net/Custom/0fd0807c-ee4a-4b80-9122-ccf156bab4de.pdf> -
- ASK, (2023) - Anketa Fuqisë Punëtore, <https://askapi.rks.gov.net/Custom/9da1088d-bbd2-4501-a937-c22d85e2c4b5.pdf>
- MBZPHR (2021)- Strategjia për bujqësi dhe zhvillim rural 2022 – 2028
- AUVK <https://auvk.rks-gov.net/bizneset/bizneset-e-aprovuara-per-ushqime-me-origjine-shtazore/>
- MBPZHR, Programi zhvillimit Rural 2020, 2021, 2022 & 2023
- MBPZHR, Programi Pagesave Direkte 2021, 2022, 2023 & 2024
- European Commission (2024) https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf Kosovo* report 2024,
- European Commission, (2020). https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/food-farming-fisheries/key_policies/documents/voluntary-coupled-support-note-revised-july2020_en.pdf
- SHPQK, 2023 – Raporti Sektori i Qumështit në Kosovë
- Programi zhvillimit të Blegtorisë dhe prodhimit blegtoral në Kosovë deri në vitin 2000, 1990, Instituti Blegtorisë dhe veterinarisë – Fakulteti Bujqësisë Prishtinë, faqe 14
- SHPQK (2021) Assessment of the current situation of KAMP
- MBZPHR (20113) - LIGJI Nr. 04/L-191 PËR BLEGTORINË

16 SHTOJCA

SHTOJCA 1: Llogaritjet e marzhit bruto të qumështit

Llogaritjet e marzhit bruto të qumështit	Njësi	Sasia	Çmimi (€/l)	Shuma (€)	Numri i lopëve qumështore (€)
Cmimi rentabël			0.38		10
Prodhimi rentabël		4,885			
Te hyrat					
Qumësht	litra	6,000	0.47	2,820	28,200
Vlera e viçit	kg	100	400	400	4,000
Subvencionimi për krerë					
Subvencionimi qumështit					
Të ardhurat totale				3,220	32,200
Kosto e ndryshueshme					
	njësi	Inpute	Çmimi	kosto	
Qumësht për ushqyerje me gji (L)	litra	300	0.47	141	1,410
Kostot e zëvendësimit 10 vite	Amort/vit	1	300	300	3,000
Shërbime veterinare	LS	1	50	50	500
Inseminimi artificial	LS	2	20	40	400
Vdekshmëria e lopëve	#	0.05	2,000	100	1,000
Shtroja	kg	1	30	30	300
Kostoja e punës	Viti	1	300	300	3,000
Shpenzime të tjera	#	1	30	30	300
Shpenzimet para ushqyerjes				991	9,910
Marzhi bruto para ushqimit				2,229	27,440
Ushqim	Njësi	Inpute	Çmimi	Kosto	
Silazh misri	kg	6,360	0.05	318	3,180
Sanë bari dhe bishtajore	kg	2,460	0.15	369	3,690
Kokërr misri	kg	1,368	0.25	342	3,420
Krunde gruri	kg	315	0.15	47.25	472.5
Kokërr gruri	kg	618	0.2	123.6	1,236
Soje	kg	198	0.48	95.04	950.4
Vit & min	kg	81	1	81	810
Shpenzime operative				1375.89	13,759
Shpenzim total direkt				2,367	23,669
Marzhet Netto EUR				853	8,531
Marzhet e fitimit % = fitimi neto/të hyrat *100				26	

Studimi sektorial për sektorin e blegtorisë - gjedhëtari - 2024

SHTOJCA 2: Llogaritja e marzhit bruto të mishit të viçit

Llogaritjet e marzhit bruto të mishit të gjedhit	Sasia	Njësi	Çmimi €/l	Shuma €	Numri i demave në tufë (€)
Cmimi rentabël			2.68		10
Prodhimi rentabël	361				
Te hyrat	Pesha përfundimtare				Total €
Dema	500	kg	3.9	1,950	19,500
Të ardhurat totale				1,950	19,500
Kosto e ndryshueshme	Inpute	njësi	Çmimi	Kosto	
Blerja e viçave	250	Kg	3.7	925	9,250
Shërbime veterinare	1	LS	10	10	100
Shtroja	1	kg	20	20	200
Kostoja e punës	180	ditë	1	180	1,800
Shpenzime të tjera	1	LS	20	20	200
Shpenzimet para ushqimit				1,155	11,550
Marzhi Bruto para ushqimit				1,155	11,550
	Inpute	njësi	Çmimi	Kosto	
Ushqim për foragjere	3,000	kg	0.1	300	3,000
Ushqim koncentrat	880	kg	0.25	220	2,200
				520	5,200
Shpenzim total direkt				1,675	€ 16,750
Marzhi Netto				275.00	€ 2,750
Marzhet e fitimit%					14.10